

Muhammed Muteveli Sharaviu

Mrekullitë e Kuranit (2)





Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

MREKULLITË E KUR'ANIT (LIBRI I DYTË)

Muhamed Mutevelli
Sharaviu

Botuar nga: Zëri Ynë

© Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit dhe përkthyesit Muhamed Jusufi

LAVDI ALLAHUT (EL-HAMDULIL-LAH)

Me emër të Allahut, Mëshiruesit të Përgjithshëm, Mëshirëplotit

Hyrja, në Kur'ani Kerim, fillon me Fatihan, ose ndryshe me nënën e Librit, kurse, kjo fillon me: Bismil Lahir Rahmanir Rahim (Me emër të Allahut, Mëshiruesit të Përgjithshëm, Mëshirëplotit). Arsyet e falenderimit janë të shumta, ne falenderojmë dikë, që konsiderohet të jetë për hirë të qenjesisë së Tij. Në të, ka veçori, që e bëjnë të meritueshëm falenderimin. Falendërojmë cilësitë e dikujt. Gjithashtu, edhe kur shohim diçka të bukur, sikur diamantet e rralla, apo kur mburremi dhe kënaqemi me bukurinë e tyre, apo kur shohim lule të bukura, etj. Lavdërimi është edhe, atëherë, kur kujtojmë begatitë ose precizitetin e përgjithshëm, si dhe përsosmërinë e tyre. Kur na shërben një njeri, do t'a falenderonim atë, për mirësinë që na bëri. Nëse na jep diçka, gjithashtu, do t'a falenderonim. Njeriu falenderon edhe, atëherë, kur lakmon të arrijë diku. Njeriun, të cilin, e njohim se është bamirës, e falenderojmë, ngase presim ndonjë të mirë nga ai. Për të arritur te e mira, thurim ose përpilojmë lëvdata të ndryshme për të.

Njeriu falenderon edhe nga frika, dënimi ose ekzistenca e nënshtimit. Kur dikush bën gabim dhe kur tjetri ka kompetenca për t'a dënuar në çast, por ai nuk e bën atë. Me këtë gjest paraqet një lloj mëshire ndaj tij, ai padyshim se do t'a falenderonte për zemërgjërësinë dhe mëshirën e tij, përkundër së drejtës së tij për t'a dënuar.

Këto, do t'i konsideronim, si disa elemente kryesore të falenderimit. Kur ne vërejmë se, të gjitha këto elemente, i ka Allahu, ne e ndiejmë veten të obliguar që t'a falendërojmë Atë. Mirësitë e Tij nuk numërohen, Ai gjithnjë jep, i hap dyert e mbyllyra dhe i lehtëson rrugët e jetës. Jep shëndet dhe pasuri. Parapëlqen punën, dhe shpërblen shumë mirë. Ai është Dhurues i Pafund, Ai asnjëherë nuk merr, sepse nuk ka nevojë për ne. Ne, as s'e shtojmë, e as e pakësojmë pasurinë e Tij. Depot e Tij, nuk zbrazen kurrë. Askush nuk mund t'i numërojë dhe llogaritë mirësitë e Tij. Allahu xh.sh., në Kur'ani Kerim, thotë:

“...dhe nëse përpiqeni t'i numëroni të mirat e Allahut, s'do të arrini t'i llogaritni ato”.¹

Me gjithë përparimin e lartë, që kemi arritur tani, ne nuk jemi në gjendje t'i numërojmë mirësitë e Allahut të Lartësuar, si ato të jashtmet, po ashtu dhe të brendshmet.

Si përfundim, mirësitë e Allahut, nuk mund të llogariten. Sikur të vendosnim t'a falendërojmë Atë, për secilën mirësi, nuk do të na mjaftonte e tërë jeta jonë.

¹ Kur'an, Ibrahim 34

Është mëshirë e Allahut, që t'a falenderojmë me dy fjalë: Lavdi Allahut. Është për t'u çuditur se, kemi njerëz të cilët kërkojnë të falenderohen me orë të tëra, për një të mirë që ia kanë bërë dikujt, dhe në fund, mbase, nuk janë të kënaqur, ose nuk do t'u mjaftonte ky falenderim.

Allahut xh.sh., me të gjitha madhësitë e Tij që ka, i mjaftojnë vetëm dy fjalë

El'Hamdu Lil'lah - Lavdi Allahut. Për ta kuptuar se sa është mundësia e Tij, dhe sa shpërblehet falenderimi ynë ndaj Allahut të Lartësuar, mirësitë e të Cilit nuk i numërohen në këtë botë dhe në ahiret, duhet t'i shohim ato në jetën e përditshme dhe, njëkohësisht, do t'i shohim ato edhe në ahiret. Ai na jep më tepër, se secili njeri që mund të na japë. Na kthen të mirën me të mirë në ahiret, dhe na përgatit jetë të kënaqshme në këtë botë. Na jep shumë më tepër, nga ajo që mund të marrim në këtë, dhe sikur, e gjithë fuqia dhe mundësitë tona njerëzore, të bashkohen për t'a falenderuar, nuk do të mjaftonte, por ja, që Atij, i mjaftojnë vetëm dy fjalë: El'Hamdu Lil'lah.

Atij, i Cili, kujdeset për të gjitha krijesat e Tij, i mjaftojnë vetëm këto dy fjalë dhe, këto fjalë, janë në fillim të hyrjes, në Kur'an, El'Hamdu Lil'lah dhe, gjithashtu, në përmbyllje të lutjeve tona. I Lartësuari thotë: "...ndërsa lutja e fundit e tyre do të jetë: Lavdi, është për Allahun - Zot i botërave"². Falenderimi qëndron në këtë jetë dhe në ahiret, qëndron derisa krijesat janë në jetë si edhe atëherë, kur çdo gjë të kthehet tek Ai.

Do të ishte shumë e vështirë që njerëzimi të gjente formë falenderimi për Allahun. Sado të mundoheshim për të gjetur formë falenderimi të kënaqshëm, nuk do të arrinim t'a gjenim atë, që e meriton dhe i takon Atij. Për këtë arsye, Allahu, na mësoi që në fillim të librit të Tij, si t'a falenderojmë Atë, në mënyrë që, të gjithë robërit e Tij t'a falenderojnë njëllë. Çdo njeri ka nevojë t'a falenderojë Atë, por atyre edhe u kërkohet që t'a bëjnë këtë.. Meqenëse, robërit duhet t'a falenderojnë Atë, ata nuk do të ishin në gjendje t'a gjenin mënyrën e duhur të falenderimit të Allahut të Lartësuar, prandaj u është kërkuar kjo formë.

Meqenëse na mësoi se si t'a falenderojmë, Ai dha mundësi të barabarta dhe të shumta, si për itelektualët, ashtu edhe për njerëzit e rëndomte apo analfabetë. Mënyra se si ta falenderojmë, ishte një dhuratë tjetër për ne dhe, për këtë meriton një falenderim të veçantë, prandaj duhet t'a falenderojmë. Pra, kur njeriu duhet t'a falenderojë Allahun për mirësitë e Tij, ai duhet pra, t'a falenderojë, Atë, edhe për mënyrën se na mësoi se si t'a falenderojmë. Me këtë lloj të kuptuari, robi do të ishte vazhdimisht falenderues, kurse Allahu gjithnjë do të jetë i falenderuar.

Para se t'a fuste fjalën: El'Hamdu Lil'lah, në buzët tona, i Lartëmadhëruari, krijoi begatitë, të cilat do të lidhen me El'Hamdu Lil'lahin. Nëse i hedhim një vështrim,

² Kur'an Junus 10

radhitjes së gjërave dhe mirë- sive, do të shohim se ato begati të Allahut na udhëheqin gjithnjë, ato gjithmonë janë para nesh, dhe nga kjo, ne, kuptojmë se ato janë të krijuara para krijimit të njeriut. Allahu krijoi qiejt, tokën dhe përcaktoi rizkun³.

Kur, njeriu u krijua, me fjalën 'bëhu', të gjitha begatitë ishin prezent. Bile, kur Allahu krijoi babën e njerëzimit, Ademin a.s., ai jetoj në xhen-net, pa ndier lodhje e as ankesa. Çdo gjë ishte e bollshme për të. Ademi ishte njeri pa kohë të shkuar dhe, edhe pse i tillë, Allahu ia kishte servuar begatitë atij. Ato, e pritnin atë, për t'i dhënë një jetesë, të cilën nuk e kishte ndërtuar vetë. Ajo ishte ndërtuar nga i Lartësuari Allah.

Kjo do të ishte një hyrje e fjalës El'Hamdu Lil'lah. Kjo ishte një hyrje e domosdoshme, me të cilën obligohemi t'a falenderojmë Allahun, për të gjitha begatitë, të cilat na dhuroi.

Kjo ishte një hyrje, e cila duhej t'i paraprinte secilit kapitull të këtij libri, si: Allahu dhe Gjithësia, Dyshimi dhe Ekzistenca, Pamja e Gjërave dhe Realiteti 'Tyre, Mrekullia e Isra-së dhe Miraxh-it.

Pra të fillojmë fjalimin tonë.

ALLAHU DHE GJITHËSIA

Kur flas për Allahun e Lartësuar, për ekzistencën, shoh se një shumicë njerëzish, duken se janë të etur, për këtë çështje. Këtë e prezentojnë me dualizëm ose mohim. Këta e humbasin veten, duke u munduar të argumentojnë teori të humbura, të cilat, në përpjestim me të vërtetën, janë hiç gjë.

Para se të filloj fjalimin, dëshiroj të them se bara mbi shpenzimet janë tonat, sepse secilit që mund t'i ndodhë ndonjë fatkeqësi në fenë e tij, e kjo pastaj e bën ate të mëkatojë, duke u përpjekur t'i shpjegojë dyshimet që i paraqiten për ekzistencën e Hyjnisë. Kjo buron në brendi të secilit mëkatar ngase ate diçka vazhdimisht e brenë, e përjeton dhe e ndien, se një ditë do të merret në pyetje, e ajo është ahireti,⁴ si dhe një ditë, do të takohet me All'llahun. Kjo ndjenjë e ngacmon njeriun vazhdimisht, e shtyn atë të dyshojë në fe, t'i nënshtrohet mëkatit, duke e mashtruar veten se nuk do të merret në pyetje e as nuk do të dënohet.

Filozofët janë munduar, me vite të tëra, të fusin dyshim në fetë qiellore. Ata orvaten që, me oratoritë e tyre, besimtarët t'u nënshtrohen logjikës së tyre. Por,

³ Rizku, çdo gjë që është e nevojë e domosdoshme për njeriun është rizk, e këtë secili e ka të garantuar (kom.Përkth)

⁴ Jeta e amshuar (njeriu kalon nëpër katër jetë, në bark të nënës, në këtë botë, në jetën e varrezave dhe në ahiret ose në jetën e përjetshme), (komment i përkthyesit).

disa filozofë të tjerë, shtojnë duke pohuar se feja është adhurim, ndërkaq, lirim nga feja, e konsiderojnë çlirim. Konsideroj se, të dy mendimet janë të gabuara.

Imani⁵ në Zot është një gjë që ka gjurmë, dhe për këtë njerëzimi është orvatur shumë. Secili orvatet në mënyrën e vet, dhe prej saj pret rezultatin. Kjo nënkupton, se është një polemikë, e cila nuk do të përfundojë kurrë. Njeriu, vazhdimisht hulumton të arrijë me argumentet e veta forcën e kësaj ekzistence. Kurse, kjo i përket metafizikës ose argumenteve mohuese, që orvaten të argumentojnë ekzistencën e kësaj force. Ne e dimë, dhe e njohim Allahun nga natyrshmëria jonë njerëzore, sepse Ai, gjendet në brendi të qenies sonë, e cila, vërteton ekzistencën e Tij. Për ndryshe, njeriu nuk do të shkrinte energji në këtë polemikë. Shohim zemërime të shumta të njerëzve, që i ngacmojnë thellë, edhe pse materialisht mund të qëndrojnë mirë. Numri më i madh i vetëvrasjeve është në shtetet materialiste, që janë më të zhvilluara. Ata, edhe pse kanë arritur rezultate të larta, që shumë vende materialistësh do t'i kishin lakmi për jetën luksoze që bëjnë, shprehin pakënaqësitë dhe zemërimin e tyre, sepse nuk kanë arritur t'a realizojnë harmoninë ndërmjet vetes dhe gjithësisë. Kjo harmoni, do të arrijë tek ta, vetëm nëse kanë iman dhe e pasojnë programin e Tij.

Le të lexojmë një ajet të Kur'ani Kerimit, i cili e ngacmon besimtarin, ai ajet është ajetul Kursij (ose që njihet tek ne si tespih dova):

“Allahu është Një, - nuk ka hyjni tjetër përveç Atij, i Gjallë, qëndron ...”⁶ Fjala i Gjallë, vetëkuptohet se Ai është përjetësisht i Gjallë, Ai nuk e shijon vdekjen. Ai, krijoi jetën dhe vdekjen. Fjala ‘qëndron’, ka kuptimin se Ai qëndron me mbretërinë e vet.

Mendoj se kjo duhet sqaruar pak më gjërësisht. Disa njerëz, besojnë se Allahu i Lartësuar, krijoi gjithësinë, pastaj përcaktoi në të edhe rregullat e saj. Pasi i krijoi rregullat, atë e la të lirë, pa ndonjë ndërhyrje në të. Shpjegojmë se, kjo jetë vazhdon sipas rregullave të caktuara prej Tij. Janë rregulla shumë precize, të cilat nuk ngatërrohen me kohën, dhe ato nuk ndikojnë në asgjë. Përkundrazi, Allahu i Lartësuar, na paralajmëron se krijoi këtë gjithësi, përcaktoi rregullat e saj dhe njëkohësisht na bëri me dije, se Ai Qëndron mbi të, është mbikqyrës i mbretërisë së Tij, Ai këtë, nuk e le vetëm për asnjë moment.

Nga kjo nënkuptojmë se, Allahu i Lartëmadhëruar, si mbikqyrës, na siguron dhe na mëson, që ne nuk duhet të mërzhitemi për këtë. Ai vendosi rregullat e kësaj gjithësie, pastaj kërkoi nga ne, të bazohemi në të dhe t'i ndjekim rregullat e Tij. Ne nuk jemi në gjendje të ndryshojmë asgjë, sepse Ai qëndron mbi mbretërinë e vet, Ai mund t'i hapë dyert dhe të realizojë ato gjëra, të cilat neve i dimë se janë të pamundura. Kur proceset nuk funksionojnë, atëherë njeriu ndien dridhje dhe

⁵ Besimi i pastër në Zotin- monotoizmi i vërtetë.

⁶ Kur'an, Bekare 255

frikë dhe menjëherë klith duke thënë: ‘O Zot’. Përderisa, ai beson bindshëm se Ai qëndron mbi gjithësi, njeriu besimtar është i qetë, ai e di se e drejta do t’a mundë të padrejtën dhe të pamundurit do t’a mundin të keqen ose tiraninë. Pra, kur ai drithërohet për Allahun, ai sinjalizon shenjat e njohjes së fuqisë së Allahut, dhe atëherë kur atij i duket se proceset po pengohen dhe se nuk po i përgjigjet askush, mbështetja e tij është në Allahun, i Cili qëndron mbi gjithësinë në çdo kohë dhe çdo vend. Me këtë bindje, ai lirohet nga brengosja dhe ajo i shndërrohet në shpresë dhe çlirim.

Haxherja, kënaqësia e Allahut qoftë në të⁷, duke mos e ditur se në atë vend ka ujë, e la foshnjën, pranë pusit Zem zem, dhe filloi të endej poshtë e lartë në kërkim të ujit. Ftesës së saj, nuk ju përgjigj askush. Pas shtatë vrapimeve njëra pas tjetrës, prej një kodrine në tjetrën, ajo u lodh dhe filloi të brengoset tmerrësisht. Në këtë situatë që gjendej, foshnja duke lëvizur këmbët apo thembrat në tokë, doli uji. Dihet se foshnjët nuk posedojnë forcë sipas logjikës tonë, por ja që uji doli!

Muhammedi s.a.v.s., kur me qëllim të propogandimit të thirrjes së vet, e pësoi nga vizita e tij në Taif, u keqtrajtua, dhe mori fyerje të shumta nga populli, Allahu ia mundësoi të shihte mrekullitë më madhështore me shkuarjen e tij në qiell. Allahu ia mundësoi Isra-në dhe Miraxhi-n, vetëm për ta bindur të dërguarin e Tij. Pastaj, Muhammedi s.a.v.s., e ndryshoi formën e thirrjes në Islam, si të atyre në Mekke, ashtu edhe të atyre, që e vizitonin atë. Më vonë, erdhi një delegacion nga Medina, të cilët ia dhanë besën për sigurimin e tij, gjë që solli deri te hixhreti ose migrimi dhe deri te ngadhnjimi i Islamit.

Nëse ne do të rrëfenim për jetën tonë, do të tregonim për pengesat që kemi patur, pastaj si janë mbyllyr dyert, pastaj brengosjet e tmerrshme që i kemi përejtuar etj. Mbledhjet i transferojnë problemet, por, ato, nuk i zgjidhin ato. Kur arrijmë deri aty, ku nuk ka rrugëdalje, atëherë shohim çudinë, befas hapen rrugët andej nga nuk e kujtojmë fare. Pra, Allahu qëndron mbi gjithësi dhe është mbikqyrës, atëherë kur njeriut besimtar i dridhet e gjithë qenia e tij dhe kur është më brengosës, ndien qetësi dhe çlodhje, sepse Allahu dëgjon dhe sheh, Ai Qëndron mbi mbretërinë e Vet dhe nuk e le vetëm atë asnjëherë.

Vazhdon ajeti kerim: “Atë nuk e merr as kotja e as gjumi” (nuk e merr). Ai nuk fle kurrë dhe nuk tronditet. Me këtë thënjë, Allahu, sikur i jep njeriut forcë dhe bindje, në veçanti atyre, që pës- ojnë tronditje nga problemet e jetës. Atij do t’ia kthejë bindjen dhe sigurinë: Atë nuk e merr as kotja. Ai pra, nuk tronditet për asnjë moment të vetëm. Kur njeriu e dëgjon këtë nga Allahu, ai bëhet i qetë dhe bindet, se Krijuesi tij qenka gjithnjë zgjuar, Ai nuk kotet dhe kështu i sheh të gjitha mizoritë dhe tiranitë: Atë nuk e merr as kotja. Njeriu i rëndomtë, gjatë natës, fle i qetë, sepse e di që Ai nuk fle, Ai sikur do t’i thotë njeriut besimtar, fli i

⁷ Gruaja e Ibrahimit a.s., babait të peygamberëve (përkth.).

qetë dhe lirshëm, e mos u frikëso, sepse Unë nuk fle, Unë të mbroj qofsh në gjumë ose zgjuar, mos e zemëro veten, dhe mos mendo se do të të vijë ndonjë armik. Para shkuarjes në shtrat, për të fjetur, largoi zemërimet dhe brengat, sepse Unë nuk fle dhe të jesh i bindur dhe i qetë plotësisht, se je nën mbrojtjen Time të vazhdueshme. Njeriu, do të flejë shumë qetë, nëse në hyrje ka përcaktuar një roje, ose kur e di të paktën, që ndonjëri prej tyre, nuk do të flejë natën. Si ju duket, kur Allahu ju siguron se jeni nën mbrojtjen e Tij? Si do t'a ndiejë njeriu veten, duke qenë në dijeni se atë e ruan Fuqia, e cila krijoi gjithësinë?

Me këtë ndjenjë, besimtari, jeton gjithmonë, është i qetë, i bindur se është në sigurinë dhe mbrojtjen e Allahut të Lartësuar, si në kohërat e qeta pa luftëra, ashtu edhe në kohërat e vështira.

Vazhdon, ajeti Kur'anor, t'a shtojë harmoninë e sigurisë se njeriut me gjithësinë, edhe më shumë, kur Ai i thotë:

“...të Tij janë çdo gjë, që është në qiej dhe në tokë... Kjo është vazhdimësi e qetësisë dhe bindjes për njeriun, thujase Allahu i Lartësuar i thotë njeriut, ngase ke frikë? Nga rizku i së nesërme, që nuk e di nëse do të marrësh ose jo, si rezultat i punës prej së cilës mundet të mos shpërblehesh, nga paraja, e cila, të është e nevojshme dhe nuk mund t'a kesh? Paramendo ti, që çdo gjë, që është në qiej dhe në tokë, është mbretëri e Imja, ia Jap atij që dëshiroj dhe ia ndaloj atij që dua. Nga është ky zemërim dhe kjo urrejtje, nëse Unë kam dhe jap, prej nga ky mendim kur Unë posedoj edhe shumë gjëra që ti nuk i sheh? Mjer ti, nga frika e ditës së nesërme dhe nga frika e ndjenjës tënde, se je i vetëm në botë. Por, Unë jam Gjallë, nuk vdes, jam përgjithmonë dhe ekzistoj. Unë nuk fle dhe nuk tronditem, e as nuk kotem. Çdo gjë është nën patronazhin Tim. Përderisa ti je robi im dhe më ke besuar, të jesh i bindur dhe i qetë në caktimet e Mia. Përderisa e furnizoj atë që nuk më ka besuar, edhe pse kam kërkuar që të kujdesesh edhe për ata që mëkatojnë, si mundet të mendojë besimtari, që mos t'i përgjigjem atij, që më beson dhe është i bindur në Mua?

Vazhdon ajeti Kur'anor: “...Kush mund të bëjë shefaatë (ndërmjetësim) tek Ai, pa lejen e Tij...” Prej këtij ajeti, kuptojmë se, askush nuk mund të shërojë, askënd, pa lejen e Tij.

Me fjalë të tjera, ti mos u frikëso nga askush në botë, sado tiran të jetë ai, dhe mos u trishto nga fuqia e dikujt. Të gjithë këta, nuk mund të të lëndojnë ty, pa lejen Time. Ata, të cilët e thërrasin Allahun, janë të afërmit e Tij. Secili tiran ose mizor, në tokë, është shumë larg Allahut të Lartësuar.

Vazhdon ajeti Kur'anor: “...Ai e di ç'ka para tyre (të kaluarën dhe të tashmen) dhe pas tyre (të ardhmen) dhe ata s'mund të arrijnë diturinë e Tij pa vullnetin e Tij...” Dëshira e Allahut, është që të shtojë edhe diçka më tepër në bindjet tona, për të besuar Atë, sa për qetësinë e zemrave tona besimtare. Asnjëherë, mos

mendo se Unë nuk e di ç'po ngjan, dhe çka po të përgatitet ty. Unë di se ç'mendojnë ata, dhe ç'kanë planifikuar, di të gjitha ato që janë të shfaqura e që nuk janë të njohura për ju. Sepse, Unë, jam ai, që vendosi për veprën, për nijetet, sepse Unë jam sekreti i tyre. Prandaj, ti mos u frikëso, se mund të më shpëtojë gjë, ose se dikush, nga krijesat e Mia, mund të më fshehë diçka, qoftë ajo edhe sekret në veten e tyre. Atë, nuk mund t'a mashtrojë askush. Në Kur'an, i Lartësuar i thotë: "...Ai di sekretet dhe çdo fshehtësi"⁸. Domethënë, Allahu i di të gjitha sekretet.

Shtrohet pyetja: ç'është sekreti?

Një e përbashkët, mes dy gjërave. Një gjë, që e bëra dhe e fsheha ndaj dikujt, ndaj shokëve ose familjarëve të mi. Ky është sekreti. Pra, një gjë që fshihet nga të tjerët. Një gjë, që thuhet ose kërkohet të jetë sekret dhe ai të mos përhapet askund. Mbetet sekret në vetë, ajo nuk duhet të dalë nga goja. Edhe kjo, që mbetet vetëm në veten e tij, nuk mund të fshihet nga Allahu i Lartësuar. Allahu, i përhap këto sekrete, nëse është varianti i tij, i vetëm për të. E ti ngase frikohesh, nëse Zoti yt i di të gjitha, si dhe çka të mundon ty kur Zoti yt nuk fle, ti pse nuk qetësohesh?

Edhe më tutje, vazhdon ajeti: "...dhe ata s'mund të arrijnë diturinë e Tij, pa vullnetin e Tij...". Çfarë do të thotë kjo? Dituria e Allahut është e paarritshme, askush nuk mund të ketë dituri, përveç atij, që Ai i jep me dëshirën e Vet. Pra këtu kemi:

Dituri të dhuruar nga dëshira e Tij, pasi ta ketë zgjedhur personin. Dituri e dhuruar, për mbarë njerëzimin.

Dituri, e cila është në vet qenien e Allahut, dituri, të cilën, nuk ia jep askujt.

Dituria e parë, iu përket të zgjedhurve të Tij ose peygamberëve, evlijave (njerëzve të mirë). Kjo shpalosje është vetëm ndërmjet Allahut dhe të zgjedhurve të Tij. Këtu nuk kemi për çfarë të flasim asgjë, ata kanë dhunti të caktuara. Ato nuk janë tema të përgjithshme, prandaj këtu nuk ka vend për polemikë.

Dituria e dytë, i është dhuruar mbarë njerëzimit, ajo njihet si dituria materialiste. Kjo dituri, është një prej dhuntive të Allahut, kjo jepet ose zbulohet kohë pas kohe, gjeneratë pas gjenerate. Kjo dituri ka datën e lindjes të përcaktuar nga Allahu i Lartësuar. Nëse ndodh të lindë ndonjë dituri e re, do të shohim shumë dijetarë duke hulumtuar dhe duke u orvatur për arritjen e saj, për të cilën e ka dhënë pëlqimin Allahu xh.sh. Por, nëse kjo dituri nuk zbulohet prej mundit ose hulumtimit njerëzorë, atëherë dëgjojmë zëra që thonë se ishte një rastësi. Thujase, dikush ishte duke kërkuar diçka, e ai, rastësisht, zbuloi diçka krejtësisht tjetër gjë.

⁸ Kur'an, Taha 7

Ky zbulim, i cili nuk erdhi si rezultat i rregullave të hulumtimit, por erdhi në mënyrë krejt të rastësishme, mund konsiderohet si një shpalosje e Allahut, sepse kësaj diturie i ka ardhur koha e lindjes. Ne jemi vetë dëshmitarë të kohës, kur shkencëtarët turren dhe hulumtojnë diçka shumë të rëndësishme për t'a zbuluar, dhe çuditërisht, dhe krejt papritmas zbulohet diçka e re, e papritur fare.

Një risi, që njerëzimi nuk e kishte idenë fare, për të, më parë. A thua, si ndodhi kjo? Njerëzit janë të prirë të thonë, ndodhi rastësisht, por e vërteta e saj është se ka ardhur koha e lindjes së asaj diturie, për njerëzimin. Kjo ndodh, ngase ka dalë prej sekretit të diturisë së Allahut, e kjo do të arrijë tek dituria njerëzore me fjalën 'kun' (bëhu), ngase koha e lindjes është caktuar që nga ezeli⁹.

Kjo, është dituria e njerëzimit, kurse në diturinë, që ka të bëjë vetëm me Allahun e Lartësuar, nuk mund të arrijë askush. Për këtë arsye, ne, ajetet e Allahut i marrim në kuptim të përgjithshëm, sepse i Lartësuar na bën me dije se, sado të jetë dituria e atyre, të cilët provokojnë dhe sado të armiqësohen me ty, dije se Allahu e di dhe se dija e Tij është mbi dijen e tyre dhe e di, se cila dituri e shkatëron atë dituri, ose e pengon atë. E gjithë kjo, tregohet që besimtari t'a ndiejë veten të qetë, në caktimet e Allahut. Meqë është në siguri të plotë dhe ajo vjen nga All-llahu i Lartësuar, ai duhet t'a ndiejë veten të mbrojtur, sepse ka mbështetjen e qiellit.

Para se t'a kalojmë këtë temë, e shoh të udhës të sqaroj një diçka shumë të rëndësishme, e pastaj, me këtë, t'a përmbyllim domethënien e kësaj. Allahu i Lartësuar jep gjërat, nga të qenurit Zot - Rububije dhe nga të qenurit Hyjni - Uluhije. Allahu i Lartësuar i ka ofruar njerëzimit, duke i dhënë të gjitha dhuntitë Rububije (të qenit Zot). Kështu thotë i Lartësuar:

“Dhe kur, Zoti yt, nxori nga ijet e bijëve të Ademit, pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmitarë ndaj vetvetes së tyre (dhe i pyeti): A nuk jam Zoti juaj? (Ata iu përgjigjën): Po si jo, ne dëshmojmë, kështu që, në ditën e Kijametit, të mos thuani se ne ishim të padijshëm (indiferent) ndaj këtij (mësimi).¹⁰

Pse Allahu nuk tha, a nuk jam Unë Hyjnija juaj, dhe të dëshmoni në Hyjninë tuaj, ngase kjo ishte një dhënie e Zotit, Allahu është Zot i botëve, është dhurim, nga të qenurit Zot.

Dhurimet, që i jep nga të qenurit Zot, janë të barabarta për të gjitha krijesat. Secilës krijesë, që e krijoi Allahu, i jep, nga të qenurit Zot. Psh., Allahu i Lartësuar, krijoi gjithësinë dhe ia nënshtroi njeriut. Gjithësia ka forca të shumta dhe ato janë më të fuqishme, më të mëdha, se njeriu, por, ato, i janë nënshtuar njeriut, me urdhër të Allahut të Lartësuar. Dielli, toka, erërat dhe shumë forca të

⁹ Ezel, nga dituria e përjetësisë ose infinitit

¹⁰ Kur'an, Araf 172

tjera të mëdha, në univers, janë shumë më të mëdha se njeriu. Dielli, ka mundësi t'a djegë tokën, me gjithë ç'ka në të. Sikur, toka, të ndryshonte pak nga lëvizjet e saj (rotacionin ose revolucionin), njerëzimi do të zhdukej, gjithashtu edhe erërat mund të shkatërojnë, uji ka forcën e fundosjeve. Sikur të ndaleshin shirat, toka do të thahej dhe jeta do të shkatërrohej. Të gjitha këto fuqi, si dhe shumë të tjera, të cilat vlejnë për t'a mbajtur barazpeshën e gjithësisë, janë më të fuqishme dhe më të mëdha se njeriu, por, që të gjitha këto i janë nënshtruar njeriut. Dielli, nuk e ka lirinë e vet, të lindë ose mos të lindë, sot ose nesër. Uji, nuk mund t'a fundosë tokën ose t'a thajë atë, duke ikur gjetiu. Toka, nuk mund të ndalet nga rrotullimi saj. Të gjitha këto, shikuar si forca, janë gjigante dhe të tmerrshme. Këto, i janë nënshtruar njeriut, me urdhër dhe dëshirë, prej Allahut. Këto, nuk e posedojnë lirinë dhe nuk kanë kurrëfarë alternative të zgjedhjes. Si të tilla, këto, nuk mundën t'a thyejnë urdhërin e Allahut, sepse nuk kanë alternativ tjetër.

Allahu iu jep të gjithëve. Ai iu jep, sepse është Zot për të gjithë. Allahu, nuk bëri kurrfarë dallimi mes njerëzve, ata nuk i dalloi, nëse janë besimtarë ose jo besimtarë. Ai, iu mundësoi të gjitha krijesave, t'a shijojnë diellin dhe, ai, lind për të gjithë njëlloj, pa marrë parasysh bindjet e tyre, teiste ose ateiste. Toka jep frutat e saj, si për besimtarët ashtu edhe për jobesimtarët. Shiu bie ndër popujt besimtarë dhe jobesimtarë. Rregullat tokësore janë dhurim i të qenurit Zot. Ai, i cili, punon tokën mirë dhe përkujdeset për të, vazhdimisht nxjerr përfitime të majme, qoftë ai besimtar apo jobesimtar. Ai, i cili, nuk përkujdeset për tokën dhe nuk e mbjell, ai nuk do të arrijë asgjë, sado të jetë besimtar e i devotshëm. Do të përfitojnë nga dituria e Allahut, ata njerëz, që iu shpaloset dituria e Allahut, prej teknologjive bashkëkohore. Ai i jep atij, që involvohet në përparimin e kësaj bote, dhe ata, që mundohen, do të korrin atë që kanë mbjellur. Shohim se, All-llahu i Lartësuar, në cilësinë e të qenit Zot, nuk dallon një njeri prej tjetrit. Rregullat e caktuara prej Allahut, në tokë, janë të lidhura ngushtë me procesin e krijimit, ata që angazhohen, do të përfitojnë nga këto procese, pa marrë parasysh kush janë ata, besimtarë ose jobesimtarë. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar, kur kërkoi nga qenia njerëzore të dëshmojë ndaj vetes së vet, i tha “A nuk jam Zoti juaj”? Përveç atyre dhuratave të Zotit, më lartë thamë, se kemi edhe ato Hyjnore. Këto dhurata u përkasin, vetëm atyre, që besojnë Allahun, që dëshmojnë se “nuk ka Hyjni tjetër përveç Allahut”¹¹. Besimi, këtu kuptohet, si dëshmia mes njeriut dhe Zotit të tij. Për këtë arsye, vërejmë se ajetet e Kur'anit Kerim, në suren el Bekare, fillojnë me këto thënie: “Elif, Lam, Mim.”¹² Ky është Libri, në të cilën nuk ka

¹¹ La ilahe il'Allah (nuk ka Hyjni tjetër, përveç Allahut)

¹² Sipas fusnotës, së përkthimit të Kur'anit, nga z. Fetë Mehdiu. Elif, Lam, Mim. Njëzet e nëntë kaptina në Kur'an, fillojnë me një ose me disa shkronja, në fillim të disa kaptinave janë verseti i parë ose pjesë e versetit të parë. Me anë të këtyre shkronjave, u tërhiqet vëmendja, atyre që e lexojnë ose e dëgjojnë Kur'anin, për përmbajtjen që pason. Gjithashtu, këto shkronja, përkatësisht, shenjat e tyre, kanë edhe kuptimin të veçantë, por kanë edhe vlera simbolike.

dyshim, është udhëzues (hidajet) për Muttekinët (përudhërit).¹³ Të cilët, besojnë në sekretet dhe ata, të cilët e falin namazin dhe ata, që shpenzojnë (në rrugën e Allahut) nga rizku, që ju kemi dhënë Ne. Dhe të cilët, besojnë në atë që t'u revelua ty dhe, atyre, që iu është reveluar para teje dhe, ata, që e besojnë Ahiretin. Këta, janë në përudhje nga Zoti tyre dhe këta, janë të shpëtuarit.¹⁴

Shohim se Allahu i Lartësuar, në Kur'ani Kerim, iu ligjëron vazhdimisht besimtarëve me thënjet "O ju që keni besuar". Për të përfitur nga dhuratat e Hyjnisë, kushti kryesor është besimi në All-llah. Ky dhurim, është prezent në Kur'ani Kerim, ai është imani, ky mund të jetë edhe sekret, besimi në ringjallje, pastaj marrja në pyetje, pastaj rruga e jetës, nëse do të jetë e sigurtë, e qetë dhe e këndshme. Ky është përsëkrim nga Allahu i Lartësuar, në Librin e Tij, për ata që besojnë. Dhuratat, që dalin nga Hyjnia, i përkasin jetës së mirë në këtë botë dhe në ahiret. Ato, janë për besimtarët, që e njohin Allahun, si krijues, dhe nuk i bëjnë shok, Atij. Ata, e ndjekin këtë rrugë, sipas përsëkrimeve të Allahut, për këtë jetë, që është sqaruar, për ne në Librin e Tij. Në këtë rrugë, gjenden shpjegimet dhe mënyra e përmirësimit për secilin, që ka marrë rrugën e shkatërrimit. Aty, shoqëritë do të gjejnë etikën dhe moralin e lartë, e cila, të shpie në një jetë të lumtur, në një jetë të sigurt dhe me plot begati.

Në të shumtën e rasteve, ne, marrim për udhëzim legjislaturën njerëzore. Kjo, më pas, na bën, të kemi kokëçarje të mëdha në shoqëri. Sikur ne, të merrnim legjislaturën e Allahut të Lartësuar, do të kishim një zhvillim dhe një jetë shumë më të lumtur dhe më të plotë.

Arsyeja është ngase, mundësia dhe përudhja e njeriut, dallon dukshëm nga mundësia e Allahut të Lartësuar. Përderisa, Allahu e krijoi qenien njerëzore dhe gjithësinë, Ai është më i ditur, se kushdo tjetër. Ai e di më mirë, çka e gëzon dhe çka është më e mirë për jetën njerëzore.

Besimtari, i cili, e ndjek rrugën e Allahut xh.sh., e ndien, në vete, dhuratën e Tij dhe gjithmonë është i qetë. Kur, zbriti thënja e Allahut, për Muhammedin ﷺ, "...dhe Allahu do të të mbrojë prej njerëzve...", Muhammedi ﷺ, i urdhëroi mbrojtësit e tij, të mos kujdesen më për të. Ai, këtë ajet Kur'anor e kuptoi menjëherë, kështu që ju tha: tani e tutje, nuk kam nevojë për mbrojtje, sepse nuk ka fuqi më të madhe, se sa fuqia e Allahut. Atij nuk mundet t'i afrohet dhe t'a dëmtojë askush. Omerin¹⁵, e shihnin duke fjetur, nganjëherë, nën hijen e hurmës, pa mbrojtës. Ky, ishte i bindur, në thënjen e All-llhut: "Atë (Allahun) nuk e merr as kotja e as gjumi". Omeri flinte i qetë dhe pa brenga, nën hijen e pemëve, me plotëbesim në Allahun e Lartësuar. Ai nuk fle -thoshte Omeri,- dhe nuk ka më të

¹³ Muttekinë, janë personat, të cilët ruhen nga mëkatet dhe janë të devotshëm.

¹⁴ Kur'an, Bekare 1-5

¹⁵ Khalifi i dytë musliman

fuqishëm dhe më mbrojtës se Ai, edhe sikur t'i marrim të gjithë mbrojtësit e botës. Kjo bindje, e shtyri atë, që të flejë i qetë, nën hijet e pemëve, duke mos e mbrojtur askush. Këtu, kemi të bëjmë me imanin, me të qenurit apo jo besimtar. Të besuarit, në Allahun e Lartësuar, është të besuarit me plotëbindje, se Ai është forca më e madhe e mundshme. Të largohesh nga të gjitha paragjykimet dhe qëllimet, të jesh i mbështetur në fuqinë që Ai krijoi, duke patur parasysh se dhe këtë gjithësi e nënshtroi për ty. Duke besuar, se kjo force, nuk i ngjason askujt në dituri, në krijim, në mëshirë, në hakmarrje etj., prej cilësive të Allahut xh.sh. Kur imani hyn në zemër, nuk duhet të krahasohet dituria jonë, me diturinë e Tij. Kur, i Lartëmadhëruari, të thotë: bëje këtë, ne, nuk kemi kompetenca t'i themi, pse? Mund të bëhet polemikë, vetëm, nëse kemi të bëjmë mes dy mendjeve të përafërta. Mendja dhe mundësia e njeriut, është e pakrahasueshme me mundësinë e Allahut. Gjithashtu, nëse na urdhëron, të mos veprojmë diçka, ne nuk kemi kompetenca t'a pyesim: pse? Si është e mundur, që ne t'a krahasojmë diturinë tone, me të Tijën. Vërejmë se, shumë njerëz, marrin guximin dhe mundohen të polemizojnë me Allahun xh.sh., duke e ndier veten kompetent. Polemizojnë Allahun, me programet e veta, të cilat i kanë skicuar për njerëzimin. Iman në Allah, do të thotë t'i dorëzosh të gjitha mundësitë dhe njohuritë njerëzore, në mundësitë dhe diturinë e Allahut të Lartësuar. Këtë, do t'a konsideroja si një hyrje në imanin njerëzor. Kjo hyrje, do të vinte në sajë të mendimit dhe planifikimit së gjithësisë dhe shenjave të saj.

Disa njerëz, këtë, e quajnë adhurim. Kështu, e tërë feja, konsiderohet adhurim. Ne, gjithashtu, konsiderojmë se feja është adhurim i Allahut të Lartëmadhëruar. Por, adhurimi i Allahut xh.sh., dallon nga adhurimi i njeriut. Nëse, një njeri kërkon që të adhurohet prej teje, ai, ka për qëllim të marrë nga ty ose nga energjia jote, të gjithë potencialin e mundshëm që ke, dhe atë ia bashkangjit forcës së vet, që është më e madhe dhe më e fuqishme, pastaj, me bashkimin e këtyre forcave, mundohet t'i realizojë ambiciet e veta, për qëllimet e tij, ose të përbashkëta. Nëse arrin, që këtë person t'a adhurojnë një grup njerëzish, ai pastaj do të kërkojë, që të gjithë të punojnë për të, kurse, ai vetë, fillon t'a rritë vazhdimisht luksin për vete. Adhurimi i njeriu, konsiderohet thjesht një robëri, e cila, i sjell dobi personit të adhuruar. Në Islam, kjo nuk pranohet.

Adhurimi i Allahut të Lartësuar, është përforsim i ideve dhe mundësive të tua, e cila, të jep mirësi dhe begati. Dhuntitë e Allahut, vazhdimisht, shtohen për ty. Ky lloj adhurimi, shkon në favorin tënd. Allahu i Lartësuar është i pasur dhe të Tijat janë gjithë ç'ka në botë. Ai është sundues, është pronari i të gjithëve. Pasuria, është e Allahut, ajo transportohet nga një dorë në një tjetër, pastaj në tjetrën, e kështu me radhë. Secili njeri, nuk merr tjetër, përveçse rizkun e vet. Allahu i Lartësuar, thotë: "...dhe meshkujt kanë pjesë, prej asaj që e kanë fituar..."¹⁶ Për t'a

¹⁶ Kur'an. Nisa 32

sqaruar këtë urtësi, rizku, i cili vjen ose fitohet, nuk është pjesë vetëm e jotja, në të, ka pjesë gruaja, fëmijët, dhe një numër, nga krijesat e Allahut. Shpeshherë habitemi me atë njeri koprac, që nuk kënaqet me atë që e ka furnizuar Allahu. Do të pyes me plot çudi, a thua pse vepron kështu, dhe ndoshta, a se mundon së qortuari, mënyrën e tillë të veprimit. Përgjigja do të ishte, se kjo pasuri, të cilën e ka fituar dhe për të cilën ai kujdeset, nuk do të thotë se është rizku i tij. Ajo, është pasuri dhe rizk, edhe i krijesave të tjera, në Islam ai konsiderohet vetëm një kujdestar i devotshëm, derisa, ajo, t'ju arrijë atyre. Pra, ai nuk mund të shpërndajë prej saj, e as të kënaqet me të, por ajo duhet të qëndrojë pa u prekur, derisa të arrijë tek pronari i vërtetë.

Adhurimi i Allahut të Lartësuar është adhurim në dhënie. Dhurata të Allahut, për robin e Tij. Të Allahut, janë pasuritë e qiejve dhe të tokës. Ai nuk e dëshiron adhurimin tonë, me qëllim përfitimi nga ne, që me atë pasuri, ose punë, ose mund tonin, të arrijë rezultate të mira. Ai është, i Cili, na furnizon, na dhuron mirësi, dhe na begaton nga munda ynë. Ai na lehtëson, kur kemi vështirësi, i hap dyert e mbyllura për ne. Adhurimi i Allahut është për të mirën e robit. Ai është përgjithçka, me shumicë, për robërit, begatitë, në të, janë pasuria, shëndeti, fëmijët, përkujdesjet për robërit nga çdo e keqe dhe prapshti etj. Adhurimi jonë ndaj Allahut, e bën, Atë, të na ndihmojë në të gjitha lëmitë. Ai nuk kërkon nga ne, që të ndihmojmë Atë. Adhurimi ynë, për All-llahun, është ajo që ne e kërkojmë me mirëdashje, që Ai të na ketë në konsideratë dhe të jetë me ne. Kurse adhurimi ndaj njeriut, konsiderohet marrje e mundësive, djersës dhe veprimtarisë së njeriut tjetër. Ky është një dallim i pakrahasueshëm ndërmjet tyre.

Allahu i Lartësuar, i ka premtuar, robit të Tij besimtar, jetë më të mirë. Kur, Ai, më thotë: bëj kështu, padyshim, se ma do të mirën dhe me këtë unë do të arrij në kënaqësitë e kësaj bote dhe në ahiret. Veprimi im, nuk e shton sundimin, e as pasurinë e Tij. Po ashtu, edhe mos veprimi im, nuk e bën të varfër Atë, sepse, Atij, nuk i mungon asgjë. Shikuar nga këndi i besimtarit, njeriu me iman të plotë, nëse e ndjek rrugën e Allahut, ai ka zgjedhur jetën e mirë, ai nuk bazohet në mundësitë e veta, por ai është mbështetur në mundësitë e Allahut të Lartësuar, që nuk ka shok dhe të Cilit, nuk i përngjet askush. Kurse, nëse shikojmë nga këndi i jobesimtarit, ai do të polemizojë, ose filozofojë dhe do të parapëlqejë diçka, që është sipas tekeve dhe mundësive të tija. Dallimi mes besimit dhe mosbesimit është të zgjedhësh mes jetës të përshkruar prej Allahut të Lartësuar, mundësitë e të Cilit janë të panumërta, të pakufijshme, që nuk ndikohen nga rregullat e logjikës sonë, diturinë e të Cilit nuk arrin askush, dhe mes jetës së përshkruar nga ne, e cila është thurur sipas mendjeve tona të kufizuara dhe të mbushura përplot pasione.

Në të gjitha revelatat qiellore, Allahu kërkoi nga ne, të studiojmë dhe të hulumtojmë ajetet, gjegjësisht, shenjat e Tij. Pse u urdhëruam me këtë, nga Allahu

Lartësuar? Me siguri, sikur të ekzistonte vetëm një argument i vetëm, që do të mundej të njolloshte Allahun, ai nuk do t'a kërkonte atë studim nga ne. Ai kërkoj nga ne, të studiojmë, së pari, vet qenien dhe krijimin tonë. Ai, i cili, do të kundërshtonte studimin, ai do të ishte i dyshimtë.

I tilli, asesi nuk do të kërkonte të hulumtohej sa më mirë, përkundrazi ai do të mundohej t'a pengonte ose t'a tërhiqte shikimin rreth shenjave të tjera, dhe kështu do të vepronte derisa, të bindej se personi është hutuar dhe nuk është në gjendje t'i vërejë mangësitë. Kurse, ai, që të thotë: studio, mendo dhe shiko me precizitet, është i plotëbindur në veprën e tij. Dëshira e Tij, është që njerëzimi të bindet dhe të besojë, në ekzistencën e Tij. Ai, gjithashtu, kërkon, që të njihen sa më mirë mundësitë dhe vlerat e Tij, sepse në këtë mënyrë, do të dëshmojnë për madhësinë e krijimit.

Për ta kuptuar më mirë këtë, do të sjell edhe një shembull. Kur hyni për të blerë diçka, pa marrë parasysh se ku gjendeni, dhe vjen pronari ose prodhuesi i artikullit, që ju dëshironi të blini, ju do të ndodheni para dy situatave: Nëse malli është i rregullt, dhe i ka kaluar disa here testet, prodhuesi do të kërkojë nga klienti që t'a kontrolljë mirë atë, bile disa herë. Pse e bën këtë? Sepse ai është i bindur në rregullsinë e prodhimit të mirë, që ai ka.. Ai duke qenë i bindur, kërkon pa frikë që artikulli i tij, të kontrollohet disa herë.

Por, nëse malli nuk është i rregullt, dhe nuk ka siguri në të , prodhuesi i mallit do të mundohet të t'a hedhë në çdo mënyrë, dhe të të tradhtojë. Ai do të orvatet, në çdo mënyrë që të të hutojë, derisa të bindet, se nuk po e vëren dobësinë e mallit që e ke para duarve. Allahu i Lartësuar, kërkoj nga ne që të studiojmë dhe të hulumtojmë lirshëm, në krijesat e Tij. Ai na thotë se gjithësia është një nga shenjat e dukshme, sikurse dhe vet qenia njerëzore. I Lartësuari thotë: “Ne do t’ju mundësojmë atyre të shohin Shenjat Tona, në të gjitha horizontet edhe në vetë qenien e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se (Kur’ani) është i vërtetë...”¹⁷ Për cilat ajete (shenja) flet i Lartëmadhëruari? Ai, me këtë, po i sfidon të gjithë. Ai e di mirë ç’ka krijuar dhe se si i ka përsosur ato.

Kjo sfidë, që të studiojmë shenjat, krijesat e Tij, dhe po ashtu edhe vetë qenien tonë, nuk do të kërkohej, nëse thënësi s’është vet krijuesi. Ai është Allahu, i Cili, vendosi shenjat dhe mrekullitë në këtë kozmos, që të argumentojnë Madhërinë dhe Mundësitë e Tij të pakufizuara.

Kur studiojmë kozmosin, vërejmë madhësinë e Allahut xh.sh. Ky duhet të jetë, qëllimi i parë, për njeriun. Të studiohet kozmosi dhe të njihen krijesat e Allahut. Njeriu, i cili, i studion këto, nëse nuk i është nënshtruar Allahut, nuk do të jetë i lumtur.

¹⁷ Kur’an, Fusilet 53

Njeriu e mori amanetin, ashtu siç na mëson, i Lartësuari, duke thënë: “Vëretë, Ne u kemi ofruar amanetin¹⁸ qiejve dhe tokës dhe bjeshkëve, por ato refuzuan të ngarkohen me atë dhe, u frikësuan prej tij. Ndërsa, përsipër e mori njeriu. Pa dyshim, ai u bë mizor (ndaj vetes) dhe i pakujdesshëm (ndaj konsekuencave)”¹⁹.

17

18

19

Ç’është amaneti? Me amanet, këtu nënkuptohet liria e të zgjedhurit, pa ndonjë presion nga jashtë. Allahu, në këtë ajet, e konsideroi njeriun injorant të vetëvetes, në momentin e pranimit të kësaj barre, pra të këtij amaneti. Ky ajet, jep të kuptohet se ai nuk kishte njohuri, nuk ishte në gjendje t’a kuptonte rëndësinë dhe peshën e atij amaneti.

Do të sjell një shembull, i cili do të na e lehtësojë pak më tepër. Të supozojmë se, një njeri erdhi tek unë, më dha një sasi lekësh dhe më tha: Po i le amanet tek ti. Dhe vazhdon të vijë kësaj tek unë, çdo muaj, ose shpesh here, duke më sjellë vazhdimisht lekë dhe duke më thënë: këto para janë amanet tek ti. Por pas një kohe, unë fillova t’i shpenzoj, sipas tekeve të mija. Por, një ditë pronari, vjen dhe më kërkon të gjitha paratë. Si t’ia kthej paratë e tija, kur unë i kisha shpenzuar të gjitha? Kjo i ndodhi edhe kësaj bote. Allahu na dha begati të panumërta, dhe na tha, kënaquni sa të doni, por një gjë ta keni parasysh, kjo është barrë dhe amanet për ju. Mos u rebeloni, mos vidhni, mos e keqpërdorni këtë begati në adresa të të tjerëve. Njeriu e pranoi këtë amanet, por ja që Shejtani²⁰, një krijesë tunduese, shfrytëzoi nga rasti, pasi që njeriu e mori përsipër këtë barrë, pra (lirinë e të vepruarit) dhe kur Allahu i tha bëje këtë, ai u përgjegj: jo nuk e bëj. Duke qenë në këtë situatë, nuk i vendosi dëshirës së tij të lirë, asnjë rregull dhe presion.

Ndërkohë, që njeriut ia ofroi lirinë e të zgjedhurit, atij ia paraqiti edhe përgjegjësinë. Pastaj All-llahu i dërgoi vazhdimisht shpallje, si shenjë përrudhjeje për në rrugë të drejtë. Kurse amanetin, të cilin e mori përsipër, ishte ai, që krijesat e tjera nuk e morën. Prej këtui mundësua liria e të zgjedhurit lirshëm, të veprojë ose mos të veprojë. Të gabojë ose të mëkatojë. Përderisa, njeriut, i kërkohet një gjë të bëjë, ai është i lirë edhe të refuzojë. Si edhe, nëse i kërkohet që mos t’a bëjë, edhe kjo është në disponimin e tij, t’a bëjë ose jo. Njeriut i është

¹⁸ Komentatorët e Kur’anit, japin shumë shpjegime rreth fjalës amanet. Dikush mendonte se është namazi, tjetri sheriat, etj. Komenti i autorit të këtij libri bëri një shpjegim të pa dëgjuar më parë dhe kështu i dha një kuptim shumë më të gjërë dhe më të qartë kësaj fjale (kom. i përkth.)

¹⁹ Kur’an Ahzab 72

²⁰ Shejtani, është një krijesë si edhe ne, por ai është krijuar nga zjarri, i takon familjeve të xhinëve.

mundësuar, por kjo nuk iu mundësua maleve, as diellit e as hënës, e as yjeve. Dielli nuk mund t'a thyejë urdhërin, të thotë sot nuk do të lindë ose nuk do të perëndoj. Yjet, nuk kanë kompetenca, të duken këtë mbrëmje, ose të mos duken natën tjetër. Po ashtu edhe melaiket nuk kanë liri të zgjedhjes, ato veprojnë vetëm atë që iu thuhet. Kurse njeriu, i cili e mori barrën e amanetit, e ka lirinë e të zgjedhurit në këtë botë... dhe çfarë bëri?

Injoranca e tij parafytyroi shumë gjëra. Adhuroi shumëçka, ato që askujt nuk i shërbejnë, e as nuk e dëmtojnë. Adhuroi diellin, zjarrin, gurët, idole të ndryshme, kafshë të egra. Vazhdoi të adhuronte çdo gjë, që e parafytyronte injoranca e tij. E humbi shejtani nga Allahu i Lartëmadhëruar, i Cili është Krijuesi i gjithësisë. Vazhdoi njeriu të mos jetë mirënjohës i begative të Allahut. I harroi revelatat, ato, të cilat, zbritën për ndriçimin e njerëzimit, nga mëshira e Tij, për një jetë të qetë dhe të mirë. Po, ai filloi të bëjë edhe ligje të veta, duke i injoruar ligjet e Allahut. Tek njeriu, ngadhnjyen ndjenjat dhe pasionet, filloi t'ju nënshtrohet atyre dhe vazhdimisht të largohet nga e vërteta. Kështu e kapluan depresionet dhe zemërimet e kësaj bote. A thua, çfarë e shtyri njeriu të veprojë kështu, kur Allahu ia zbriti atij Kur'anin, me një retorikë të përsosur, dhe atij, ia tregoi cilësitë e shejtanit dhe prezencën e tij, në vet qenien njerëzore. Ai na tregoi se si shejtani e mashtroi Ademin: “a të tregoj ty për pemën e amshueshmërisë dhe për mbretërinë e pazhdukshme”²¹

Si duket njeriu kërkon dy gjëra në këtë jetë:

Jetë të amshueshme pa mbarim

Pasuri të bollshme që nuk shteron.

Dëshiron të jetojë, e të mos vdesë kurrë dhe pasuri të bollshme, për plotësimin e epsheve të tij. E gjithë kjo dëshirë, të mos ndikojë edhe në shtrëngimin e pasurisë së tij. Të ketë thesar, që nuk do të numërohej. Kështu, shejtani ndikoi dhe munda i tij pati efekt, mashtroi qeniet njerëzore. Të gjithë këta zotëra, që shpiku njeriu, ishin ose rezultat i iluzioneve të tij, të cilat e tërhiqnin kah rizku në këtë botë, ose iluzion për t'a mbrojtur nga sëmundjet, gjegjësisht nga vdekja. Shikuar në vija të trasha, këto janë motivet, që e drejojnë njeriun të adhurojë, sipas pasioneve të tij. Realiteti është krejtësisht i kundërt, zotërat e tyre nuk veprojnë, as në njërën, e as në tjetrën. Ata, nuk përmbajnë as mirësi e as dëme, as për dikë tjetër, e as për vetet e tyre. Aty, gjithnjë mbretëron frika, dhe këtë, shejtani, e mbjell në qenien njerëzore jobesimtare. Atyre ua shton frikën, deri në atë shkallë, sa të besojnë se ka edhe diçka tjetër mbi ta, që është edhe më e lartë se aty, ku ata gjenden, dhe kështu vazhdon t'i hutojë, vetëm e vetëm, që mos t'a përmendin Allahun e Lartësuar.

²¹ Kur'an, Ta Ha 120

Këto iluzione shtien frikë në qenien njerëzore, këto ndikohen shumë lehtë, për shkak të mosbesimit. Njeriu me plot iman , e di fare mirë se, Allahu është me të. Ai, e di, se kjo forcë, ka mundësi t'a mbrojë, t'a ruajë, të kujdeset për të, kur ai është edhe në gjumë.

Ai, i cili, ka besim ose iman të plotë, nuk ka nevojë për ata njerëz ose "zotëra", sepse ai është i mbështetur tek Allahu. Dallimi mes tyre, është se njëra është forcë njerëzore, kurse, tjetra është forca e Allahut të Lartësuar. Nëse e le forcën absolute dhe bazohesh në ato, që nuk kanë as dobi e as dëm, atëherë, ajo do të jetë një injorancë prej nesh, dhe kjo, pastaj, do të ndikojë në iluzione të reja të ndryshme, që nuk do t'i përkasin të vërtetës. Këtë injorancë, e pasojnë ndjenjat dhe pasionet e jetës, sa për t'i realizuar dëshirat.

T'a shpjegojmë këtë pikë. P.sh. unë kam një pasuri, por ja që nuk kënaqem me kaq dhe dëshira ime është të arrij edhe më shumë nga ç'kam. Dua të arrij me çdo kusht, edhe pse është pa djersë dhe pa ndonjë mënyrë të zgjedhur. Jeta e kënaqësive, që më është treguar në Kur'an nga Allahu, nuk më duket jetë e mirë. Urdhërat 'mos vepro', më neverisin dhe nuk më pëlqejnë. Unë jam një individ në shoqëri. Kur unë pranoj pasurinë, e cila nuk më përket mua, me siguri që miliona njerëz të tjerë kanë të drejtë në pasurinë time.

Prandaj, Allahu ia ka ndaluar atij të kujdeset për mua. Sikur të isha ai, i cili do të planifikoja mirë, do t'a dija se pasuria e huaj, nuk do të më mbronte, sikur pasuria ime. Por ja që, unë dua që të kam pasuri të pashtetur. Këtu, shejtani është aktiv dhe vepron. Allahu na ka treguar brenditë e shejtanit, deri sa e njohëm. Por hiqem se nuk dëgjova dhe përqëndrohem në atë, që më thotë mendja ime, të pasurohem në çdo mënyrë. Në ç'mënyrë nuk është me rëndësi, rëndësi ka të pasurohem sa më tepër, që është e mundur, të kam pasuri të pa shtetur. Ky passion e bën njeriun të veprojë i kornizuar në vete, e bën egoist. Duke qenë se Allahu e dinte mirë këtë passion të njerit, Ai e pyeti mbarë njerëzimin (ose shpirtërat e tyre, para se krijoheshin për këtë botë. kom. i përkthyesit): "A nuk jam Unë Zoti juaj? (të gjithë u përgjegjën) Po, si jo ...". Ky lloj individi i kornizuar ose egoist më brengos, e ndiej atë, ashtu siç e ndiej ndëshkimin që më pret prej mëkatit të bërë. Gjithnjë jam munduar, me gjithë energjinë time, qoftë ajo edhe iluzionale, të mbrohem dhe njëkohësisht të përkujdesem ndaj atyre, që e lënë ligjin e Allahut, atyre që hamendja dhe epshi i udhëzon dhe shkojnë pas dëshirave të tyre. A mund të mendoj se ai, ose ky, mori rizkun tim, ose të vazhdoj t'a bindi veten padrejtësisht, se ky do të jetë personi, i cili do të më mbrojë nga dënimi i Allahut. Mundohem t'a qetësoj veten, duke ia larguar vetes zemërimin tim, që e ka kapluar mbarë njerëzimin me këtë vetëshkatërim, ose deri në atë masë, sa që jemi zhytur tmerrësisht në mëkate. T'a thjeshtëzoj këtë: Nëse e marrim një djalosh të bukur dhe ia sjellim misin e botës dhe i themi kjo vajzë sonte është e jotja. Por, në të njëjtën kohë, ia hapim derën tjetër dhe do t'i tregojmë edhe

zjarrin, dhe i themi atij: pas kësaj nate do të hidhesh në zjarr. A mendoni se ai do të bëjë mëkat? Me siguri, se jo. Por, përderisa ndëshkimi është i pavërejtuar, ne nuk e shohim atë, shejtani ndërhyr në brenditë e qenies njerëzore dhe mundohet t'a bindë atë, se nuk ka kurrëfarë dënimi. Ky iluzion, shndërohet në dëshirë emocioni dhe pasioni, sepse epshi e dirigjon atë. Pastaj edhe ia lejon vetes t'a dëmtojë tjetrin, ose ia merr të drejtën tjetrit. Kështu, personi, duke i arsyetuar dyshimet e veta, arrin deri te mohimi në ekzistencën e Allahut. Njeriun mëkatar, më së shumti, do t'a gëzonte, që dikush t'a siguronte atë, se Allahu nuk ekziston. Porse Allahu ekziston, dhe vetë dyshimi në ekzistimin e Allahut është dëshmi për ekzistencën e Tij, dhe kjo është edhe tema e kapitullit të ardhshëm.

DYSHIMI DHE EKZISTENCA

Islami ose është formuar nga akideja²² që nënkupton fenë, ose është formuar nga jo akideja, që do të nënkuptonte hipokrizinë. Për të filluar diskutimin, së pari, duhet të sqarojmë akiden.

Ajo është, si të thuash një çështje, që konsiderohet si maja e brumit të brumosur në zemër e që ai pastaj është ngjeshur shumë. Për ne, është një bindje e plotë, saqë ajo është bërë e pashuar, nuk zhduket, si dhe nuk pranon të polemizohet për të. Si e tillë, kuptohet se, është konsumuar hulumtimi dhe zbërthimi i saj, prandaj konsiderohet si çështje e mbyllur. Nëse ndodh, të pësojë goditje ose fillon të shuhet, hapet dhe sërish kërkon që të diskutohet dhe polemizohet, nga e para. Kjo gjendje, tregon se imani, ndër muslimanët, është i mangët. Kur arabët thanë: besuam, ja si ju kthye përgjigja atyre, nga Allahu i Lartëmadhëruar:

“Thuaj (o Muhammed): ju nuk besoni, por vetëm thuani, ne jemi bindur (në islam, pasi imani ende nuk ka hyrë në zemrat tuaja”²³ Imani është akideja, bindja e plotë e zemrës. Ajo nuk lejon të shuhet nga mendja përsëri Akideja s’e ka vendin tek ndjenjat e instiktit, ose në njërën nga instiktet e tjera të njeriut. Nuk mund t’i thuash dikujt, se po besoj që je para meje, kur ai është para teje. Po ashtu, nuk mund t’i thuash, se unë po besoj se kjo gotë është plot me ujë, kur ajo vërtetë është përplot me ujë, sepse është para syve të tu. Prandaj, imani këtu nuk e ka vendin. Vendi i imanit është sekret. Një gjë, që është e fshehur nga ti, nuk e sheh dhe do të arrish t’a kuptosh nga instiktet e tua. Për këtë arsye, ndodh që shpeshherë imani të shpjegohet si bindje, si diçka që mund të vërehet. Njerëzit shprehin, shpesh, duke thënë: jam i bindur, se kjo do të ndodhë, ose shprehja: kam besim, se kjo do të ndodhë, tamam kështu siç po të shoh ty para meje. E vërteta është, se ajo që do të ndodhë është sekret. Ajo mund të ndodhë, por mund

²² Doktrina ose ideologjia e besimit islam, gjegjësisht feja islame.

²³ Kur’an, Huxhuratë 14

edhe mos të ndodhë. Unë nuk mund t'a përkufizoj këtë, por e them nga bindja e imanit tim. Kështu edhe shprehem se, kjo do të ndodhë, ashtu siç po të shoh ty para meje, duke qenë se jam i bindur për sekretin.

Nëse këto, konsiderohen gjëra të vogla në botë, atëherë si mund të paramendohet imani, në All-llahun e Lartësuar. Bindja, këtu, duhet të jetë në shkallën më të lartë. Të adhurohet Allahu thuajse po e sheh, sepse nëse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty. Kur besimtari se ka të qartë, ose i përngjan shikimi, kjo duhet të jetë temë diskutimi. E pe, apo nuk e pe. Kur imani del nga rrethi i diskutimit dhe polemikave abstrakte, atëherë nuk mbetet asgjë për të diskutuar rreth imanit. Por, nëse ndodh që ai të jetë temë diskutimi dhe vazhdimisht është prezent në mendje, atëherë konstatojmë se imani s'është i plotë.

Atëherë ku mbetet esenca e diskutimit? Ajo do të sillet rreth argumentimit të ekzistimit ose mosekzistimit të Allahut të Lartësuar. Së pari, të shohim atë, i cili diskuton rreth ekzistimit të Allahut xh.sh. T'a pyesim. Cili ishte motivi që të shtyu ty, të mendoje në argumentet e ekzistimit të Allahut? Kush të ngacmoi dhe t'a mundoi trurin, për të sjellë argumente, për ekzistimin e Allahut? Pa dyshim, se aty nuk kishte ndonjë motiv, përveçse vetë ekzistenca e Allahut, sepse ti, Atë, e njeh nga natyrshmëria jote. Kjo, natyrshmëri, është prezent tek secili nga ne. Ata, të cilët, e besojnë, i binden Atij. Ata edhe veprojnë sipas udhëzimeve të Tij. Ndërsa, ata, të cilët, janë kryeneçë, megallomanë, të tillët vazhdimisht e ndiejnë dënimin e dhembshëm që i pret, sepse atyre kjo natyrshmëri i bren vazhdimisht dhe nuk i le të qetë. Kjo kryeneçësi, edhe pse mundohet t'i afrohet fesë së Allahut, ajo në realitet do t'a largojë më shumë, të paktën e bën të largohet mentalisht. E gjithë kjo, vjen si rezultat i parallogaritjeve të tyre të gabuara.

Pra, ai, i cili, mundohet t'a argumentojë ekzistencën e Allahut, ai në realitet ka vërtetuar këtë ekzistencë, pa patur nevojë për argument. Argument, për ekzistimin e Allahut, është vetë kërkesa për argumentimin e ekzistencës së Tij, ngase ajo është kërkesë për këtë argument. Angazhimi i mendjes në të, nënkupton se Allahu ekziston tek ne në natyrshmërinë tonë, se e ndiejmë, se e përjetojmë ekzistimin e Tij dhe, kështu, e kuptojmë se Ai ekziston.

Vetë ekzistimi i Allahut, ishte shkak i orvajtjes për të arritur tek argumenti. Kjo qëndron dhe do të vazhdojë të qëndrojë, deri në fund të të jetuarit, si lajmëtar për vetë ekzistencën e Allahut. Me këto argumente, ne, përpiqemi vetëm t'i zbardhim ose t'i kthjellim mendjet tona edhe më tepër. Sikur t'i studiojmë me vëmendje dërgesat qiellore, të reveluara nga Allahu, do të gjenim argumentet më të mëdha dhe temat më të fuqishme, të cilat do t'i përshtateshin mendjeve tona njerëzore dhe mundësive tona për të kaluarën, të tashmen dhe për të ardhmen. Do t'i gjenim, të gjitha këto, të shpjeguara shumë qartë dhe përplot mrekulli.

Nëse, përqëndrohemi mirë, në diturinë e Allahut, si dhe në arritjen e kësaj diturie

tek njeriu, do të shohim se kjo është një bashkim i fjalëve me mendje, ose ashtu siç tha i Lartësuari: "...dhe ia mësoi Ademit, të gjitha emrat." D.m.th. ia mësoi Ademit kuptimin e sendeve dhe emërtimin e tyre. Pastaj, Allahu i Lartësuar, i mblodhi melaiket dhe kërkoi prej tyre, që t'i tregojnë për kuptimin e sendeve ? Ata "dhe thanë: i Lartësuar, nuk kemi njohuri ne, përveç ato që na ke mësuar ..."²⁴

Prej kësaj nxjerrim: Cili duhej të ishte më parë: kuptimi ose sendi? Që të jemi më të qartë, ajo që ekziston në realitet, ajo është në ndërdije. Pastaj vjen fjala, për t'a nxjerrë atë kuptim në mendje. Nëse themi p.sh.: shtëpi, kjo thënie ka një kuptim, në mendjet tona. Ajo, nënkupton një vend, ku banojnë njerëzit, përbëhet nga disa dhoma, etj. D.m.th nëse përmendet fjala shtëpi, dhe kjo fjalë ekziston në magazinën e mendjes, atëherë do të ishte fjalë e pranuar. Por, nëse nxjerrim fjalë të pakuptimta, dhe ato nuk janë në magazinën e mendjes sime ose nuk jam i sigurtë që ato ekzistojnë, është njëlloj sikur një njeriu, i cili, ka jetuar tërë jetën e tij, në një rrafshirë dhe nuk ka parë kurrë male, t'i thuhet mal, ai nuk do të jetë në gjendje t'a përceptojë ose parafytyrojë këtë fjalë. Sigurisht, që edhe nuk do të kuptojë asgjë nga kjo shprehje, sepse nuk e ka dëgjuar, e as që është biseduar për të, më parë. Pra, ky, as nuk e kupton, e as nuk e njeh, sepse kjo fjalë, nuk i është deponuar më parë. Po, nëse i thuhet një njeriu, se kjo punë është bërë më mendje elektronike, ai nuk do të kuptojë për çfarë bëhet fjalë. Gjithashtu, nuk do të kuptojë se, cili është roli i kësaj mendje elektronike. Por, nëse dikush thotë Allah, të gjitha mendjet do t'a kuptonin, sepse kjo thënie, bart në vete një forcë ose fuqi madhore, që krijoi botën. Si e kuptojmë All-llhun, kur Atë s'e kemi parë? Ai, sikur mos të ishte në vet brendinë e natyrshmërisë sonë, ose sikur mos të ishte në mendjet tona, nuk do t'a njihnim kurrën e kurrës. Përderisa, kuptimi u internacionalizua, dhe iu përshtat qenies njerëzore, vetëkuptohet se Ai ekziston. Vetë bindja në ekzistimin e Allahut, buron nga Ai, që ne t'a kuptojmë këtë fjalë. Ekzistenca e Allahut në ne, është prej natyrshmërisë sonë, pra Ai, vetë, bëri që kjo fjalë të hyjë në mendjet tona. Asnjë fjalë, nuk mund të kuptohet, me përjashtim, kur kuptimi i saj dhe vetgjësendi, së pari, gjenden në mendjen e njeriut. Bile, ekzistimi i atij gjësendi, duhet të ketë ekzistuar para emërtimit të saj. Nuk mund të vazhdohet biseda me ndonjërin, nëse nuk të kupton kur atij i thua (mal ose i fuqishëm).

Ai do të të kuptojë, vetëm atëherë, kur ajo që thua, është e deponuar më parë në mendjen e tij, para se t'a shqiptojë fjalën. Më parë, ai kuptim, duhej të ekzistojë, e pastaj ajo t'i jetë i njohur atij.

Nëse i shfletojmë fjalorët e botës, do të vërejmë se çdo fjalë në të, përshkruan një gjësend, që ekziston. Këto fjalorë, vazhdimisht, rriten në sajë të emërtimeve të

²⁴ Kur'an, Bekare, 32

reja që zbulohen. Pra, një gjë, së pari, duhet të ekzistojë, e pastaj t'i vihet emri. Kjo, në jetën tonë të përditshme, është e vërejtur në çdo gjë. Kemi dijetarë të specializuar vetëm në këtë lëmi, detyra e tyre është të tubohen për unifikimin e gjuhës. Këta i fusin kuptimet ose i emërtojnë gjësendet, që gjendeshin kohë më parë, por që në realitet ishin të panjohura. D.m.th. së pari, duhet të ekzistojë gjësendi, e pastaj njeriu t'a emërtojë atë. Ekzistimi i emrit të Allahut të Lartësuar, në të gjitha gjuhët e botës, nënkuton se, Ai, ekziston në mbarë mendjet njerëzore. Ky, është një argument, se Allahu i Lartëmadhëruar, ekzistonte para, se të ekzistonte vet njeriu dhe para, se t'a shqiptonte gjuha e tij, duke mos patur këtu parasysh, se në cilën gjuhë shqiptohet.

Fjala Allah, kuptohet tek të gjitha mendjet, dhe në të gjitha gjuhët. Bile, mendja njerëzore, e pranon emrin e Allahut të Lartësuar, si kuptim të mendjes, që e njeh Atë nga natyrshmëria (brendia), edhe pse, Allahu, është mbi fuqinë mendore të njeriut. Tani t'i kthehemi edhe një herë shpalljeve qiellore, në versetin:

“Dhe përkujtoni kohën, kur Zoti yt morri nga prapashpina e (ose nga ijet) bijve të Ademit, pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmitarë të vetes së tyre (duke i pyetur ata). A nuk jam Zoti juaj? Ata u përgjigjën: Po gjithsesi, e dëshmuam (ngjarjen).(Kjo u bë me qëllim që) të mos thoni në Ditën e Kijametit, se ne ishim injorant ndaj kësaj (dëshmie). Ose të thoni, se prindërit tanë, më parë, ishin politeistë, kurse ne i pasuam paraardhësit tanë...”²⁵

Me këtë ajet Kur'anor, Allahu xh.sh., na vërteton neve, se si Ai është në brendinë tonë. Pra, është në natyrshmërinë tonë, edhe pse, kjo është mbi mundësinë e të kuptuarit tonë. Kështu, ne e njohim, Atë, në bazë të bindjes sonë. Kjo bindje, qëndron thellë në brendi, edhe pse, nuk na mësoi askush për të. Kur përmendet emri i Allahut, nuk na duket të jetë emër i panjohur, i pakuptimtë. Përkundrazi, shqiptimi i emrit të Tij, na është shumë i njohur, atë e ndiejmë nga thellësia jonë. Gjithashtu, e ndiejmë mundësinë dhe forcën e Tij.

Nuk do të kishte harmoni jeta, nëse Ai nuk ekziston. Analfabetët nuk lexojnë, e as nuk shkruajnë, mbase, gjatë jetës së tyre, nuk kanë lexuar edhe një fjalë të vetme, por, nëse i informon për diçka, që i përket kësaj bote, do të kishin pyetur: Ç'është ajo, për të cilën po flet, ne nuk po të kuptojmë asgjë? Do të ishte përjashtim, vetëm nëse ju përmendim atyre, emrin e Allahut të Lartësuar. Nëse lexohet ky emër, të gjithë do t'a njihnin, si analfabetët dhe alfabetët, i vogël e i madh, plak ose kushdo tjetër, që është prezent aty.

Pa dyshim, askush nga ata, nuk do të pyeste: ç'kuptim ka kjo fjalë, sepse të gjithë e kuptojnë. Pse ndodh kjo? Ngase, Allahu, gjendet në brendinë tonë, në vet natyrshmërinë tonë. Allahun e adhurojnë fëmijët, të paarsimuarit, të arsimuarit,

²⁵ Kur'an, Araf 172-3

akademikët etj. Të gjithë këta, mund të kenë probleme, rreth kuptimit të gjësendit, por asnjëri prej këtyre të sipër përmendurve, nuk ka problem, në të kuptuarit e fjalës Allah, ose në adhurimin e Tij. Nëse hyni në xhami, keni për t'i parë robërit e Allahut, të ulur së bashku. Të gjithë, janë të ndryshëm, si në moshë, ashtu edhe në mendje, në kulturë dhe në pozita shoqërore, në tradita, etj. Që të gjithë, të përkushtuar, veprojnë në harmoni të plotë, adhurimi është i përbashkët, ata qëndrojnë në ruku²⁶, në sexhde²⁷, ose duke lexuar Kur'an. Ata, së bashku, e Madhërojnë Atë. Këta, të gjithë, nuk do të bashkoheshin, nëse Allahu nuk do të ekzistonte tek ne, ose në natyrshmërinë tonë. Ose, më mirë, ashtu siç tha Allahu: “Dhe përkujtoni kohën, kur Zoti yt morri nga prapashpina e (ose nga ijet) bijve të Ademit, pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmitarë të vetes së tyre (duke i pyetur ata). A nuk jam Zoti juaj? Ata u përgjigjën: Po gjithsesi, e dëshmuam (ngjarjen)”.

Ata, të cilët, mundohen t'a mohojnë ekzistencën e Allahut, duke u munduar t'a mohojnë Atë, e vërtetojnë ekzistencën e Tij. Një gjë, që nuk ekziston, nuk ke se pse t'a mohosh. P.sh., disa thonë se toka është në formë të rrumbullakët, disa të tjerë, thonë se është e rrafshët dhe kështu fillon debati. Sikur të mos shihej toka se është e rrafshët dhe sikur mos t'a zbulonte shkencën se toka është e rrumbullakët, me siguri nuk do të polemizohet. Polemika, filloi, atëherë, kur dy palët mendonin se kishin të drejtë. Tani radha ishte e dy palëve që t'a vërtetojnë. Pra, realisht ajo ekzistonte, prandaj u diskutua dhe u polemizua. Nëse mendojmë t'a mohojmë teorinë shkencore, atëherë, së pari, kjo teori shkencore duhet të ekzistojë, se përndryshe, si do të mohohet? Ndryshimi, këtu, është në mohimin, kurse ekzistenca e saj, doemos, të ishte një realitet, në të kundërtën, debati do të kishte përfunduar vetvetiu.

Pra, orvajtja e mohimit të ekzistencës së Allahut, është, ngase, Ai, realisht ekziston, në të kundërtën, pse duhet të mundoheshin pabesimtarët t'a mohonin Atë. Orvajtja për t'a mohuar, dhe polemika, nuk do të mbarojë kurrë, nëse ai gjësend ekziston. Nëse, vërtetë, nuk do të ekzistonte asgjë, në ç'ka do të polemizohet. Kush do t'i detyronte ata, të mundohen në mohimin ose ekzistimin e atij gjësendi.

Dualizmi në ekzistimin e Allahut të Lartëmadhëruar, është vërtetim i ekzistimit të Tij.

Pa patur nevojë për argument, vet orvajtja për të grumbulluar argumente rreth dualizmit, në ekzistimin e Allahut, vërteton ekzistimin. Argumentim, mbi ekzistimin e Allahut, është vetë, kërkesa e argumentimit, për këtë ekzistencë. Angazhimi i trurit për Të, nënkupton ekzistimin e Allahut, që është në brendinë

²⁶ Ruku- qëndrim i obligueshëm në namaz, përkulje mes qëndrimit në këmbë dhe përkuljes në tokë.

²⁷ Sexhde- qëndrim i obligueshëm në namaz, përkulje duke i lëshuar gjunjët, duart dhe kokën në tokë.

tonë, që prej krijimit tonë.

Pra, përfunduar me këtë realitet. Allahu ekziston, brenda nesh, që në kohën e krijimit tonë. Atë, e ndien secila zemër njerëzore, edhe pse, ka prej atyre që e mohojnë Atë, Atij ata i frikësohen. I frikësohen Ditës së Gjykimit. Orvaten t'a mohojnë Atë, në realitet ata orvaten t'a mohojnë, dënimin që i pret ata. Gënjejnë, duke thënë ose supozuar, se ajo ditë nuk do të ndodhë kurrë. Orvajtja e mohimit vazhdon, nga frika e takimit me Allahun dhe nga dënimi, që iu është premtuar atyre. Vazhdojnë, ngase mundohen t'i qetësojnë vetvetet e tyre, nga dridhja e brendshme, që i kaplon dhe që ndiejnë për Ditën e Gjykimit. Orvajtja e tyre, për t'a qetësuar veten është iluzion, supozimi tyre se nuk ka Ditë të Gjykimit, i bën ata të grumbullojnë argumente kundër saj. Ata, vazhdojnë jetën e tyre në tmerr, derisa t'u vijë vdekja. Vdesin me ankth, duke mos qenë asnjëherë të qetë, të frikësuar ndaj së nesërme, që do t'i presë, pa marë parasysh, nëse kishin ditë të lumtura. Shoh të domosdoshme, të flasim edhe për programin e Allahut. Pse, disa njerëz, e lënë anash këtë? Mos vallë, programi Allahut, nuk përmban drejtësi, ose nuk jep harmoni mes njerëzve, bile mbarë njerëzimit? Shtrohet pyetja, a thua pse njeriu orvatet të gjejë rrugë të tjera për vete? Pse ikën nga realiteti, e mundohet të paraqesë programe të ashtuquajtura bashkëkohore, ose nganjëherë i quan teori bashkëkohore? Pse ikën nga rruga e All-llahut? Vërtetë, Allahu i Lartësuar, solli rregullat (kushte) për qenien njerëzore. Këto rregulla, nuk i solli për të mirën e ndonjë grupi të posaçëm, ato i solli për të mirën e mbarë njerëzimit. Por, ç'ti bëjmë lakmisë së njeriut, ajo duket të jetë e pakufi. Njeriu dëshiron t'i ndjekë instiktet e tij, edhe pse është në dijeni të plotë, se ato veprime janë në dëm të shoqërisë. Të supozojmë, instiktin e dëshirës për pasuri. Njeriu dëshiron të ketë në pronësi çdo gjë. Nëse bisedojmë me ata, që kanë pasuri dhe i pyesim, pse kanë kaq shumë pasuri, ose nëse i pyet: a munden t'a harxhojnë gjithë këtë pasuri, gjatë jetës së tyre, ose sikur edhe të kishin jetëra të tjera? Përgjigja e tyre, në të shumtën e rasteve, do të ishte: se është e pamundur, që t'a harxhojnë vetë ata.

Pason, pyetja e dytë. A mos vallë, do t'a merrni me vete, tërë këtë pasuri, pas vdekjes? Gjithashtu, përgjigja do të ishte: kurrësesi. Nëse, kjo është e pamundur, atëherë pse e gjithë kjo luftë, për këtë pasuri? Përgjigja është, qenia njerëzore edhe pse është e bindur se do të vdesë, mendon se jeta e tij do të vazhdojë vite të shumta dhe, për këtë arsye, i Dërguari Allahut, Muhammedi ﷺ, ka thënë: “Nuk kam parë bindje, që i përngjan dyshimit, më shumë se bindja e vdekjes”

Allahu i Lartësuar e qartësoi, shumë pastër, këtë instikt të pasurisë. Ndaloi armiqësinë ndaj atij, që posedon pasuri. Këtë e bëri për t'a mbrojtur, secilin individ në shoqëri. I obligoi ata, që t'i respektojnë të drejtat e tjetrit, ndaloi pasurinë e jashtëligjshme, ndaloi që të shfrytëzohet pasuria e të dobët, pasuria e jetimit, i cili nuk ka mundësi e as fuqi për t'a mbrojtur atë. Ndaloi vjedhjen, në përgjithësi. E gjithë kjo, u bë për arsye të mbrojtjes së përgjithshme. Të fortin,

e mbron në momentet e mundshme të ligjësimi të tij, dhe njëkohësisht, e mbron të fortin, duke qenë i fuqishëm.

Përmbajtja, duket se ka kundërthënie, por është reale. Nëse, Allahu më ndaloj mua pasurinë e huaj, atëherë ia ndaloj edhe të tjerëve, e ata të tjerët janë shoqëria mbarë, që t'a marrin hakun tim. Secilit, i dha atë që i takon. Ma ndaloj, t'a marr hakun e tjetrit edhe pse në moment jam i fuqishëm, kurse ai është i dobët. Kjo, u bë, për t'a mbrojtur atë nga unë.

Nëse mua, do të më kishte lejuar, Allahu, t'a marr pasurinë e të dobët, atëherë automatikisht, këtë, do t'ia lejonte edhe shoqërisë mbarë. Do t'u lejohej, qoftë me të drejtë ose jo, t'a marrin pasurinë time.

Këtu, e shohim drejtësinë e Allahut. Ai e mbron të dobët, prej të fortit dhe, njëkohësisht, e mbron të fortin nga shoqëria. Ligji është për të mirën e përgjithshme. Si për të pasurit, ashtu edhe për të varfërit. Si për të dobët, ashtu edhe për të fortit, pastaj caktoi mëshirën, bamirësinë si dhe bashkëjetesën vëllazërore, duke i obliguar të pasurit, që me pasurinë e tyre t'a ndihmojnë të dobët, dhe kështu që shoqëria do të jetojë në paqe. Me këto sjellje, xhelozia, urrejtja dhe problemet midis njerëzve, nuk do të zinin vend, përkundrazi, do të mbretërojnë mirëqenia, harmonia dhe vëllazërimi. Ky, është sheriat i Allahut të Lartësuar. Qëndron, haptaz, kundër lakmisë së disa njerëzve, të cilët, dëshirojnë të pasurohen pakufi. Akoma, pa e shijuar pasurinë, lakmojnë pasurinë e tjetrit, mundohen t'ia marrin atij, duke përdorur lloj-lloj mënyra, deri në nënshtrimin e tij. Por jo, Ai, solli rregulla për t'i mbrojtur këta njerëz nga vetet e tyre, prej lakmisë, e cila të udhëzon në shkatërrim, në këtë botë, si dhe në ahiret, po ashtu e mbron shoqërinë mbarë, që ajo shoqëri, të jetojë në harmoni të plotë dhe në paqe.

Nëse, tani, kalojmë në instiktin seksual, do të vërejmë se edhe këtu, Allahu xh.sh., duke mbrojtur individin, e mbron shkatërrimin e shoqërisë.

Tregohet se, një njeri erdhi tek i Dërguari Allahut ﷺ dhe i tha: Unë do t'a përqafoj islamin, por jam person që i dua shumë femrat dhe nuk mund t'a paramendoj veten të larguar prej tyre. A mundeni të më lironi mua? I Dërguari Allahut nuk e rrahu, e as nuk e përbuzi, e as nuk e dënoi atë. Ai, si mësues që ishte, dëshiroi që atë, t'a bindë me stilin e tij, ose me gjuhën që ai të mund t'a kuptonte urtësinë e kësaj, si dhe ligjin e Allahut. I tha atij, duke qenë shumë i qetë: “A dëshiron që dikush të veprojë kështu me nënën tënde? U panë shenjat e hidhërimit tek ai, dhe i tha: jo. Atij ju drejtua, përsëri, i Dërguari Allahut, duke i thënë: A dëshiron që dikush të veprojë kështu me nusen tënde? Me të shpejtë ia ktheu personi jo, jo! Atëherë, ai, i tha: Që të gjithë jemi të tillë, or vëlla arab.

Shohim se sheriat i Allahut është shkruar, si për mbrojtjen e nënës, motrës, vajzës dhe nuses së tij, ashtu edhe për të tjerët. Sikur t'i kujtohet, secilit person, në

momentin e kryerjes së mardhënies seksuale, se dikush tjetër do të vepronte kështu me nënën, motrën, vajzën ose nusen e tij, sikur të kishte vetëm pak seder, do të largohej nga ai veprim menjëherë. Pra, kur ligji godet instiktin, atë e kornizon me rregullat, të cilat shërbejnë për mbrojtjen e vet individit, nënës, motrës, nuses së tij, prej keqbërësve të mundshëm, si dhe mbron paraqitjen e tij. Njeriu, kështu, do të ishte më përparimtar, por në të njejtën kohë, ai, i cili, respekton ligjin, e mbron familjen nga shoqëria dhe njëkohësisht detyrohet, që ky të moskeqpërdorë familjet e tjetrit.

Këtu, del në pah drejtësia qiellore, për t'u thënë: jo, padrejtësive. Të gjithë jeni të barabartë, para Allahut. Nëse, ligji i Allahut, e mbron familjen dhe paraqitjen tënde, atëherë, Ai, gjithashtu e mbron edhe familjen dhe paraqitjen e tjetrit. Nëse e përbuz ligjin e Tij, qortohesh, e nëse e kundërshton, do të ndëshkohesh. Pse e gjithë kjo? Ngase, ti dëshiron turbullira dhe po bëhesh shkakhtar i prishjes së harmonisë në tokë.

Nëse, Allahu i Lartësuar, ia ndaloi njerëzimit thashethemet, atyre iua ndaloi edhe përgjuarjen e sekreteve. Këtë, e bëri, për të mirën tonë. Unë kam pjesët e turpshme, që nuk dëshiroj të m'i shohë askush, po ashtu edhe ti ke pjesë të turpshme, që nuk dëshiron t'ia tregosh askujt. Që të gjithëve, na vjen turp, t'i shohim pjesët e turpshme të tjetrit, ose dikush, duke mos qenë prezent, të përgojohet në ato vende, kur ai nuk ka mundësi të mbrohet.

Kemi njerëz, të cilëve nuk ju bëhet vonë, ia lejojnë vetes vjedhjen, por, tjetrit ia ndalojnë. Ia lejojnë vetes, t'a nënçmojnë dikënd, kurse nuk lejojnë, që dikush t'a nënçmojë atë. Dëshirojnë t'ia zbulojë sekretet dikujt, e përgjon, e keqpërdor. E, kur atij i ndodh, që vetë të përgojohet ose përgojohet, atëherë, sillet keq dhe nervozohet. Allahu i Lartësuar ju thotë: jo, që të gjithë jeni të barabartë tek Unë, jeni robërit e mi, Unë ju kam krijuar dhe Unë nuk bëj dallime. Nuk ia lejoj dikujt, atë çka ia kam ndaluar tjetrit, sado të jenë të fuqishëm përballë të tjerëve, që janë shumë më të dobët. Kur, Unë, iu ndaloj diçka, ajo vlenë për të gjithë, e kur t'ia lejoj dikujt, e bëj për të gjithë, qofshin ata, të dobët ose të fuqishëm, të varfër ose të pasur. Të gjithë ata, që mendojnë se pasuria, pamja ose pozita e tij, e bën të dalluar tek Unë, është i mashtruar.

Kjo, është drejtësia Hyjnore dhe ky, është programi i Allahut. Nuk bën dallime, për askënd, nuk ia lejon dikujt, diçka, e t'ia ndalojë, atë, tjetrit. Ai, me ligjet e Tij, ka për qëllim t'a mbrojë mbarë shoqërinë, pa marë parasysh, vendin ose pozitën e tij, në shoqëri.

Allahu na jep pasqyrën e një shoqërie të vërtetë. Solli rregulla, për një shoqëri të shëndoshë e të fuqishme. Kultivoi edukatë të pastër njerëzore, të fuqishme dhe të drejtë. Kjo nuk do argument, këtë e vërteton brendia njerëzore. Kështu, i mbron të drejtat njerëzore. Ai, nuk la të sundojë ligji i xhunglës, aty, ku dominon i forti

ndaj të dobët. Ai, e ngriti njeriun në shkallën e vet njerëzore, atë e lartësoi, pasi e dalloj prej krijesave të tjera.

I gjithë programi i Allahut, është ndërtuar për ngritjen dhe zhvillimin e tokësorëve. Ky është i Vetmi që mund t'a bëjë këtë, sepse është mbi të gjithë dhe më i dituri, nga të gjithë. Ky është Ai, që krijoi universin dhe nënshtroi çdo gjë, për të mirën e njeriut. Nënshtroi forcat, që janë shumë herë më të mëdha, se forca e njeriut. Për hir të njeriut, nënshtroi diellin, hënën, tokën dhe yjet. Këta i binden, pa patur mundësi tjetër të zgjedhjes, si dhe këto nuk posedojnë forcë, që të lejojnë ose të ndalojnë ndokënd.

Pra, Allahu, që Ai, i Cili, i krijoi të gjitha këto fuqi, pastaj i urdhëroi ato, që t'i nënshtrohen njeriut. Kjo forcë, nuk mund të krijohet nga njeriu. Njeriu, nuk është në gjendje të krijojë një tokë apo qiell, një diell ose hënë, as mbështjellësin atmosferik, e as gravitacionin e tokës. Nëse, qenka Allahu i Lartësuar, Ai, i Cili, krijoi të gjitha këto fuqi madhore, dhe i nënshtroi për të mirën e njeriut, atëherë, Ai, është në gjendje të na skicojë edhe rrugën e vërtetë të jetës së lumtur, në këtë tokë. Sado, të mundohet njeriu, ai, nuk është në gjendje të na skicojë rrugën e vërtetë të lumturisë, ashtu si Allahu i Lartësuar. Që të gjithë, ne, jemi të mangët ose të pamundur, para mundësive të Allahut. Sado të mundohemi të udhëzojmë në drejtësi, do të na sundojnë pasionet. Allahu nuk ka pasione. Kjo do të ishte drejtësi dhe rrugë e drejtë (siratil' Mustekim). Kur thuhet për diçka, se e ka thënë Allahu, duhet të kihet parasysh, se Ai është më i dituri, nga të gjithë ne. Atë dhe programin e Tij, duhet t'a dëgjojmë me vëmendje, duke mos e krahasuar, absolutisht, me programet njerëzore, të çfarëdo lloji qofshin ato.

Kur i pyesim disa persona, kush e krijoi jetesën? Thonë: Allahu. Cili i krijoi qiejt dhe tokën? Thonë: Allahu. Kur i pyesim, nëse kjo është e vërtetë, atëherë pse nuk e përfillni programin e Tij? Disa nga ata nuk dinë të përgjigjen, disa të tjerë thonë se kemi programet njerëzore, në vend të programit të Allahut. Kjo, pastaj, i detyron ata të përpilojnë idera të ndryshme dhe të hapin debate. Ne ju themi të gjithëve: ju po kundërshtoni vetet tuaja. Allahu është krijuesi i universit dhe jetës, në përgjithësi. Allahu solli programin e jetës sonë, sepse Ai vetë i ka krijuar këto. Si mund të braktiset kjo dhuratë e Allahut, e të lakmohen gënjeshttrat dhe udhëzimet e njerëzve, të cilët, i sajojnë sipas tekeve të tyre? Si të braktiset Ai, që di, e të pasohet ai, që nuk di? Si të debatohen ligjet e Krijuesit, me ato të të krijuarit, sikurse edhe unë!?

Baza, për ndjekjen ose pasimin e programit të Allahut, është besimi. Për këtë arsye, Allahu xh.sh., kur ju ligjëron robërve për programin e Vet, gjithmonë i jep theks të veçantë shprehjes "O ju që keni besuar". Këtë e përsërit, në shumë ajete të Kur'anit. Njeriu, për t'iu përmbajtur programit të Allahut, shtyllë kryesore duhet të ketë besimin tek pejgamberët, melaiket dhe sekretet. Nëse, nuk beson në to, atëherë, të tjerat janë të kota. Po, sikur, edhe të gjitha veprimet e tua, të jenë të

rregullta, nëse nuk beson (nuk ke iman) Allahun, e gjithë ajo veprimtari të shkon kot.

Këtë pikë, dua t'a sqarojmë pak më shumë. Allahu na ka urdhëruar që t'u ndihmojmë (përkujdesemi) fukarenjve. Ai që kujdeset për ta, duke qenë se është besimtar në Allahun e Lartëmadhëruar, do të shpërblehet nga Ai. Kemi edhe të atillë, që ndihmojnë të varfërit për propagandë, atij, i mjafton t'i thuhet bujar ose dorëllirë. I tubon fukarenjtë e i ndihmon ata, deri sa të bëhet objekt diskutimi, bujaria e tij. Në momentin kur atij i paraqitet nevojtari i vërtetë, ai e refuzon atë, sepse nuk është, në thelb, bujar. I tilli, vuan për pozitë dhe për reklamim, ai nuk vuan për bekimin dhe uratën e Allahut. Këta persona, Allahu nuk i shpërblen, edhe pse veprat e tilla, Allahu, i çmon dhe i vlerëson shumë. E bëri mirësinë, por pa besim, e bëri, por zemra tij është e zbrazët, nuk ka besim në të, për të tillin nuk ka domethënie asgjë, thirrja e All-llahut: "O ju që keni besuar". E njëjta, vlen edhe me personin që falet, sa për sy e faqe, para popullit, ai nuk shpërblehet për ato namaze, që i kryen, edhe pse ky njeri bëri një vepër, që All-llahu e kërkon prej robërve të Tij.

Allahu i Lartësuar, është më i pasuri, nga të gjithë ata, që e bëjnë shok. Nëse, dikush e bën një vepër, për hir të Tij, Ai e pranon atë. Nëse dikush, e bën për hir të njerëzimit, Allahu është i pasur, nuk ka nevojë për ata, prandaj, edhe nuk ia pranon atë, si vepër të mirë. Po sikur të jetë edhe një pjesë e veprës së tij, për hir të njerëzimit ose për pozitë të kësaj bote, Allahu nuk do t'ia pranojë. Allahu është i pasur dhe është mbi të gjithë botërat. Muhammedi ﷺ, thotë: "Çdo vepër varet nga vendosmëria (nijeti), secili do të shpërblehet sipas vendosmërisë së tij". Ky hadith²⁸ e qartëson edhe më tepër këtë lloj veprimtarie. Nijeti, e ka vendin e vet, në zemër. All-llahu i krijoi zemrat dhe, Ai, e di fare mirë, se ç'ka në to dhe çka fshehin ato. Ai, plotësisht, e di, por kemi njerëz, të cilët, mendojnë se një ditë do t'a mashtrojnë Allahun e Lartësuar, e kjo, pra, është katastrofa njerëzore.

Filozofët orvaten, derdhin shumë mund, humbin vite të tëra, vetëm për të treguar dhe vërtetuar se All-llahu ekziston. Angazhojnë trurin, në vend se t'a marrin atë të gatshme nga shpallja qiellore, të cilën Allahu i Lartëmadhëruar, ia zbriti qenies njerëzore.

Hulumtojnë, lodhin trurin për t'a zbuluar Atë, që ishte krijues i saj. Mendja ka detyrë, ose më mirë të themi, ka shumë detyra në jetë, por ajo, asesi, nuk është e detyruar të vërtetojë ekzistencën e Allahut. Kjo, është mbi fuqinë e saj, nëse nuk shërbehet me revelatat e zbritura nga Allahu, për robërit e Tij, ajo nuk e gjen rrugën. Allahu, i dërgoi këto revelata, për t'a ndihmuar mendjen njerëzore, si dhe të kenë argument për vetet e tyre. Këto i shërbejnë, prej ditës që i krijoi, deri në ditën e kataklizmës. Por ja, që kemi filozofë, të cilët duan t'ia tejkalojë Atij.

²⁸ Hadith- thënjët, tradita dhe pëlqimet e Muhammedit ﷺ

Mundohen t'i servojnë mendjes, gjëra të cilat janë mbi diametrin e mundësive të trurit të tyre.

Allahu neve na ka treguar: Ja, kjo është rruga e adhurimit dhe na e ka sqaruar atë. Na e bëri të qartë, se cila rrugë është e mirë dhe cila është e keqe. Krijuesi, këtë, e ka një argument të forte, para njerëzimit. Kemi njerëz që adhurojnë diellin, idhujt ose diçka tjetër, vetëm e vetëm, që t'a përjashtojnë besimin në Allah. Këto mësimet të kota, janë shkak, që revelata e Allahut, mos t'iu bie në dorë. Prandaj, këta, nuk do t'a dinë, se cila është rruga e vërtetë, për robërit e Allahut. Ne nuk kemi dëgjuar, që dielli të ketë dërguar peygamberë, për t'i udhëzuar njerëzit, edhe pse njerëzit e adhurojnë diellin. Gjithashtu, nuk kemi dëgjuar, që idhujt të kenë dërguar peygamberë, edhe pse njerëzit i adhurojnë idhujt, qofshin ato në formë skulpture ose qenie të gjalla, si kafshë etj. Me fjalë të tjera, çdo gjë, që i largon njerëzit nga e vërteta dhe i drejton drejt pasioneve të tyre.

Po t'a gjykojmë logjikën, si një tërësi dhe mendjen, si një tërësi tjetër, që të dyja nuk na orientojnë ne, nga gjërat që janë mbi mundësitë e të dyjave, së bashku. Duke e ditur këtë, njeriu, prapë se prapë, mundohet të futet aty ku nuk i takon, ai mundohet t'i thyejë të gjitha forcat ose pengesat, që e rrethojnë. Këtë e bën, nga injoranca e vet, ai nuk bazohet në parimet e veta, me drejtësi. Argument, i kësaj që thamë, është se ne nuk njohim ndonjë shkollë filozofike, të ketë ndonjë metodë, përveç metodës së metafizikës. Ose, diçka që të jetë mbi materien e të dalë jashtë materies, dhe me to, të mundohet të arrijë rezultatet e njëjta, të shkollave të tjera para tyre. Por, secila shkollë, sjell rezultate të kundërta prej shkollave të tjera. Asnjë, nga këto shkolla, nuk arriti rezultatin e njëjtë, që të paktën të ishte i pranuar nga mendja e njeriut.

Lidhja e njeriut, me botën e jashtme, bëhet nëpërmjet shqisave. Si gjallesë njerëzore, për të arritur dhe kuptuar, atë që e rrethon, i duhet të ndihmohet prej pesë shqisave të njohura:

Të dëgjuarit Të pamurit Të shijuarit Të nuhaturit Të prekurit

Me këto shqisa, ne e njohim botën e jashtme. Këto, kanë rol ndërmjetësues dhe na mundësojmë të dallojmë botën, bile edhe ia japim atributet ose karakteristikat, të cilat i nxjerrim prej tyre. Për shembull, ngjyrat i dallojmë me anë të shqisës së të pamurit. Me shqisën e shijimit, e shijojmë të ëmblën, të idhëtën, të mirën ose të keqen, etj. Pra, bota e jashtme, e cila na rrethon, kuptohet ose njihet, me anë të këtyre shqisave.

Por, cilat janë ato, që na lidhin me botën e brendshme të njeriut? Si mund të ndërlihdemi me to? Cila është ajo brendi? A bëhet ndërlihdja me anë të shqisave ose me diçka tjetër?

Disa njerëz i thonë intuitë ose aksiomë, disa të tjerë i thonë inspirim i veçantë, disa të tjerë e emërtonjë me emra të tjerë, e kështu me radhë. Një gjë është e

ditur, se kjo nuk shpjegohet me anë të pesë shqisave, të cilat shërbejnë për njohjen e botës së jashtme. Kjo arrihet me diçka tjetër, e cila siç thashë më parë, quhet si inspirim, intuitë, aksiomë ose ndjenjë e brendshme, etj.

Të bëhemi pak më studiozë rreth kësaj. Së pari, të fillojmë me shqisat, të cilat na mësojnë botën e jashtme. Njeriu sheh ngjyra të llojllojshme, dëgjon zëra të ndryshëm, prek elemente të ndryshme, shijon ushqime të llojllojshme, ndjen erëra të ndryshme. Kjo është lidhja e njeriut me botën e jashtme, kurse lidhja e tij me brendinë e tij, bëhet me anë të ndjenjës së urisë. Ne, urinë nuk e shohim, nuk e prekim, nuk e shijojmë, por e ndiejmë atë. Ç'ka pas urisë? Kemi, për shembull, dashurinë, urrejtjen etj. Njeriu dashuron, ose e urren ndonjë njeri, ose diçka tjetër, duke mos qenë, këtu, shkak ndonjë ndjenjë e njohur.

Pra, paskemi diçka edhe të brendshme. Ne na lejohej t'a ndiejmë atë, në mënyra të veçanta. Këto i ndiejmë, i njohim plotësisht, por ne nuk i shohim ato ndjenja. Sado të flitet ose të shpjegohet, për shkakun e dashurisë ose urrejtjes, nuk do të arrinim t'a njihnim, se çka solli deri te shkakun i ndjenjës së dashurisë ose të urrejtjes. Këto ndjenja, nuk janë në mesin e pesë shqisave të jashtme, për të na shpjeguar saktësisht, ose për t'a përcaktuar, këtë marrëdhënie ndërmjet njeriut dhe materies. Kështu që, dijetarët janë të kujdesshëm kur flasin për shqisat. Ato vlerësojnë lidhjen e njeriut me botën e jashtme, por, tek njeriu, gjendet edhe talenti, instikti, ndjenja, inspirimi ose edhe të tjera gjëra, që janë dhe ekzistojnë në brendinë e tij. Të gjitha këto, e lidhin njeriun me brendinë e tij njerëzore dhe, si të tilla, ndikojnë dukshëm në personalitetin dhe qenjësinë e tij.

Ne mundohemi t'i mohojmë ato, që nuk i nënshtrohen logjikës. Në brendinë e njeriut, ka edhe shumë gjëra të tjera, të cilat nuk janë shqisa, por, që e lidhin me botën e jashtme. Njeriu, mund të ndërlihet me botën dhe me brendinë e tij, pa ndikuar njëra prej shqisave të sipërpërmendura, të njohura si ndërmjetësuese. Ç'është e vërteta, inspirimi, ndjenjat ose sensibilizimi, janë brenda qenies njerëzore. Këto ndjenja, ekzistojnë para asaj, që na rrethon nga bota. Foshnja, për shembull, ndjen uri ose etje dhe ato i prezanton, duke qarë, para se t'i përdorë shqisat e saj, që e lidhin me botën e jashtme. Duke qenë foshnje, ajo ndien ngrohtësinë, dashurinë, urrejtjen, vrazhdësinë, mëshirën, të gjitha këto, janë prezent, që në minutat e para të jetës së saj. Kurse, në anën tjetër, shqisat, duhet të presin disa javë, që të aktivizohen dhe të plotësojnë nevojat e shumëduhura të foshnjës.

Nëse, studiojmë brendinë dhe këto ndjenja të brendshme, do të gjejmë, se prej ndjenjave më të fuqishme, është ndjenja e ekzistimit të Allahut. Kjo ndjenjë, mbase, është e tillë, që përmban një precizitet të jashtëzakonshëm, që i përket madhështisë së Allahut të Lartëmadhëruar dhe forcës së Tij. Kjo ndjenjë e mbikalon forcën e Universit, si dhe të gjitha ato ekzistanca, të këtij lloji. Kjo ndjenjë, e vërteton ekzistimin e një forceje të brendshme të njeriut, e cila, e

motivon atë t'a ndiejë ekzistimin e Krijuesit të Lartësuar.

Emrin e Allahut, nuk mund t'a njohin pesë shqisat. Ai është më i madh, se mundësia e tyre. Atë, mund t'a njohë ndjenja, e cila është në brendi të njeriut, ajo ndjenjë, që nuk shihet. Pra, fjala Allah, është mbi mundësitë e pesë shqisave tona. Kur, veshi dëgjon diçka, ne e kuptojmë atë, por ai nuk mund të dijë se ç'ka në brendinë e qenies njerëzore, për të gjykuar diçka, që neve nuk na është e qartë plotësisht. Atij, i është disi i njohur, por që ne nuk e kuptojmë, e as nuk jemi në gjendje t'a zbërthejmë atë, por na është i njohur. Kur dikush na e përkujton emrin e Allahut, menjëherë deponia e mendjeve tona, thotë se, ky emër, sinjalizon një fuqi të jashtëzakonshme. Tregon se, kjo forcë ka krijuar botërat dhe është mbi mundësitë e mendjes sonë, si dhe jashtë fuqisë së shqisave tona.

Atëherë, si t'a njohin ekzistimin e kësaj force? Si mundet, që ky emër, të jetë mbështjellur tek ne, kur kjo forcë është jashtë rrethit të shqisave dhe mendjes sonë? Këtu, përfshihen fuqitë që janë në brendi, si inspirimi dhe ndieshmëria. Ato na thonë se, kjo fuqi, edhe pse është mbi mundësitë e mendjes dhe shqisave, ajo ekziston në brendinë tonë, prandaj njeriu ose qenia jonë, e kupton dhe e ndien ekzistimin e Tij.

Qysh në kohërat e vjetra, filozofët janë marrë me metafizikë. Këtu, do të kisha veçuar filozofinë antike të grekëve. Hulumtimet e tyre, kishin dalë nga sfera e materies, ata hulumtonin rreth krijimit dhe forces, që qe shkaktare, për ngritjen e kësaj bote. Ata, nuk u morën vetëm me këto hulumtime, por merreshin edhe me shumë hulumtime të tjera, që patëm rast t'i njohim nga librat e filozofisë. Ky përkushtim, na bën kurioz të pyesim, a thua, kush ju tha atyre se duhet t'a studiojnë botën, jashtë kësaj materie? Kush ju tha, se gjendet diçka tjetër, jashtë kësaj materie, dhe këtë, domosdoshmërisht, duhet t'a studiojnë? A thua, si e kuptuan ata, se ka diçka jashtë materies, kur shqisat nuk na sinjalizojnë një gjë të tillë? Me këtë, nuk kemi për qëllim të hapim diskutimin dhe të polemizojmë filozofët grekë. Nuk kemi për qëllim t'i vlerësojmë shkollat e tyre filozofike, cilat prej tyre ishin të sukseshme, e cilat jo. Kjo, nuk na intereson aspak. por, ajo që ne do të na interesojë është pyetësi, çka i motivoi filozofët grekë të hulumtojnë ose studiojnë metafizikën?

S'do mend. se ata i ka motivuar dikush, por cila ishte ajo fuqi e brendshme e motivimit? Duke qenë se fjala është për metafizikën ose jomaterien, ata, me siguri, nuk i ka motivuar e as ngacmuar ndonjë nga shqisat e njohura të materies, që kjo pastaj t'i detyronte në këtë lloj hulumtimi.

Njeriu, që në agim të historisë, ose më saktë, që nga fillimi i krijimit të tij, është marrë me metafizikën. Atë e shpjegonin në mënyra të ndryshme, pastaj ata dinin, nganjëherë, edhe të merrnin kahje të ndryshme. Kishte raste, që asaj edhe t'i nënshtroheshin, ose, drejtëpërdrejtë, edhe t'a adhuronin këtë forcë të metafizikës.

Por, ajo që është më me rëndësi, për ne, këtu, është se kjo paraqet ndjenjën e njeriut, se atë diçka e bren thellë në brendi. Kjo brendi, sikur i thotë atij, ose sikur e inspiron atë, duke i thënë: jashtë kësaj bote, ka edhe diçka tjetër!? Ajo, është një fuqi e papërshtatshme dhe madhështore. Secili njeri, e ndien në brendinë e vet, ekzistencën e Allahut. Ai, prezencën e kësaj fuqie e ndien dhe e sheh, se është jashtë këtij rrethi, jashtë universit. Me siguri, se në vetë brendinë e njeriut, do të jetë një element, që e motivon atë, për t'a njohur dhe kuptuar se kjo botë, me gjithë hapësirën rrethuese, që ne e vërejmë, nuk mundet të qëndrojë pa një fuqi madhore, e cila, është në gjendje t'a udhëheqë botën me precizitet kaq të madh.

Bota, në të cilën ne jetojmë, rrethohet prej materies. Atëherë, si mundet kjo të krijojë elemente të tjera jashtë materies? Shqisat nuk mund të na thonë, se prapa kësaj, është një forcë tjetër shumë e fuqishme, që është në gjendje të shkatërrojë çdo gjë. Përderisa, materia nuk jep këto rezultate, atëherë, me siguri, duhet të ekzistojë një forcë tjetër, jashtë kësaj materie, e cila, e solli këtë parandjenjë.

Kjo, gjithashtu, na mësoi se kemi gjëra, që janë në kundërshtim me materien, prandaj, duhet hulumtuar rreth saj. Ky ishte edhe fillimi i të menduarit rreth kësaj fuqie. Sikur të mos ekzistonin këto ndjenja në brenditë tona, dhe sikur mos të ishin të forta, atëherë, këto nuk do t'i studionim. Por, faktet, flasin se këto studime, sa vijnë e shtohen, dita më ditë, gjatë historisë sonë njerëzore.

Kemi edhe një vështrim tjetër, të cilin e vlerësoj se duhet regjistruar. Kur njeriu fillon të mendojë ose të studiojë ekzistencën e Allahut, ose në momentin kur ai mendon në fuqinë madhore, që është mbi këtë univers, ai, me siguri, duhet të jetë në moshë. Ai duhet të ketë kaluar një kohë bukur të gjatë të jetës së tij. Në të shumtën e rasteve, njerëzit që fillojnë të mendojnë hollësisht për këto gjëra, duhen së paku të kanë një moshë prej njëzet deri tridhjetë vjetë. Ata duhet të jenë të pjekur dhe të gatshëm të debatojnë për këto gjëra.

Pyetja, e cila del si imperativ i kësaj teme, do të ishte, me çfarë logjike kanë adhuruar këta njerëz Allahun, para se të arrijnë në këtë moshë? Si t'a kuptojë filozofia, kur mendja e njeriut, paska nevojë për pjekuri e dituri më të madhe. Duheshka, pra, t'i rreket studimit, të ketë mbështetje për të arrirë në një njohuri shumë të vogël, dhe pas kësaj njohurie, do të kuptojë diçka nga metafizika. Kemi njerëz ose mendje të thjeshta, që nuk kanë lexuar asnjë libër, si dhe nuk kanë mësuar mbi materien ose metafizikën, por e njohin ekzistencën e Allahut. Ata, e adhurojnë Atë me bindje, gjithashtu vërejmë se këta, nuk janë njerëz që hapin polemika, ata, absolutisht, as edhe nuk debatojnë rreth kësaj teme. Këta, e pranojnë ekzistimin e Allahut, i luten Atij, dhe tek ta, nuk vërejmë asnjë kundërshtim. Jetojnë sipas mënyrës së tyre, në harmoni të plotë dhe nuk vërejnë ndonjë dis'harmonie mes kësaj bote dhe ekzistencës së Krijuesit të Lartësuar. Shumica e tyre, e ndiejnë harmoninë, brenda natyrës së tyre edhe pse shumëçka iu është e panjohur. Allahu i Lartësuar dhe prezenca e universit, për ta, janë dy gjëra

të patjetërsueshme. Prezenca e të dyjave është një realitet në brendinë e njeriut.

Përderisa na qenka në brendinë tonë, ajo që e vërteton ekzistencën e Allahut, atëherë prej nga është prezent ky zemërim në botë? Pse dolën shumë rryma ose shkolla të kundërta mes vete? Pse, disa njerëz, orvaten t'a vërtetojnë ekzistimin e Allahut, në njërën anë, kurse, të tjerë, mundohen t'a mohojnë këtë ekzistencë? Vërtet, cili është shkaku i të gjitha këtyre kundërshtimeve të çuditshme, që po i shohim, kur qenia njerëzore, në natyrshmërinë e vet, e bart njohjen e ekzistimit të Allahut?

Thënë realisht, këto ndodhin, sepse e tëra kjo, është produkt i pasioneve njerëzore dhe i të gjithë atyre, që mundohen të thellohen në këto tema. Në vend të logjikës, shërbehen me supozime dhe iluzione. Kurse në vend të mendjes, sjellin parafytyrimet. Kështu, mendja njerëzore e mundon veten së koti, duke u thelluar në gjërat, që nuk janë kompetencë e saj. Ato janë shumë më të mëdha, se ç'mundet mendja të kuptojë. Si e tillë, ajo bëhet e stërngarkuar. Kur ndodh që, ajo duhet të vlerësojë diçka që është në kompetencën e saj, ajo nuk është në gjendje t'a bëjë atë dhe kështu nuk mund t'a prezantojë dëshirën e vet nga stërngarkimi saj dhe kështu përfundon në imagjinata të ndryshme ose fantazira.

Mendoj, se duhet këtë t'a sqaroj pak më ndryshe. Mendojmë sikur e mbyllim derën e dhomës, në të cilën jemi duke qëndruar. Pas pak, dëgjojmë një trokitje. Secili prej nesh, është i vetëdijshëm se dikush trokiti në derë, dhe ai është përjashta saj. Kjo është mundësia jonë e parë, nëse shkojmë me këtë logjikë, deri këtu jemi në rregull dhe nuk kemi kurrfarë kundërshtimi. Por, nëse do të fillojmë të pyesim, thua kush trokiti në derë? A thua është mashkull apo femër? A thua është i gjatë ose i shkurtër? A thua është i bardhë ose i zi? A thua është arab ose joarab? Kur fillojmë t'i shtrojmë këto pyetje, atëherë këtu fillon debati dhe kundërrthëniet. Pse kjo? Kjo, tani, vjen si rezultat i hamendjeve, imagjinatave, parafytyrimeve tona. Po sikur të përdornim logjikën, nuk do të kishim debate ose polemika.

Kjo, është ajo, që ndodh me shumë njerëz, që lëshohen në këtë fushë të të menduarit dhe imagjinojnë Allahun. Duke qenë se, kjo lloj imagjinate, është jashtë kalibrit të mendjes njerëzore, atëherë ata sillen rreth një rrethi vicioz. Për t'a imagjinuar gjësendin, ai ose ajo, duhet të jetë një diçka, që i përngjan gjësendit, që e pranon mendja e njeriut. Kur dikush dëshiron të shpjegojë formën e diçkaje dhe të tjerët nuk e kuptojnë, atëherë ai detyrohet t'iu drejtohet atyre duke ju thënë: Shikoni, ajo psh. i përngjan toptshit. Me këtë ai e kalon, këtë parafytyrim, nga jashtë mundësisë së mendjes së njeriut, në mbredinë e saj. Më pas, njeriu fillon t'a parafytyrojë atë formë. Por, Allahu nuk është kështu, Ai nuk i gjason askujt. Kështu, çdo gjë që thonë filozofët, i përket kapitullit të imagjinatës, imagjinatë, e cila, nuk mund të kuptohet me mend dhe nuk mund t'i nënshtrohet logjikës. Nëse, në këtë rast, do t'a eliminonim logjikën, nuk do të kishim kundërshtime.

Sepse, Allahu i Lartësuar, na paralajmëroi Vetë, na tregoi atë, që ne duhet dhe duam t'a dimë. Sa duhet në fakt ne t'a njohin Atë, dhe sa do t'i mjaftojë kjo krijesës njerëzore? Nëse futemi në njohuri më të thella, nga kjo që na u dha, atëherë do të kishim kaluar mbi mundësitë tona njerëzore dhe kështu do të zhytësim thellë e më thellë, deri në humbje.

Por, sikur t'ju përmbaheshim fjalëve të Allahut, do të kishim një logjikë të shëndoshë. Pra, ajo, që e vërteton ekzistencën e Allahut është prezente, që në natyrshmërinë dhe në zemrat tona, sikur që e kemi edhe mënyrën e adhurimit dhe respektimit të Allahut. Çdo gjë, që duam të dimë për Të, është në Dërgesat e Tij, të cilat i dërgoi përmes të dërguarve të zgjedhur. Logjika thotë, se ne duhet t'i përcjellim këto dërgesa, kurse imagjinata thotë, se ne duhet të hulumtojmë. Nëse, ne vendosim të ndjekim imagjinatën, ose atë që është mbi mundësinë e mendjes sonë, do të humbim edhe pse i kemi dërgesat e Allahut të Lartësuar, si argumente të mëdha për ekzistimin e Allahut.

Këtu, dua të përkujtoj, një ajet shumë të rëndësishëm, që theksohet në Kur'ani Kerim: “Ne do t'u bëjmë atyre të mundur, që t'i shohin Shenjat Tona në univers, si dhe në vetet e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ky (Kur'an) është i vërtetë...”

Pse nuk tha i Lartësuari, se do t'u bëjmë të mundur t'i shohin shenjat në tokë, në vend të universit? Ne e dimë mirë, se Kur'ani është tejet preciz në thëniet e tij, prandaj duhet të shohim se në ç'kuptim na paraqitet.

Me këtë, i Lartësuari, na ka paralajmëruar, se do të vijë një kohë në të ardhmen, që njeriu do të ketë mundësi të hulumtojë edhe në gjithësi-univers. Jo vetëm kaq, por, mbase, do të shkojë edhe më tutje, që të dijë gjëra që nuk i dimë edhe në ditët tona të tanishme. D.m.th se Allahu do të na zbulojë edhe shenja të tjera, jo vetëm në tokë, por edhe në univers, së bashku me tokën. Mbase, arritja e njeriut në hënë dhe orvatja e tij për të arritur në Mars, si dhe orvajtja e zbulimeve të tjera në univers dhe tokë, e vërtetojnë këtë ajet Kur'anor. Disa nga ata, që janë thelluar në shkencë, harrojnë ose hiqen se harrojnë, se e tërë kjo dituri është nxjerrë për njeriun, nga dëshira e Allahut të Lartësuar. Kemi disa njerëz, që mundohen me filozofira rreth adhurimeve, duke i shpjeguar si produkt i enërgjisë së mendjes. Kështu, orientalistët orvaten të fusin huti tek njerëzit rreth Kur'ani Kerimit dhe thonë se, Allahu, thotë: “Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi”, “Ngado që të ktheheni, andej, është Allahu”²⁹

Nëse Allahu është në çdo vend, në lindje, në perëndim ose: ngado që të kthehesh andej e ke Allahun, kjo, a nuk kundërshtohet me përcaktimin e vendit, gjatë drejtimit në namaz?

Kjo është një çështje e besimit, dhe kjo prej çështjeve shumë të mëdha. Është një

²⁹ Kur'an, sure 2 - el Bekare; ajeti 115.

shtyllë, me të cilën njihemi me Hyjninë. Meqë, dituria e Allahut është mbi të gjitha dituritë dhe përderisa, besuam në Allahun dhe iu bindëm kësaj fuqie të madhe, do të ishte e drejtë Hyjnore, që të na trasonte rrugën më të mirë dhe të drejtë. Atëherë, t'i do t'a pasoje këtë rrugë, përderisa ka rrjedhur nga Allahu i Lartësuar. Kjo është një çështje e besimit (imanit) dhe bindjes. Kjo është, ashtu siç thamë, se mundësia nuk është e barabartë, ashtu siç nuk është e barabartë edhe dituria. Por, që të dyja sillen ndërmjet mundësisë së Allahut dhe mundësisë së diturisë së njeriut. Besimi në Allah, është shtylla kryesore e tij dhe bindja në hyjninë. Për këtë arsye, Allahu solli çështjen e kibles.

Me vendin e kibles³⁰ besimtarin nuk e ngarkon asgjë. Drejtimi i tij, drejt lindjes ose perëndimit, si dhe drejtimi djathtas ose majtas, besimtarin nuk do t'a vështirësojë gjatë namazit. Ai nuk mundohet gjatë kërkimit të tij, në drejtim të perëndimit në vend të lindjes. Ai, mundin e njëjtë, kishte për t'a dhënë gjatë kthimit të tij.

Të shohim një prej ajeteve të Allahut, i Cili, tha në Kur'ani Kerim, për kiblen: “Do t'u thonë, disa njerëz mendjelehtë: “Çfarë i ktheu ata (muslimanët) prej kibles, në të cilin ishin ata...”³¹

Me këtë ajet, këtu dua t'ju përkujtoj një gjë shumë të rëndësishme. Përdorimi i shkronjës ES ose S-in në arabishte, parapërcakton vetëm kohën e ardhme. Pra, tregon për një kohë, që do të vijë. Nuk mund të përdorim kohën e ardhshme në të shkruar, e të kemi për qëllim të tashmen. Ajo vepër nuk duhej të kishte ndodhur, por koha e ardhme, paralajmëron kohën, e cila, do të vijë dhe do të ndodhë.

Allahu i Lartësuar, në Kur'an, paralajmëron se: do t'u thonë disa njerëz mendjelehtë, kjo, d.m.th., se këta njerëz ende nuk kanë thënë, por, ata do të thonë, atëherë kur muslimanët do të kthejnë drejtimin e kibles. Paralajmëron se këta njerëz janë armiq të kësaj feje.

Ata vazhdimisht përpiqen të futin huti dhe dyshim në të, ata imagjinojnë dhe pastaj propozojnë mendimet e tyre të kota, për ndonjë ngjarje si edhe të kësaj tani. Prandaj, i Lartësuari, paralajmëron se do t'u thonë disa njerëz mendjelehtë. Allahu i cilësoi ata, para se ata të paraqisnin imagjinatat e tyre, para se t'a thërrisnin popullin në këtë mendjelehtësi. Para se t'ju thonë besimtarëve dhe pejgamberit për këto prapësira, pra, Çfarë i ktheu ata (muslimanët) prej kibles”.

³⁰ Kible - kur njeriu drejtohet në namaz, ai kthehet drejt kibbles. Vendi ose pika tjetër e segmentit, në të cilën drejtohet adhuruesi gjatë faljes. Pika tjetër është në Mekë, ose më saktë, në xhaminë e Qabes.

³¹ Kur'an, sure 2 el Bekare, ajeti 142 (Pasi emigroi Muhammedi s.a.v.s, muslimanët faleshin në drejtim të xhamisë Aksa, në Jerusalem, ngase Qabja vazhdonte të ishte brenda përplot idhuj. Me zbritjen e këtij ajeti, Muhammedi a.s.v.s., u këshillua të drejtohet drejt Qabes. Shënim i përkthyesit)

Kjo, na bën të kuptojmë se Allahu i Lartësuar i sfidoi këta pabesimtarë, dhe këtë, duke i paralajmëruar, se do të ndodhë një gjë e tillë, duke qenë se ata ishin të lirë në veprimet e tyre, për të mos thënë. Atyre iu tha se do të thonë, dhe, ata, të cilët do të thonë ato thënie, janë mendjelehtë. Këtu qëndron mrekullia. Mrekullia është pikërisht këtu, ngase, këta pabesimtarë, ishin të lirë të thonin ose mos të thonin. Plus kësaj, këta njerëz, i etiketoi si mendjelehtë, ky ishte një cilësim poshtërues. Kur'ani, pra, është Libër, me të cilin shprehim adhurimin tonë deri në ditën e fundit - kataklizmës. Ai, mbetet i pa ndryshuar, ai nuk zëvendësohet, e as plotësohet.

Ç'kishte për të ndodhur, sikur këta njerëz, mos të thonin, ose mos të pyesnin për kthimin e drejtimit të kibles? Skandal. Mospërgjigja e tyre do t'a shkatëronte Kur'anin dhe fenë. Pra, kjo ishte një thënie shumë madhore, për sa i përket besimit-Imanit . Por, ja, ajo kohë erdhi, ata thanë se Muhammedi, në librin e tij, i cili i "revelohet" nga Allahu, tha se do të vijë njerëz, të cilët janë emëruar si mendjelehtë, ç'u bë me ta dhe me muslimanët dhe ndërimin e kibles së tyre. Askush nuk pyeti, e as nuk u ndikua me këtë temë, që të gjithë t'a dinin se ky libër nuk është shpallje nga Allahu dhe se kjo fe është e Muhammedit.

Përderisa, Allahu është predikues dhe Ai është veprues, Ai bëri që të vërtetohen kundërshtarët e Kur'anit dhe të Muhammedit ﷺ, duke u bindur në realitetin e tij.

Kur, Allahu i Lartësuar, thotë se do të thonë mendjelehtë, për kthimin e drejtimit të kibles, prej xhamisë së Aksasë (Jerusalem), në xhaminë e Mekkes - Qabe, me këtë paralajmëroi se ata, pa dyshim, do të kundërshtojnë, para se të flasin, edhe pse ata janë paraqitur si njerëz të ligë dhe mendjelehtë. Këta pabesimtarë, vërtetë, do të kundërshtojnë Kur'anin, si vërtetësi e asaj, që u tha nga Fjalët e Allahut. Këta. do të orvaten të futin huti, vazhdimisht, në këtë fe. Këta nuk ndryshuan asgjë, ata vetëm sa i vërtetuan thëniet e Allahut, në Kur'ani Kerim, që ishin të paralajmëruara. Njëkohësisht, bënë që vetë kundërshtarët, t'a vërtetojnë këtë fe, duke mos qenë në gjendje t'a ndryshojnë zgjedhjen e tyre, edhe pse kishin mundësi dhe alternativa të tjera.

Pra, ndërimi i kibles, konsiderohet mrekulli madhore, tek besimtarët. Allahu i Lartësuar, me këtë, i sfidoi, "Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi", konsiderohet si një tjetër mrekulli. Kjo, gjithashtu, paralajmëron se feja islame do të shpërndahet në mbarë rruzullin tokësor. Ithtarët e kësaj feje, do të falen nga shumë drejtime të ndryshme. Dikush, do të falet nga lindja, tjetri nga perëndimi, dikush nga veriu e dikush nga jugu. Që të gjithë, do të drejtohen drejt kibles, e ajo është Qabeja (shtëpia e Allahut). Namazi do të jetë në rregull, si për atë, që është drejtuar në drejtimin e Kibles, si për atë, që mendon se është drejtuar drejt kibles, e në realitet, drejtimi i tij është i gabuar (jo qëllimisht-përkth.). Kështu, kuptohet namazi në aeroplan, në anije edhe pse aeroplani dhe anija gjatë faljes mund t'a ndërojnë drejtimin e kibles. Qëllimi i drejtimit tonë drejt kibles, ka për qëllim

unisonin e muslimanëve dhe drejtimin e tyre drejt shtëpisë së shenjtë të Allahut. Kuptim edhe më të madh do të kishte, bindja në Allahun e Lartësuar, si Hyjni e vetme. Për shembull, një prej ritualeve të haxhit, është puthja e gurit³², gjuajtja e (shejtanit) me gurëz tek disa shtylla³³. Me këto veprime, ne nuk i nështrohemi ose bindemi mendjes, ose logjikës sonë, por, në këso raste, ne i jemi bindur urdhërave të Allahut, jemi të bindur dhe besojmë se aty ka Urtësi, përderisa Ai i ka urdhëruar.

Duke qenë në këtë gjendje, njeriu i përket njëres prej tre situatave, që janë:

Njeri besimtar, që përcjell çdo gjë, që thuhet nga Allahu i Lartësuar, për vërtetësinë e Hyjnisë së Tij, si dhe të vërtetat, mbi formën e adhurimit ndaj Tij. Kur janë në pyetje nënshtrimi në All-llahun xh.sh, vërejmë se Kur'ani Kerim iu drejtohet besimtarëve e jo njerëzimit. Allahu, në Kur'an, asnjëherë nuk thotë: O ju njerëz! Bëjeni këtë, e mos e bëni këtë. Por Ai, iu drejtohet duke thënë: O ju që keni besuar (o ju besimtarë)! Ju drejtohet, këtyre njerëzve, ngase, këta, e dinë dhe e njohin madhësitinë e Allahut. Këta e dëgjojnë, i ndjekin thëniet e Allahut, ashtu siç e ndjek i sëmuri kurën e mjekut më të mirë në botë, duke mos e kundërshtuar për barërat. Ai, asesi nuk e kundërshton atë, bile, e dëgjon me shumë vëmendje, se si t'i përdorë ilaçet. Ai, këtë e bën, nga bindja dhe respektimi i diturisë së mjekut.

Njeri kafir³⁴ ose pabesimtar. Ky person ka lirinë e vet, është i lirë të bëjë çfarë të dojë, ngase për të, fjala 'mëkat' nuk ekziston. Nuk ka mëkat, meqë ka mohuar Allahun xh.sh. Ky është i barabartë me atë pacient, i cili, i copëton recetat dhe të gjitha udhëzimet e mjekut, të cilat, ia ka shkruar për kurimin e tij. Të gjithë shprehin keqardhje për të, por, tek e fundja, nuk kanë se ç'ti bëjnë, ai me vetë dëshirë e dëmton veten. Nëse nuk beson, bën ashtu si t'a merr mendja.

Njeriu, i cili, ka besim në vetëdijen e vet, ai është i përkushtuar, që me anë të dijes së vet, të arrijë deri në nivelin e diturisë së Allahut të Lartësuar. Për ne, edhe ky është i humbur, pasi do të dërmohet gjatë tërë jetës së vet dhe, në fund, nuk do t'a arrijë, as për së afërmi, diturinë e All-llahun të Lartësuar.

Kjo është një nga çështjet më madhore të besimit (imanit). Allahu ia lehtësoi mendjes së njeriut jetën, pasi na dërgoi të deleguarit e Tij (pejgamberët). Me këtë lehtësim, na sqaroi, rrugën e mënyrës së jetesës, në këtë planet.

Por kemi shumë njerëz, që e refuzojnë këtë mëshirë të Allahut të Lartësuar. Këta, preferojnë t'a lodhin trurin dhe vetëveten e tyre dhe, në fund, nuk mundën të arrijnë në asnjë rezultat.

³² Është fjala për Gurin e Zi, i cili është në një nga cepet e Qabes. Puthja nuk është e domosdoshme.

³³ - Aty, ku ishte parë shejtani, duke e mashtruar Ismailin a.s.

³⁴ Kafir – (në shqip: Qafir) njeri, i cili, e mbulon të vërtetën. Këtu, aludohet për personat, të cilët e njohin Allahun, por nuk e shprehin, duke e injoruar Atë.

Një prej çështjeve shumë madhore të imanit, është bindja në Allahun e Lartëmadhëruar, nënshtrimi i njerëzve në adhurim dhe përgjegjësi. Kjo, nuk ka alternativë tjetër. Allahu i Lartësuar, bëri që, imani, të jetë provimi i qenies njerëzore, dhe, njëkohësisht, nënshtrim në All-llahun xh.sh. Ai na thotë: po qe se, vërtetë, besoni dhe më adhuroni, dhe deklaroheni se: Nuk ka Hyjni tjetër, përveç Allahut, atëherë kjo nënkupton, se kjo është ajo rruga e pranimi të urdhërave, si p.sh. vepro ose mos vepro. Ky besim dhe bindja jonë, e ka edhe lirinë e përzgjedhjes, kjo do të vazhdojë derisa të zgjatë ky iman në zemër. Nëse, vërtetë, më keni besuar për Zotin tuaj, dhe si Krijuesin tuaj, atëherë duhet të vazhdoni jetën tuaj, ashtu siç Ua kam skicuar rrugën. Kur ne e adhurojmë Allahun xh.sh., ashtu siç Ai dëshiron, ne nuk duhet t'i përzihemi në përligjeje. Ne konsiderojmë, se mendja jonë është në rrugën e Atij, që është më i ditur se ne dhe, Ai, na mëson si t'i lutemi Atij. Duhet t'a dallojmë dhe të jetë e qartë se, Ai Krijues është Allahu, e ne jemi robër të Tij.

Mbase, ndërimi i kibles, ishte provim i imanit tonë. Të drejtuarit tonë, kah lindja ose perëndimi, nuk e ngarkon dhe rëndon besimtarin. Allahu i Lartësuar thotë: "...dhe Kiblen, nga e cila ti ishe drejtuar, nuk e bëmë për gjë tjetër, përveç se të dimë (provojmë) se cili do t'a pasojë të dërguarin (Muhammedin ﷺ), nga ata, të cilët e braktisën rrugën e tij (duke mos ju bindur të Dërguarit).

Vërtetë, edhe pse ,kjo ishte gjë e madhe (si dhe e vështirë), përveç atyre që i udhëzoi Allahu. Dhe Allahu nuk do t'ua humbë besimin³⁵ tuaj. Vërtetë, s'ka dyshim se Allahu ndaj njerëzimit është Dhurues i Mirësive dhe Mëshirëplotë."

Shumica, që polemizojnë Imanin, nuk sjellin argumente për pohimet e tyre. Ata gjithnjë i shmangen polemizimit të Dërgesës, ose rrugës, të cilën e skicoi Allahu xh.sh. për robërit e tij. Njëri prej tyre, mund të shprehet: Ky Kur'an, nuk ka mundësi të jetë nga Allahu xh.sh, por këtë, që e shpreh dhe e thotë, nuk mund t'a vërtetojë dhe argumentojë. Kështu nuk e informoi Allahu i Lartësuar, por, gjithashtu, këtë lloj refuzimi, asnjëri, nuk e ka argumentuar, për gjithçka që thotë, por mbështetje ka supozimin e tij, që është bazuar në hamendje të tij. Mundohet t'a realizojë qëllimin e vet, duke ikur nga sheriati i Allahut, në një sheriati tjetër njerëzor. Kjo është mbi mundësitë e së drejtës së tij.

Gjithashtu edhe shumë të tjerë ngurojnë aty, ku nuk është e drejta e tyre. Disa i tradhtojnë njerëzit, orvaten të përfitojnë popullaritet, për këtë, ata sjellin hipoteza dhe teori të shumta, edhe pse ato nuk janë zbuluar shkencërisht. Shohim duke propaganduar teorinë, se, gjoja, njeriu e ka prejardhjen prej majmunit. Kjo teori

³⁵ Besimin tuaj – Meqë namazi është një shtyllë shumë e fortë e islamit dhe meqë, mosfalja e namazit ditor është në mes besimit dhe jobesimit, Allahu xh.sh., në vend të fjalës: namazin tuaj, e përdori shprehjen: besimin tuaj. Pra, fjala e sipërpërmendur në ajet, e ka kuptimin namazin tuaj. Allahu na faltë, nëse jemi gabim.

është bazuar në supozime. Ai, i cili, e thotë këtë, ai nuk është dëshmitar i transformimit të majmunit në njeri, gjithashtu nuk është në gjendje t'a transformojë majmunin në njeri. Me këtë njeri, do të debatoja në këtë mënyrë. O ti njeri, eja këtu dhe më trego a e ke dëshmuar transformimin e majmunit në njeri? Do të thotë: jo. A mos vallë dëshmove krijimin e njeriut? Do të përgjigjet: jo. A mos e ke dëshmuar krijimin e majmunit? Gjithashtu do të thotë: jo. A ke mundësi ta transformosh majmunin në njeri? Do të thotë: jo. Atëherë ku bazohesh ti me këtë teori? Do të thotë: me vrojtime dhe hamendje.

Atëherë, të debatojmë, sipas vrojtimeve dhe hamendjeve. Teoria e evolucionit është sendërtuar në bazë të hamendjes, ajo, si e tillë, është e papranuar ose, përndryshe, le të na thonë ata, a mundet njeriu të bëjë dallimin e një vremçthi nga vremçthi tjetër, ose në mes një kali me kalin tjetër, të të njëjtit lloj, ose në mes një majmuni dhe majmuni tjetër. Përgjigja e tyre me siguri do të ishte: jo. Por ky, do të ishte në gjendje t'a bënte dallimin e njeriut dhe milionave të tjerë, edhe pse të gjithë ne jemi të krijuar në të njëjtën formë. Që të gjithë ne, kemi sy, veshë, gojë, duar, këmbë, e të tjera. Një formë e njëjtë, si edhe ato forma të kafshëve, në aspektin shtazor. Por, secili njeri, ka pamjen, që e dallon nga miliona njerëz. Kur dëshiron t'a dallojmë një njeri, në mesin e milionave të tjerë, themi se ky është Aliu, ky është Ismaili, kurse kjo është Fatimja, e ky këtu është babai, kurse kjo tjetra është motra, etj. Kush është ai, i cili dalloi njeriun nga njeriu tjetër? Nëse krijimi është sipas teorisë së evolucionit, atëherë, kush e bëri dallim shtazor? Ai, i cili, e bëri këtë dallim, është All-llahu i Lartësuar, për t'a drejtuar këtë jetë, të cilën e skicoi. Bëri dallime në këtë botë, për t'u përgjigjur në botën tjetër. Sikur, mos të kishte dallime në mes njerëzve, jeta do të ishte e pamundur dhe e paorganizuar. Do të ishte e pa mundur të dëshmohej për veten në botën tjetër. Allahu dalloi njeriun me një precizitet të fuqishëm, derisa edhe poret e gishterinjëve ia bëri të ndryshme, në mes miliona krijesave.

Që prej fillimit e deri në fund, fytyra e një njeriu nuk përsëritet me fytyrën e një njeriu tjetër. Mbase, argumenti më i miri do të ishin fytyrat e mbretërve, të cilët kanë lënë këtë tokë dhe vdiqën para disa shekujsh. Do të jemi në gjendje ta dallojmë pamjen e Ramsesit, Kleopatrës ose Napoleonit, nga njerëzit e tjerë të gjallë. Edhe pse, ata kanë vdekur shumë më parë, dhe vazhdon përsëritja e pasardhësve të tyre, pamjet e tyre nuk përsëriten. Kjo bëhet, ngase njeriu duhet të njihet dhe të japë llogari, sipas pamjes së tij. Ky dallim, kaq preciz, është një mrekulli në vetë, dhe kjo nuk mund të ndodhë nga vetë zhvillimi evolucionar ose rastësisht, por është vepër e mrekullueshme e Allahut dhe fuqisë së Tij. Ajetet e Tij, të cilat ia shpalli njeriut, janë ato, të cilat vërtetojnë thënjet e Allahut të Lartësuar: “Ne do t'u bëjmë atyre të mundur, që t'i shohin Shenjat Tona në univers, si dhe në vetet e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se, ky (Kur'an) është i vërtetë...”

Bile, mendja e njeriut, e vendosur nga Allahu xh.sh., në një pjesë të vogël të trupit, është e përbërë nga miliarda qeliza nervore. Këto miliarda qeliza, veprojnë në mes grindjeve dhe sulmeve të ndryshme, si dhe mbrohen. Në këtë gjendje, ato japin edhe sinjale.

Kemi tre mijë tubacione kapilaresh, të cilat shijojnë ushqimin. Ato japin shenja, nëse është i ëmbël ose i idhët. Secila ngjyrë, ka shijen e vet, në ushqim. Nëse i afrohem i zjarrit, do të bërtisnin trishtueshëm tridhjetmijë qeliza të kokës: “kujdes” dhe, në moment, do t’a ndienim zjarrin, të cilit iu afruam. Kjo mrekulli, nuk është e mundur të plotësohej nga zhvillimi evolucionar. Dallimi i jashtëzakonshëm dhe shumë i madh mes njerëzve dhe krijesave të tjera, argumenton përsosmërinë e Krijuesit. Kjo Fuqi e Mbinatyrshme, mori një grusht dhe, pastaj i tha atij: ‘bëhu’ dhe u bë ky njeri, i cili jeton sot në tokë. Pastaj, ky njeri, ndërton dhe jeton, ngrihet, zhvillohet dhe, si rezultati i përparimit të tij, iu mundësua të shkojë në Hënë. Shiko se çfarë mundi të bëjë ky njeri, dhe çka do të mund të bëjë në të ardhmen. Do të arrish të kuptosh, se ç’bëhet nga një grusht dheu, pasi të ketë ndikuar ndihma dhe fuqia e Allahut.

Njeriu, në brendinë e vet, ka enigma. Gjithçka që zotëron, Allahu i Lartësuar, nuk ia zbuloi njeriut të një gjenerate. Në të shumtën e rasteve, njeriu nuk e kupton as veten e vet, ai nuk ka arritur thellë në brendi të sekreteve të tij. Karakteri i njeriut, edhe sot, vazhdon të jetë enigmë e madhe tek shkencëtarët dhe hulumtuesit. Kemi disa ligje të njohura për ne, ato edhe më tutje na sundojnë. Si bëhet me ato ligje, që nuk janë të njohura ende për ne, dhe sundojnë në sjelljet tona? Për shembull, kur njeriu dashuron, nuk e di pse dashuron. Ndoshta, individit që e dashuron, nuk e meriton atë mirënjohje. Mund të jetë njeri shumë keqbërës, si dhe mund të ketë sjellje, të cilat nuk na pëlqejnë, bile të jenë të urryera, megjithatë dikush e dashuron. Dashuria dhe urejtja janë të ndieshme, truri njeriut nuk i kupton ligjet e tyre. Bile, në të shumtën e rasteve, në to, ka gjëra që janë në kundërshtim të plotë me logjikën dhe arsyen. Emocionet dhe ndjenjat, tek qenia njerëzore, janë përplot përplasje të çuditshme. Ato, shpeshherë, janë logjike dhe kemi prej tyre alogjike, ato sakrifikohen dhe kanë egon e tyre. Ato, në brendi, kanë enigmën dhe do të mbeten enigmë.

Nëse qenia njerëzore është enigmë, ne, nuk jemi në gjendje t’a kuptojmë atë. Në të, është natyrshmëria dhe, këtë, të gjithë e ndiejmë. Kjo natyrshmëri është lidhja ose ndërmjetësimi mes kësaj qenie, me Allahut të Lartëmadhëruar. Ai gjendet në ne, sipas natyrshmërisë sonë. Atë e njeh fëmia, i riu dhe plaku. E njeh intelektualit dhe jointelektualit. Këta, nuk arrijnë të bashkëveprojnë në njohjen e një gjësendi mes vete, por pa dyshim që të gjithë e ndiejnë dhe e kuptojnë fjalën Allah. Edhe pse të ndryshëm në njohuri, zemrat e njerëzve dridhen, kur e dëgjojnë fjalën Allah. Allahu i Lartësuar, i thërret emocionet tona, të cilat ne nuk i njohim, por ato janë në dijeninë e Allahut. Njerëzit më të gëzueshëm, janë ata, që janë të qetë.

Këtyre, Allahu, iu dha qetësinë dhe harmoninë, në këtë botë dhe tjetrën. Ata jetojnë në harmoni dhe në qetësi, në sajë të thënieve të Tij, drejtësisë, fuqisë, mundësisë, diturisë dhe ekzistimit të Tij. Janë të qetë, ngase janë të bindur në ekzistimin e Allahut dhe ahiretit³⁶.

Janë të njoftuar me këtë botë surrealiste, e kuptojnë realen nga jorealja dhe i janë bindur ndihmës së Allahut të Lartësuar, për ata që zgjedhin rrugën e drejtë. Janë të bindur në parapërcaktimin e Allahut, si një e mirë. Atë që e jep, është e mirë, gjithashtu, atë, që ndalon, është e mirë. Ndalesa, nga Ai, është mëshirë, sepse na largon nga të këqijat ose na mbron prej tyre.

Parapërcaktimi i Allahut, për këtë lloj qenie, si në lejime ashtu edhe në ndalime, është për të mirën e tij. Kjo qenie, beson në Allahu xh.sh., sepse i mbron ata, që e besojnë Atë, dhe besojnë se, Allahu, i do të gjithë robërit e Tij besimtarë. Allahu është Mëshirëplotë në Gjykimin e Tij me besimtarët. Nuk ka mizor, që mund t'i shmanget drejtësisë së Allahut, si dhe, nuk ka diktator, që e tejkalon mundësinë e Allahut, gjithashtu, nuk ka zullumbërës, që t'i shpëtojnë dënimit të Allahut.

Në të shumtën e rasteve, njerëzit i shohin gjërat, nga një shikim tjetër. Çdo ditë, shohim padrejtësi dhe tirani të shumëllojshme. Po vërehet se tirania, po e kaplon planetin tokë. Pyesim, ku është drejtësia e Allahut? Por, thënë, realisht, zemrat na janë ngushtuar, kemi presion të brendshëm, sepse një pjesë, nga Urtësia, është e fshehur për ne. Ishte dëshira e Allahut, që edhe këtë, të na e shpjegojë, për t'a parë dallimin, në të shumtën e rasteve, mes ndodhive të dukshme dhe atyre të vërtetave. Kjo temë, do të shtjellohet në kapitullin e ardhshëm, rreth sinjaleve të kaptinës Kehf (shpella).

LIGJËRIME RRETH SURES KEHF (SHELLA)

Kur flasim, për Kur'ani Kerimin dhe kuptimet e tij, sygjeroj që, në të shumtën e rasteve, të jemi shumë të vëmendshëm, në Urtësitë e disa ajeteve, gjatë leximit. Ndodh, shpesh, që leximin t'a kemi sipërfaqësor dhe, kështu, na kalojnë shumë gjëra të rëndësishme pa i vërejtur. I kalojmë ato, pa i parë, edhe pse jemi urdhëruar të jemi të kujdesshëm për të.

Kjo, nuk do të thotë se, Kur'ani, në vetvete përmban shumë kuptime. Disa dijetarë, për t'a mbrojtur atë, në koherencë, ose duke u munduar t'i vërtetojnë mrekullitë e Kur'anit, mundohen të gjejnë ngjashmëri, ose lidhje, ndërmjet disa teorive shkencore, të cilat ia verbojnë sytë njerëzve, dhe disa prej ajeteve të Kur'ani Kerimit.

Rreziku qëndron tek teoria shkencore, ajo, në vete, mund të bartë vërtetësinë

³⁶ Ahiret – jeta e amshueshme, e përhershme (në xhennet ose në xhehennem).

gjithashtu edhe mosvërtetësinë e saj. Çfarë do të bëhej sikur, ajo teori shkencore, të bierë poshtë pas një kohe? Disa dijetarë të tjerë, sjellin argumente të tjera dhe vërtetojnë se ajo nuk ishte teori e vërtetë. Cili do të ishte qëndrimi jonë? Nuk duhet që, në asnjë mënyrë, të përshpejtojmë në vendime, gjithsesi të jemi larg emocioneve, kur të hulumtojmë, ajetet Kur'anore, të cilat mundet t'i përshtaten teorive shkencore bashkëkohore, ose t'u përngjajnë atyre.

Atë që desha t'a potencoj, është se Kur'ani Kerim, është libër fetar e asesi shkencor, ose dituri tokësore. Kur'ani nuk na shpjegon teoritë teknike, e as rregullat medicinale, etj., por Allahu i Lartësuar, që në fillim të këtij libri, pra, në fillim të kaptinës të sures el Bekare, na tregoi qëllimin:

“Elif – Lam – Mim. Ky është libri, në të cilin, nuk ka asnjë dyshim, është udhëzues për Muttekinët (ata, që i frikohen Allahut dhe ata, që janë të devotshëm). Të cilët, besojnë të fshehtën, e kryejnë faljen (namazin) dhe prej saj, që Ne ju kemi dhënë, ata japin (zeqatin-sadakën dhe japin lëmoshë, etj.)”

Pra, në fillim të kësaj sureje, si dhe, në fillim të Kur'anit, Allahu i Lartësuar, na bëri me dije, se ky libër, është për përdhje të atyre që e besuan.

Konsideroj se, kjo ishte një hyrje, pa të cilën nuk ia vlente, para se të fillonim ligjërimet rreth sures Kehf (shpella).

Ata të cilët studiojnë Kur'ani Kerimin, duhet gjithsesi të mbështeten në fjalët e Allahut të Lartësuar. Ai, ka sjellë fjali në ajete, që janë shumë të fshehura. Prandaj, nuk duhet të nxitojmë dhe t'i kalojmë ato ajete, shkel e shko. Nëse, sot do të flas për sinjalet e sures Kehf, kjo na jep të kuptojmë se, këtu duhet të jemi të vëmendshëm dhe shumë preciz. Para se të fillojmë fjalimin rreth disa ajeteve të sures Kehf, ne do të përqëndrohemi pak rreth emërimit të kësaj sureje. Emri saj është Kehf – Shpella. Ç'kuptojmë pra me fjalën shpellë? Ajo është një vrimë, ose një hyrje e futur në mal – kodër. Dëshira Allahut xh.sh., ishte të kemi shumë shpella, për t'i parë ato, për t'i ndier e për t'i dëshmuar ato.

Pra, shpella na ishte një vrimë, e futur në mal. Duke qenë jashtë shpellës, a do të dije se ç'ka brenda në të? Përgjigja do të ishte: jo. Gjithsesi, së pari, duhet të futesh brenda, e pastaj të fillosh hulumtimet dhe, në fund, të dalësh me rezultatet përfundimtare të asaj shpelle. Pra, së pari, ishte emri i kësaj sureje, që nuk duhej t'a kalonim, ashtu thënë, shkel e shko. Allahu xh.sh., bëri shumë shpella kuptimore. Gjërat, të cilat na fshihen nga realiteti ynë, në gjithësi dhe univers, gjithashtu ngjarjet e Musasë a.s.me Hizrin³⁷, ose me njeriun, të cilit Allahu i kishte dhënë dituri. Është fillimi i një tregimi, qëllimi i së cilit është që, ne, mos t'i anashkalojmë gjërat. Përmbytja e anijes, e cila ishte në duart e të vobektëve, ishte

³⁷ Hizri, në arabisht është Khidr. Emri i një njeriu, i cili është theksuar në Kur'an, si Njeri i Mirë dhe shumë i ditur, i cili vazhdimish i shprehte falenderim Allahut, për atë dituri, që ia kishte dhënë.

një vepër e shëmtuar, nëse do të gjykonim nga pamja e jashtme. Realiteti ishte krejtësisht ndryshe, ajo u shpëtoi, atyre, anijen nga uzurpimi i mbretit tiran i kohës së tyre. Ashtu si ishte edhe vrasja e fëmijës, por, në kuptim e gjërë, ishte përkujdesje dhe mbrojtje e prindërve të tij të mirë, duke ju dhuruar një fëmijë tjetër të pastër e të mirë. Ata, u mbrojtën ngase ishin të mirë, se përndryshe, ai do t'i bënte të dilnin nga feja. Ashtu si dhe riparimin e murit, që ia bëri popullit të një fshati. Ata të dy, kishin kërkuar ushqim nga fshatarët, por ata refuzuan t'ju japin ushqim këtyre dy udhëtarëve të huaj e të uritur. Këto veprime, nuk i pranon logjika e shëndoshë, por ja, që ai e bëri atë, për shkak se e dinte që muri i përkiste disa jetimëve, ati i të cilëve u kishte fshehur atyre një thesar para se të vdiste. Ai e riparoj murin, që fshatarët mos t'ua merrnin thesarin atyre. Ky riparim, do të qëndronte derisa jetimët të rriteshin, e pastaj ata vetë t'a nxirrnin atë thesar. Sikur të shkatërrohej muri, në kohën kur jetimët ishin të vegjël, do të dilte në shesh thesari dhe do t'ua merrnin atë.

Për këtë do të flas më gjërësisht. Këto ajete nuk mundemi t'i shpjegojmë me kaq rreshta të shkurtër. Me këtë desha të sinjalizoj se, kjo sure është e një rëndësie të veçantë. Dëshira e All-llahut xh.sh ishte që të zbulojë, në këtë sure, disa nga vërtetësitë e fshetësirave për ne. Mendja e njeriut, vetë, nuk do të arrinte t'i kuptojë ato. Po ashtu, dëshira e Tij, ishte që, ne, mos t'i anshkalojmë gjërat, duke i gjykuar ato s'i të dëmshme për ne e, në realitet, është e kundërta e saj.

Ç'KUPTOJMË ME FJALËN SHPELLË

Shpella, për të cilën Kur'ani Kerim tregon këtë ngjarje, është një shpellë, që ka ekzistuar në të vërtetë. Në të hynë disa besimtarë. Kjo shpellë, atyre, iu shërbeu për t'u fshehur, ngase kishin ikur, për arsye se ishin besimtarë. Frikësoheshin mos t'i shkatërronin fizikisht pushtetarët mizorë të asaj kohe. Këtu, do të ligjëroj për tri gjëra, të cilat do t'a sqarojnë kuptimin. Këto, tri gjëra, ishin të panjohura në kohën së revelimit ose zbritjes së Kur'anit Kerimit. Allahu, këtë dituri, ia shpalosi mendjes së njeriut, pas revelimit të Kur'anit.

Tregimi i Lekës së Madh – sunduesit të dy mbretërivve (lindjes dhe perendimit). Në këtë ligjërim, tema e diskutimit, nuk është rreth vetë Lekës, e të tregojmë se kush ishte personaliteti tij. Kur'ani, nuk ka për qëllim të përcaktojë tregime rreth personaliteteve. Përcaktimi i vetë personit, ndodh që t'a prishë rëndësinë e ngjarjes, si dhe, nëse për shembull, orvatemi të flasim rreth personave, që ishin në shpellë, ose kush ishte faraoni i Musasë, ose kush ishte Karuni, e të tjerë nga personalitetet e theksuara në Kur'an. Atëherë, me siguri, do të humbej realiteti për të cilën, Allahu dëshiron të na tregojë. Këta persona, në histori, përmenden në shumë vende, si dhe në shumë periudha kohore. Shpeshherë, këto tregime, dalin të kundërta, në periudha të ndryshme kohore. Ajo varet nga koha dhe mënyra e

përhapjes së propagandës, gjithashtu bëhen edhe përshtatje të fjalëve që qarkullojnë, ose ashtu si i pëlqen ndonjë klani t'a tregojë vetë ngjarjen, ose të tregojnë kohën dhe vendin e ndodhjes, si dhe ku gjenden.

Kur Allahu na sjell shembuj, për ata, të cilët nuk e besuan Atë, psh. gruan e Nuhut a.s. ose gruan e Lutit, Allahu nuk ka për qëllim vetëm këto gra, qëllimi është për të gjitha gratë, që i tradhtojnë burrat e tyre të mirë. Ose, shembullin e gruas së faraonit, me të ka për qëllim të gjitha gratë e mira, që burrat e tyre janë pabesimtarë. Për të gjitha ngjarjet, që përsëriten gjatë historisë, emrat e tyre nuk janë përcaktuar. Kurse ngjarjet, që nuk përsëriten, emrat e tyre janë përcaktuar, si p.sh. ngjarja e Merjemes. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar, thotë: “dhe Merjemja, e bija e Umranit”, e përcaktoi emrin, ngase ajo ngjarje nuk përsëritet.

Tregimi i ngjarjeve në Kur'anin Kerim, nuk nënkuton se ajo ngjarje përfundon, me përfundimin e ngjarjes së atij personi. Pra, kur ne flasim për Dhulkarnejnin (sunduesin e dy mbretërive-lindjes dhe perendimit³⁸), flasim për njeriun, i cili kishte dhunti, nga Allahu xh.sh., për çdo gjë, prandaj e udhëzoi për rrugëtim, e këtu nuk është fjala rreth personit, se kush në të vërtetë është Dhulkarnejni, ose gjërat më pak të rëndësishme. Të gjitha këto, tek ne, nuk çojnë peshë.

Tani, të shohim një ajet shumë të rëndësishëm, që ka të bëjë me Dhulkarnejnin. Allahu thotë: “Derisa arriti në lindjen e diellit (aty ku dukej se po lindte, ose më saktë, deri tek populli më i largët, në lindje, që përjetonte vuajtjet e parisë së tyre), vërejtë se, ai lindte tek një popull, që Ne nuk iu kishim dhënë atyre mbulesë nën të (diellin)”.³⁹

Këtë tregim, do t'a ndërpresim këtu, sepse kemi për qëllim diçka tjetër. Në këtë ajet Kur'anor, Allahu i Lartësuar, nuk përmend asgjë tjetër, përveçse Dhulkarnejnin, i cili kishte arritur tek një popull, të cilëve nuk iu kishte dhënë Allahu mbulesë, në mes tyre dhe diellit.

Shumë njerëz, lexojnë ajetin pa vërejtur asgjë. Mendja e njeriut duhet pak të ndalet në këtë ajet dhe të pyesë. Çfarë na mëson ky ajet? Nëse lodhemi së menduari pak, vërejmë se Allahu na paralajmëron se, atje diku larg, është një popull, të cilëve nuk iu ka dhënë mbulesë, midis tyre dhe diellit. Çfarë kuptojmë nga kjo? Cili është qëllimi i Allahut xh.sh., të na tregojë se, atyre nuk u ka dhënë mbulesë poshtë diellit? A thua, nënkupton që ajo tokë të jetë e rrafshtë, pa drunj për t'u strehuar ose mbuluar nga dielli? A thua nënkupton se, ata nuk kanë shtëpi banimi për t'u strehuar nga dielli? Apo, mos vallë, ata janë lakuriq e nuk kanë rroba për t'u mbuluar.

³⁸ Fjala Dhulkarnejn, përveç kuptimit të poseduesit të dy brinjëve (njeri, i cili njihet se kishte një kapelë me dy brinjë), ka domethënien e poseduesit të dy mbretërive – lindjes dhe perendimit.

³⁹ Kur'an, Kehf 90,91

Të gjitha këto konstatime, do t'i shkonin ndërmend njeriut. Por, realisht thënë, që të gjitha këto, nuk parakuptojnë të jenë mbulesë e njeriut nga dielli. Dielli është prezent, kur ata do të dalin nga shtëpitë e tyre, gjithashtu do të jetë prezent, kur ata do të dalin prej hijeve të lisave, etj. Të gjitha këto, nuk nënkuptojë mbulesën ndaj diellit.

Pra, kush do të konsiderohej mbulesë e diellit, dhe ajo që e bën atë të humbë, ose të shkojë? Ajo është nata, pra, terri. Nata është ajo që mbulon diellin. Gjatë natës, nuk shihen rrezet e tij, në asnjë vend. Atë nuk e sheh në cilindo pozicion të jesh, si nga lartë, po ashtu edhe në rrugë, etj. Atë nuk e sheh, sepse është i fshehur nga ti, me terr. Pra, duhet të ndalojmë vetëm pak. Allahu i Lartësuar, në një nga ajetet e mëparshme, kishte sjellë disa rregulla, të cilat i nevojiteshin për të qarkulluar në tokë, duke thënë se, duhet t'i përmbahemi shkaqeve, të cilat vinin nga Allahu, të pëlqyera për ne. Pastaj ajetet e tjera, kur Dhulrarnëjni arriti në mes dy digave, aty ai takoi një popull, si dhe dy të tjerë, ata Jexhuxhë dhe Mexhuxhë. Ishin popuj prapshitanë.⁴⁰ Por tani, kemi të bëjmë me ajetin, i cili thotë: “Derisa arriti në lindjen e diellit (atu ku dukej se po lindte, ose më saktë, deri tek populli më i largët në lindje, që përjetonte vuajtjet e parisë së tyre), vërejt se, ai lindte tek një popull, që, Ne, nuk iu kishim dhënë atyre mbulesë nën të (diellin)”.

Tani, Allahu i Lartësuar, nuk ka përqëllim të tregojë veprën e Dhulkarnejnrit, por qëllimi është të tregojë diçka shumë të rëndësishme, përderisa, me kaq precizitet, Kur’ani e përcjell secilën shkronjë në të. Duhet të jetë kështu, sepse Allahu i Lartësuar, dëshiroi të na tregojë, në këtë ajet, diçka. Pra, cila është ajo Urtësi e fshehur, në këtë ajet?

Shumë njerëz, kur i lexojnë këto ajete nuk thellohen, por ato i kalojnë shkel edhe shko.

Duhet t’a dimë se Allahu, sikur që kishte angazhuar me detyrë, Dhulkarnejnin, pas perëndimit të diellit, e kishte angazhuar, gjithashtu, edhe atëherë, kur kishte arritur edhe tek popujt, që kishin ngritur digën. Por kësaj radhe, nuk kishte angazhim⁴¹. Nuk ka dyshim se, qëllimi i Allahut, këtu, është të na tregojë se Leka i Madh, kishte arritur në një pjesë të tokës, ku nuk perëndonte dielli, për një kohë të gjatë. Është një vend, jo i zakonshëm për ne, që njohim lindjen dhe

⁴⁰ Rreth popujve Jexhuxhë dhe Mexhuxhë ka shumë komentime, shumica e dijetarëve mendojnë se këto dy popuj i përkasin racës së verdhë (supozohet të janë Kinezët)... Së shpejti do të keni mundësi të lexoni më gjërësisht rreth Lekës së Madh dhe këtyre dy popujve ... (shtojcë e përkthyesit).

⁴¹ Komentatorët sjellin shpjegime të strategjisë së Leka i Madh, ose Dhulkarnejni, kishte në program të ekspeditës së tij, që t’i thërriste këshilltarët e vet në mbrëmje. Gjatë natës ata përpilonin planin e sulmit të nesërm. Por, kësaj radhe u zhgënjye, në këtë rast të këtij ajeti. Kur ai arriti në këtë vend, priti që dielli të perendojë, e pastaj t’i tubonte këshilltarët. Ai po priste perëndimin e diellit, por, në fakt, dielli nuk perendoi një kohë të gjatë, dhe kështu vendosi t’a prishë rregullin ... (shtojcë e përkthyesit).

perëndimin. Dielli lind dhe një kohë të gjatë nuk perëndon dhe kështu nuk ka kush e mbulon atë. Sot, na janë të njohura vende, në të cilat nuk perëndon dielli për 6 muaj. Ai vend është poli veriut, si dhe poli jugut të tokës.

Allahu, sikur do të na thotë se, keni vende, në të cilat rregullat, me të cilat përballemi gjatë ditës dhe natës, diku në këtë ruzull, nuk vlejnë, sepse dielli, atje, lind dhe për një kohë shumë të gjatë, nuk perëndon.

VESHI, JETA DHE RINGJALLJA

Do t'i rikthehem përsëri Dhulkarnejnit, i cili u theksua në Kur'an, por tani, do të fillojmë të vazhdojmë me fenomenet e sures el Kehf (shpella), nga e para.

Ashtu siç thamë, me shprehjen 'shpellë' nënkuptojmë një zgavër të madhe brenda malit, ose shkëmbit. Mund të dimë se ç'ka në të, nëse hulumtojmë brendinë e saj. Shpella, për të cilën bën fjalë Allahu, në fillim të sures 'Shpella', ka të bëjë me disa persona, që e besonin Zotin e tyre. Këta persona ishin besimtarë. Nga frika e tiranisë së pabesimtarëve, që kishin mbretëruar atë kohë, ata persona, ishin futur në këtë shpellë, për t'u strehuar. Qëllimi ishte për t'a ruajtur besimin e tyre, sepse qeveritarët i detyronin ata të mohonin Zotin. Allahu i Lartësuar deshi të na informojë ne se, sado të përhapet dhuna dhe tirania, imani është është prezent. Ai mund të jetë fshehur tek ne, por ai ekziston dhe asnjëherë nuk humbet.

Këto, janë ajetet e para të sures 'Shpella'. Kur ne i hedhim një vështrim të thuktë, do të shohim shumë mrekulli, në Kur'an. Por, gjithnjë, nëse Allahu do të dëshirojë të na i tregojë ato.

I Lartësuari thotë: "Kështu që, Ne iu mëshuam në veshët e tyre (ranë në komë) në shpellë, për disa vite me radhë".³⁹

Kjo është mrekullia e parë. Allahu i Lartësuar, me këtë, na tregoi se gjëja, që nuk fle, prej shqisave të njeriut është veshi. Kur njeriu mbyll sytë, ai nuk mund të shohë, por asesi nuk mund t'i mbyllë veshët. Veshi vazhdon të jetë i hapur, e kryen detyrën e vet, deshe ose nuk deshe. Ashtu siç thamë, nëse nuk dëshiron të shohësh një person, mjafton të mbyllësh sytë.

Këtë nuk mund ta bësh me veshët, nëse nuk dëshiron t'ia dëgjosh zërin dikujt. Kur personi është në gjumë, kuptohet që, nuk mund t'a shohë njeriun, nëse ai i kalon atij pranë. Por, nëse ndodh, të lëshohet një zë, edhe pse, personi është në gjumë, do të zgjohet menjëherë. Me këtë, Allahu i Lartësuar, së pari, përkujton se veshi nuk fle kurrë, së dyti, se ai është një organ, i cili pranon thirrjet, dhe së treti, se nëse veshi nuk dëgjon zëra, ose nuk dëgjon zhurmë, ai mund të flejë një kohë të gjatë. Është e pamundur të flejë njeriu, nëse vazhdimisht dëgjohen zërat, ose zhurmat e ditës. Kur, Allahu i Lartësuar, vendosi që ata të flejnë një kohë të gjatë,

në shpellë dhe pa e ndier, se çfarë po ndodh përreth tyre, Ai nuk ju mori atyre sytë, e as nuk bëri që të rrahurat e zemrës të jenë më të rralla, se ato të njeriut kur fle, por, ju mëshoi në vesh. Për t'i shkëputur nga kjo botë, plotësisht, kjo, paska qenë e mjaftueshme. Veshi është organ, që e pranon i pari thirjen në botën tjetër-ahiret.

Të shohim versetin tjetër, i Lartësuar, thotë: Dhe (po t'i shihje) do të llogarisje ata të zgjuar, ndërsa ata ishin duke fjetur, kurse, Ne i rrotullonim ata, në të djathtë e në të majtë...”.⁴⁰

Mendja e njeriut duhej të ndalet më tepër, në këtë thënie të Allahut të Lartëmadhëruar: kurse Ne i rrotullonim ata, në të djathtë e në të majtë...”.

Pse Allahu u shpreh në këtë mënyrë, pse ishin të nevojshme këto fjalë në këtë ajet? Sikur të mos shkruhej kështu, prapëseprapë nuk do të ndërronte asgjë prej ngjarjes. Ashtu siç kam thënë më herët, edhe e them se, Kur'ani, në çdo fjalë, ka mrekulli, por disa nga ato janë zbuluar, ndërsa të tjerat do të zbulohen me kalimin e kohës. Nëse vërejmë ajetin me vëmendje: kurse Ne i rrotullonim ata, në të djathtë e në të majtë...”, do të shohim se i Lartësuar, do t'i zgjojë ata nga gjumi, si shenjë nga shenjat e Tij. Ata, do t'i kthejë edhe një herë, në jetën njerëzore të kësaj bote. Për ata, që flejnë shumë Allahu, ka rregulla të veçanta. Mjekët, kur kanë pacientë të palëvizshëm, këshillojnë që ata t'i rrotullojnë vazhdimisht, për arsye të mpirjes së trupit, si dhe kjo, njëkohësisht, i ndihmon që gjaku mos t'ju ngjizet në këmbë, ose në pjesën e poshtme të trupit.

Dëshira e Allahut ishte që, ne të mësojmë se, kur njeriu është për një kohë të gjatë i shtrirë, duhet që të rrotullohet. Mosrrotullimi tyre është i dëmshëm për trupin, nëse ai do të qëndrojë, një kohë të gjatë, vetëm në një anë. Në të kundërtën, ai do të pësojë aq shumë, saqë, sot, mjeksia e di shumë mirë këtë. Allahu i Lartësuar, me këtë veprim, deshi të na mësojë, që të dimë se si duhet vepruar.

Para se ta zbulonte shkenca njerëzore këtë, Allahu, para shumë shekujve, na kishte informuar me anë të këtyre verseleve. Ai, na mësoi se si duhet vepruar në rastet, kur kemi pacientë, që janë të shtrirë për një kohë të gjatë. Ata, duhet të rrotullohen në të djathtë e në të majtë. Ky veprim, është bazë e ruajtjes së shëndetit, ose së paku, shërben për parandalimin e dëmtimeve më të mëdha.

VULLNETI ALLAHUT

Tani, të shohim, një tjetër ajet: “Dhe mos thuani, për diçka (për punët e pakryera) se unë do ta bëj ate nesër. Përveç (nëse shtoni thënjen) nëse do të dëshirojë Allahu⁴² dhe përkujtoe Zotin tënd kur të harrosh...”⁴³

⁴² Nëse do Allahu, është shprehje e njohur ndër ne, in shae Allah (inshalla).

Këtij ajeti do t'i përkushtojmë, një kohë, pak më të gjatë. Nëse unë them për diçka se, do t'a bëj nesër, mund të ndodhë që, edhe tjetri të thotë për një diçka të kundërt prej meje: do t'a bëj nesër, atëherë do të bëhet vetëm ajo, që do t'a përcaktojë vullneti i Allahut të Lartësuar. Ne jemi të pafuqishëm dhe nuk jemi absolutë, mundësitë tona janë të kufizuara, prandaj ato janë relative. Një punë, mundet të bëhet, ose nuk mund të bëhet, përveçse, atëherë, nëse themi inshalla (nëse do Allahu). Le t'a shpjegojmë këtë. Ai, i cili, dëshiron të bëjë diçka, patjetër, duhet të posedojë së pari, mundësinë për të vepruar.

Së dyti, duhet të posedojë kohën, dhe së treti, duhet të posedojë vendin, në të cilën mendon t'a kryejë atë veprim. Kur unë them se, do të shkoj për t'a takuar filanin nesër, kjo është një nga premtimet më të thjeshta të përditshmërisë të njeriut për veprime. Unë patjetër, duhet të posedoj, mundësinë për të qenë prezent të nesërmen, sipas rutinore sonë të përditshme.

Por, thënë realisht, unë, nuk e posedoj këtë mundësi. Njeriu nuk posedon mundësi që t'i sigurojë vetes së tij, as edhe një moment të vetëm, e lëre më një ditë.

Pra, thënia ime se: do ta takoj filanin nesër, është gabim. Unë, nuk e di, nëse jam gjallë nesër. Jeta është nën patronazhin e dëshirës së Allahut të Lartësuar. Jeta ime është në varësi të vullnetit të Allahut, nëse Ai do, jetoj, e nëse jo, atëherë do të ndërroj jetë.

Nëse, tani i kthehemi botës së mundësive, të nesërmen mundet të jem gjallë, por edhe pse jam në jetë, më del një punë tjetër, që nuk mund t'a takoj atë të nesërmen. Ndodh të sëmurem, ose mundet të më dalë ndonjë punë e rëndësishme befasuese për mua dhe nuk do të më premttojë koha, që atë t'a takoj të nesërmen. Ndodh, që të më vijë një musafir i papritur ose ndonjë gjë tjetër. Ajo që është me rëndësi është se, unë mund të jem në jetë dhe, përfundimisht, nuk mund të shkoj në takim, për arsye, të cilat nuk më përkasin mua.

Sikur tani t'a marrim anën tjetër. Unë jam në jetë, me shëndet të mirë dhe asgjë prej gjëje nuk më pengon të shkoj në atë takim, dhe shkoj në vendtakimin tonë në kohën e duhur, por, ja, që personi me të cilin kisha për t'u takuar nuk erdhi, ose nuk është në zyrë, për arsye të ndryshme, është penguar në rrugë, ose është sëmurë, ose i ka dalë një punë e papritur. Thënë shkurt, i ka ndodhur diçka, që atë e ka penguar tani të jetë prezent në atë takim. I është prishur makina, ose është përplasur me makinë dhe e ka vonuar marrja në pyetje e formaliteteve policore, ose i ka ndodhur ndonjë gjë, gjatë rrugës, ose në shtëpi, etj. Nga e gjithë kjo, unë nuk posedoj asnjë element prej kushteve, për të thënë se unë do të bëj, këtë e atë. Kush është, ai që e zotëron këtë mundësi? Ai, është Allahu i Lartësuar. Ai, kur të

⁴³ Kur'an, sure 18- elKehf, ajeti 23, 24

thotë: 'bëhu', ajo do të bëhet, Ai është i Gjallë e nuk vdes, është i Përjetshëm e nuk shuhet. Askush, nuk mund t'a pengojë, për asgjë. Atë çka do, mund t'a caktojë menjëherë. Kur, Ai, ka caktuar ndonjë gjë, ajo është e bërë. Pse e them këtë? Sepse, nuk ka forcë që mund t'ia ndalojë, t'ia shpejtojë, t'ia vonojë, ose t'ia caktojë Allahut të Lartësuar.

Kështu, mund të themi se Ai vepron si të dojë, kurse ne, dhe e gjithë qenia njerëzore, veprojmë, ashtu siç, Ai, dëshiron. Nëse planifikimi ynë, hyn në vullnetin e Tij, ajo do të bëhet, ajo është e kryer. Ai, është Allah i Vetëm dhe ai është veprues. Nëse veprimi, nuk hyn në vullnetin e Tij, ai nuk mund të kryhet, për të vetmen arsye, sepse Ai është veprues. Thënja e Allahut të Lartësuar: "Dhe mos thuani, për diçka (*për punët e pakryera*) se unë do ta bëj atë nesër. Përveç (*nëse shtoni thënjen*) nëse do të dëshirojë Allahu ...". Me këtë Allahu dëshiron të na përkujtojë një gjë shumë të rëndësishme. Secila punë, kryhet me pëlqimin dhe vullnetin e Allahut. Ai gjithashtu na përkujton dhe na thotë: "...dhe përkujtoje Zotin tend, kur të harrosh...", kjo kërkohet vazhdimisht nga besimtarët. Gjithmonë, ne duhet t'a kemi në vetëdije, se veprues dhe përcaktues është vetëm Allahu.

Njeriu prejardhjen e ka prej dheu, pastaj prej spermës, nga kjo e fundit, rjedhin pasardhësit e njeriut të parë, Ademit a.s. Dheu, ose sperma, nuk mund të bëjnë asgjë. Nuk mund të bëhet asgjë nga dheu, të cilin e shkelim çdo ditë. Ky është i njëjti trup, me të cilin ecim mbi të. Kështu që, vullneti Allahut, është që, njeriu të jetë me mendje dhe kjo duhet t'ia përkujtojë vazhdimisht krijimin e tij. Nëse unë jam nga dheu, sikur që edhe ti je prej dheu, atëherë nga të erdhi ty, ajo forcë e jashtëzakonshme, o ti prej dheu, t'a refuzosh dhe t'a harosh Allahun, e për adhures të trillosh vetveten.

Allahu i Lartësuar është Ai, që t'a dhuroi këtë forcë. Gjithashtu, Ai krijoi universin për ty. Kërkoj që i gjithë universi të të bindet ty. Për ta kuptuar mirë këtë realitet, duhet t'a dish mirë, se Allahu xh.sh., këtë krijesë, e bëri prej një grusht dheu. Këta, të cilët e adhurojnë veten e tyre dhe që, vazhdimisht, i sheh para teje, janë të krijuar, sikur edhe ti, prej një grusht dheu. E këta, marrin guximin dhe i përballen forcës së Allahut të Lartësuar. Për t'ju bindur ose nënshtruar këtij, që merr guximin t'i përballët Allahut, duhet të jesh i vetëdijshëm, se çfarë mund të bëjë ai, që është prej një grushti dheu, sikur edhe ti, pastaj mund të paramendosh mundësinë e tij për t'a drejtuar tërë gjithësinë.

Allahu, dëshiron të na përkujtojë begatitë e Tij. Gjithashtu, dëshiron të dimë se, Ai dërgon mirësitë. Ai, që të jep, vetëm ai ka mundësi, që t'a marrë. Ai, i cili të jep leje, vetëm ai, ka mundësi të të ndalë.

Këto janë gjëra shumë të rëndësishme në përditshmërinë e sjelljeve tona, gjatë jetës. Kur njeriu mbështet në forcën e vet, fryhet dhe rebelohet, fillon t'i

nëpërkëmbë të dobëtit dhe t'i terrorizojë. Por, kur njeriu përkujton focën e Allahut të Lartësuar, ai jep përshtypjen e një njeriu të edukuar. I tilli, e di fare mirë se, Ai që t'a ka dhënë atë forcë, Ai edhe mund të t'a marrë. Ai, që i bindet Allahut, tek ai vazhdimisht ndërhyr zemra, pastaj ajo ndikon që, ai mos të jetë i dhunshëm, arrogant etj. Këtë e bën, ngase, ka frikë Allahun, për secilën vepër që fillon t'a bëjë. Sikur, kjo të kuptohet kështu, nga të gjithë, atëherë universi do të ishte i qetë, në harmoni të plotë.

LAVDIA I TAKON VETËM ALLAHUT

Pason ajeti tjetër, i cili, do t'a plotësojë debatin:

“Por, sikur, të thojë, kur hyrë në kopshtin tënd: MasheAllah, fuqia i takon Allahut. Edhe pse më sheh mua më të varfër dhe më pak fëmijë, Zoti im, mbase, do të të ma bëjë kopshtin më të mirë se tëndin”⁴⁴

Ky ajet të kthen në origjinë. Një njeri, ia përkujton tjetrit, se kishte haruar fuqinë e Allahut xh.sh. Gjithashtu i përkujton se, kishte haruar seç i ishte dhuruar. Vazhdon t'i thotë: mos vallë je duke menduar, se kjo mirësi, është fryti yt! Mendon se proceset natyrore ishin rezultati yt, e jo të Allahut! Këtu ju përkujtoj, edhe një herë, se emërimi i kaptinës ‘Shpella’ nuk është e rastësishëm. Thamë, se kemi të bëjmë me fjali, me shumë kuptime. Thesari është i fshehur brenda shpellës së vërtetë. Dhuruesi është Allahu, por ja që, kjo dhuratë është e fshehur për shumë arsye, prandaj kemi njerëz, të cilët thonë: “...vërtetë, kjo që posedoj është rezultat i dijes sime...”⁴⁵, kurse kemi të tjerë, që thonë: “Unë jam më i pasur se ti dhe më i fuqishëm në njerëz (familje më e madhe).”⁴⁶

Në këtë sure, Allahu, dëshiroi të na tregojë realen dhe jo realen, gjërat, që duken dhe janë të qarta, si dhe ato që, mendja e njeriut nuk do të arrijë t'i kuptojë. Tek kjo e fundit, qëndron fuqia ose mundësia absolute e Allahut të Lartësuar.

Ç'thotë i Lartësuari Allah, në Kur'an, duke e cituar personin, që ishte, me më pak pasuri dhe, gjithashtu, me më pak fëmijë? “Mbase, Zoti im, do të më japë një kopsht më të mirë se tëndin, kurse (në kopshtin tënd mund që) të dërgojë një rrufe prej qielli e të shndërrohet në fushë të shkretë. Ose të shterojnë ujërat e saj në thellësi, po sikur edhe t'i kërkoje ato (ujëra), nuk do t'i gjeje dot”.⁴⁷ Allahu, për begatitë, na jep dy shenja shumë të rëndësishme. Robi i Allahut, që ishte i lumtur dhe falenderues me pasurinë dhe fuqinë që e posedonte, pra, ai që shprehej: kurse

⁴⁴ Kur'an, sure 18-elKehf, ajeti 39

⁴⁵ Kur'an, sure 28 el Kasas, ajeti 78

⁴⁶ Kur'an, sure 18 el Kehf, ajeti 34

⁴⁷ Kur'an, sure 18 el Kehf, ajeti 40,41,42

(në kopshtin tënd mund që) të dërgojë një rrufe prej qielli e të shndërrohet në fushë të shkretë. Ose t'i shterojnë ujërat e saj në thellësi, po sikur edhe t'i kërkoje ato (ujëra), nuk do t'i gjejë dot"

Pse Allahu përmend këto dy raste, e nuk përmend asnjë rast tjetër? Sikur dëshiron t'i thotë atij se, Allahu ka mundësi të t'a marrë shpirtin që nesër, gjithashtu mund të të paraqitet një sëmundje dhe, në çast, t'a bëjë atë që të mos mund të lëvizë, ose diçka të ngjashme nga mundësitë e Allahut, që mund t'ia japë njeriut kryelartë, që harron mirësitë dhe begatitë e Allahut të Lartësuar.

Fjala është për këta dy persona, shkakut thelbësor, këtu, është tek këto dy mirësi. Këta të dy, e kishin tokën shumë pjellore, rendimentet e saja ishin të shumta dhe mirësia gjithashtu ishte e panumërt. Këta dy punëtorë, nuk do të llogariten si prezantues të punës dhe dhënies së bereqetit. Këta, duhet t'a dinë se, nuk ju takon të thirren në këtë bereqet, ose të mendojnë se, e gjithë kjo mirësi, është rezultat i tyre. Allahu i Lartësuar na sjell këto shembuj dhe, me këto, na përkujton shkaqet. Ato janë sekret, gjëra që nuk dihen për ne. Na përkujton se, burimi i gjithë kësaj mirësie, është uji. Ujitja është një gjë shumë e vogël, por pa të, nuk ka asgjë dhe këtë njeriu duhet t'a dijë se nuk e ka krijuar ai vetë. Jo vetëm kaq, por këtu, na përkujton, se edhe sikur të dojë t'a gjejë burimin e ujit, nuk do të ketë mundësi t'a gjejë. Ai, i cili, ujit, është Allahu, dhe jo vetëm atë tokë, por, Ai, ujit mbarë botën. Që kur na ka paralajmëruar Allahu, në Kur'an, e deri më ditët tona të sotme, mbi 14 shekuj, njeriu nuk është në gjendje të prodhojë qoftë edhe një gotë me ujë. Para nesh, është shembulli ekzistues. Shihe shkretirën dhe sipërfaqet e saj të mëdha. Sikur njeriu t'a prodhonte ujin, do t'a kishte gjallëruar atë vend, e nuk kishte për t'a lënë të thatë e të shkretë.

Pra, duhet kuptuar esenca e këtyre dy kopshteve, frutat që janë aty, janë rezultat i mundësisë dhe mirësisë së Allahut të Lartëmadhëruar. Ai ua mundësoi ujin e bollshëm.

Kjo, nuk është puna, e as fuqia e asnjë njeriu. Njeriu, nuk mund të thotë se, është vepra ime. Shkenca nuk mund të prodhojë një lumë mes shkretëtirës. Kurse, fuqia e Allahut, ka krijuar qindra mijëra lumenj. Këtë, e bëri, për t'ia larguar etjen të gjitha gjallesave që kanë nevojë në tokë, si njeriut, kafshëve, bimëve etj. Të gjithë këto, kanë ujë, aq sa u nevojitet, bile ndodh që, shpesh here, të kenë ujë të tepërt.

Pra, të gjitha mirësitë vijnë nga uji. Ai është i bollshëm, e ky është rezultat i krijimit të Allahut të Lartësuar. Me këtë ajet, Allahu i Lartësuar, dëshiroi t'ia përkujtojë njeriut që parapëlqente veten, se elementi kryesor për jetesë është uji. Atë, e bëri të bollshëm për secilin dhe i tregoi atij se, ai nuk është në gjendje t'a prodhojë ose krijojë. Allahu xh.sh. thotë: Ose t'i shterojnë ujrën e saj në thellësi, po sikur edhe t'i kërkoje ato, (ujëra) nuk do t'i gjejë dot"

Allahu i Lartësuar përkujdeset që arat të mos shkatërrohen nga furtunat ose rrebeshet. E gjithë ajo sasi, që bie, është prej paracaktimeve të Tij. Njeriu, nuk e posedon këtë forcë. Kjo rrjedh nga vullneti Allahut të Lartësuar, i Cili i jep kujt të dojë dhe sa të dojë, si dhe e privon kë të dojë. I Lartësuari thotë: kurse *(në kopshtin tënd mund që)* të dërgojë një rrufe prej qielli e të shndërohet në fushë të shkretë.

VEPRUES ËSHTË ALLAHU

Nga e gjithë kjo, Allahu i Lartësuar, na tërheq vëmendjen, duke na treguar për dy të vërteta, të cilat na ishin të panjohura. Këto, dy të vërteta konsiderohen shtylla jetike. E vërteta e parë, është se Allahu i Lartëmadhëruar i kishte premtuar ujë kopshtit, e ky është një prej elementeve kryesorë të jetesës. E vërteta e dytë, është se Ai kujdeset dhe e begaton atë. Në të dy, këto veprime, njeriu nuk mund të ndërhyrjë, ose nuk ka pjesëmarrje në to. Atij, as nuk i jepet mundësia e diskutimit, e të thotë se unë e bëra këtë. Psh. Njeriu punon arën, e mbjell atë dhe kujdeset për të, por është Allahu, Ai i cili e solli këtë farë në tokë dhe bëri të rritet dhe, pastaj, të japë fruta. Pjesëmarrja e njeriut këtu është sipërfaqësore dhe, mbase kjo gjendje, e bën njeriun të thotë se: unë e bëra këtë. Allahu na tregoi se i posedon të dy të vërtetat, të cilat e bëjnë njeriun të thotë, se nuk ka pjesëmarrje aty.

E vërteta e parë, ishte uji i mjaftueshëm për jetesën në tokë dhe pjellshmërinë e saj. Pa këtë ujë, nuk do të ishin këto kopshte. E vërteta e dytë, ishte përkujdesja e Tij dhe begatia në të. Ashtu siç theksuam, tek këto dy të vërteta, njeriu nuk ka pse të thotë se, ky është produkti im.

Dhe kështu:

“Kështu frutat e tij u shkatëruan, e ai mbeti duke fërkuar duart me keqardhje për çfarë kishte shpenzuar në të, ajo (pasuria) iu shkatërrua që prej rrënjëve...”⁴⁸

A thua, pse ju shkatëruan prodhimet e tij? Nuk mund të kuptohet ndryshe, përveçse të kuptojë, se ai nuk ka kurrfarë mundësie e as forcë mbi të. T’u kuptojë se pasuria, dhe fëmijët, me të cilët ai mburrej, nuk i shërbyen asgjë, pa dëshirën e Allahut. Ai vërejti, dhe u bind, se kopshti iu shkatërrua që nga rrënjët. Deshi Allahu i Lartësuar, që ai të bindet, të mbështetet në Të, dhe t’u kuptojë se nuk ka forcë, e cila mund të qëndrojë para caktimit të Tij. Pra, Allahu ishte Ai, i cili i dha këtë kopsht atij, prej dhuntive të Tij, e kur ai filloi të mburrej me pasurinë dhe fëmijët e tij, ato iu morën. E bëri atë, të dukej si i humbur, pastaj ai u gjend para ajetit tjetër, i cili thotë: “Përveç Allahut, ai nuk kishte asnjë grup t’a ndihmojë atë, prandaj nuk ishte i ndihmuar.”⁴⁹

⁴⁸ Kur’an, el Kehf - 42

⁴⁹ Kur’an, sure 18 el Kehf, ajeti 43

Ky ajet, jep të kuptojmë, se ai ishte mbështetur diku tjetër, për momentin, u kishte kërkuar atyre t'a ndihmonin. Ai, më në fund, arriti në konkluzionin se: Nuk ka kush t'i dalë përpara forcës së Allahut, sepse nuk gjeti askënd që t'a ndihmonte. Ky ishte një realitet, sepse ai, vërtetë, nuk u ndihmua. Po edhe sikur dikush të përpiqej t'a ndihmonte me pasuri ose edhe me fëmijë, do të ishte e kotë, sepse atij nuk i ishte përcaktuar ndihma. Pas gjithë kësaj ndodhie, vjen edhe momenti i pendimit.

Shprehet ai, duke thënë: “Ah, i mjeri unë, sikur mos t'a shoqëroja Zotin tim me askënd!”

Vetëm atëherë, pasi i iku prodhimi, e kuptoi se dhurues i vetëm qenka Allahu i Lartësuar, sepse Ai që ia dha, Ai edhe ia mori. Por, pak më parë thoshte, pasuria dhe fëmijët i ishin garancë dhe kujdestarë të bereqetit të tij, nga çfarëdo lloj shkatërrimi. Kështu, ky ajet, na jep këtë shembull, me këtë njeri, të cilit Allahu i kishte dhuruar begati të shumta, por që ai i kishte shoqëruar dike tjetër Allahut të Lartësuar në këtë begati, prandaj Allahu ia mori atij. Allahu i Lartësuar është i pastër, i pashoq edhe pse dikush mundohet t'ia shoqërojë ndokënd. Një punë, e cila synohet të bëhet dhe ajo ka pëlqimin e Allahut, atij do t'i pranohet. Por, ai i cili synon t'a kënaq ndonjë njeri, veprimi i tij i jep të kuptojë se i është afruar Allahut të Lartësuar. Ai është i pastër, i pashoq para këtyre, për të. Kështu është edhe me begatitë.

Allahu na jep këtë rëfim, që të jetë shembull dhe udhërrëfyes i jetës sonë të mirë. Nuk konsiderohet bamirësi, pasuria që mund të jepet për qëllime personale, ose për të kënaqur ndonjë person. Gjitashtu, kur ajo jepet për qëllime të kësaj bote, ose që me të, të arrijë pozitë ose publicitet. Dhënia e ndonjë shume, në vendet publike, ose në ndonjë ceremonial, nuk do të jetë e efekshme, kur ajo jepet për qëllime reklamimi, që të flitet për të, se është bamirës ose humanitar. Dhënia, nëse nuk jepet për hir të Allahut, konsiderohet si shoqërim ndaj Allahut. Allahu i Lartëmadhëruar është i pastër i pashoq, kundrejt atyre, që mundohen t'a shoqërojnë Atë. Por, nëse jepet diçka nga pasuria, për hir të Allahut, gjithashtu, Ai, është i pastër dhe i pashoq, kundrejt atyre që mundohen t'a përgënjeshtrojnë Atë, duke e njolllosur me shoqërim.

Dhe në fund, të gjithë janë të barabartë me pronarin e kopshtit, i cili, vetvetes ia kishte atribuar meritat dhe, me këtë, kishte mohuar mirësitë e Allahut, sikurse ata, të cilët mundohen të shpërndajnë pasurinë për veprime humanitare, por, që në realitet, kanë qëllime të kësaj bote. Të gjitha këto veprime, Allahu i Lartëmadhëruar, na ka paralajmëruar se, janë të papranuara tek Ai. Vepra e mirë, bëhet vetëm për hir të Allahut, por sikur, ndonjë vepër, të ishte e mirë ose e pëlqyer, para njerëzimit, e në realitet të kishte qëllime përfitimi në këtë botë, edhe pse, në të njëjtën kohë, thuhet se ishte për hir të Allahut, Ai është i pastër dhe i pashoq ndaj veprimit dhe thënieve të tyre.

DITURIA E ALLAHUT DHE DITURIA NË PLANETIN TOKË

Para se t'a përmbyllin diskutimin tonë, në suren el Kehf (shpella), e shoh të obligueshme t'ju paraqes tregimin e Robit të Mirë dhe Musait a.s. Gjithashtu, tregimin e Dhulkarnejnit (Lekës së Madh).

Nuk mendoj, se duhet të diskutoj rreth emrit të këtij personi. Allahu e quajti, Robi i Mirë, dhe kjo na mjafton. Në realitet, ai ishte një Rob i Allahut, të cilit, i dhuroi dituri. Kur, Allahu i Lartësuar, na tregon ngjarje, në Kur'ani Kerim, Ai, ka për qëllim të na japë ose mësojë urtësinë dhe, njëkohësisht, ato konsiderohen këshilla për ne. E nuk ka për qëllim, që ne të ndalemi dhe të polemizojmë rreth personaliteteve, qoftë ata meshkuj ose femra. Në Kur'an Kerim, emrat nuk kanë vlerë.

Vlera e vëtetë, do të ishte në të kuptuarit e këshillës deri në arritjen e urtësisë. Për këtë arsye, All-llahu i Lartësuar, në Kur'an, nuk na tregoi emrat e personave, me përjashtim të dy emrave, e ato ishin Merjeme, e bija e Imranit dhe Isau, i biri i Merjemes, sepse ajo çfarë u ka ndodhur këtyre, nuk i ka ndodhur askujt tjetër. Këto ishin ngjarje të papërsëritura. Për këtë arsye, Allahu xh.sh., këta të dy, i veçoi me emra. Kurse Faraoni i Egjiptit, Dhulkarnejni, Faraoni i Musait dhe të tjerët, nuk janë me rëndësi për njohje, tek Allahu i Lartësuar. Kjo është e qëllimtë, sepse polemizimi rreth personaliteteve dhe emrave të tyre, do të shpinte në zvoglimin e ngjarjes dhe harresën e urtësisë. Faraon, konsiderohet, secili njeri, i cili, mendon ose kërkon që ai duhet të adhurohet në tokë. Dhulkarnejn, konsiderohet, secili njeri, që merr dhuntinë e Allahut, i cili, ngarkohet me hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve, etj.

Thotë i Lartësuari: “Pastaj ata të dy, e gjetën robin, që ishte prej robërve Tanë, të cilit, Ne i kishim dhuruar mëshirë (prej mëshirës sonë), gjithashtu dituri, nga Dituria Jonë (e cila, duhet të jetë dituri e veçantë).”⁵⁰

Thënia e Allahut të Lartësuar, kjo shpellë mbulon ose fsheh të vërtetën. Musa, ishte i dërguar i Allahut të Lartësuar. I dërguari jep informacionet e Allahut. Përderisa, ishte në lidhje të drejtëpërdrejtë me Allahun, do të ishte logjike, që çdo dituri të vinte prej tij, sepse ai ishte i ngarkuar të informonte popullin me revelatën që ai e kishte. Por ja, që kësaj radhe, i Lartësuari dëshiroi të na tregojë se vullneti Tij, nuk ka rregulla e as kufij. Ai bën ç'të dojë dhe, çfarë, Ai vetë, zgjedhë të bëjë. Kështu, kësaj radhe, zgjodhi një rob nga robërit e Tij, që e kishte pajisur me dituri. Këtë dituri, nuk e kishin as të dërguarit e Tij. Kjo, ishte një prej mirësive të Tij, që ia dhuron kujt të dojë. Vullneti Allahut të Lartësuar është i

⁵⁰ Kur'an, sure 18 el Kehf, ajeti 65

pakushtëzuar dhe pakufij.

Tani të fillojmë me tregimin, se çfarë i ndodhi Robit të Mirë dhe Musaut a.s. Shpellat, këto që, në vete, përmbajnë shumë ngjarje, këto që fshehin shumë ndodhi të vërteta, e kjo do të konsiderohet si zbulimi i parë, pastaj vijnë zbulimet e vetë ndodhive e kështu derisa të arrihet tek e vërteta. Musau i shihte shpellat, por ai nuk ishte në gjendje t'i shihte të vërtetat, prandaj nuk kishte durim. Robi i mirë, duke e njohur mentalitetin e njeriut, që në fillim, i kishte sygjeruar, atij, të bënte durim: “...kam bindje, se ti nuk do të kesh durim dhe përmbajtje me mua”, pastaj thënia: “E si të kesh durim, për atë çka nuk je i njoftuar!”⁵¹

Robi i Mirë, kështu kishte vlerësuar, sepse ishte bazuar në diturinë, që ai posedonte. Po kështu edhe Musau! Vlerësimet e tij, bazoheshin në diturinë që posedonte. Këtu kemi të bëjmë me përplasje vlerësimesh dhe gjykimesh. Sipas gjykimeve të Robit të Mirë, ai vlerësonte se bënte një punë të mirë, realiteti i së cilës ishte i fshehur në shpellë, por, në pamje të jashtme, dukej se po bënte krim. Musau shihte vetëm pamjen e jashtme. Ai gjykonte nga pozicioni tij, sepse nuk dinte se ç'fshihej në të. Dallim shumë i madh është mes realitetit dhe pamjes së jashtme. Pamjen e jashtme, mund t'a shohin shumë njerëz, por, realen, e di vetëm Allahu i Lartësuar. Kemi njerëz, që bëjnë namaz sa për sy e faqe, vetëm sa t'i thuhet se është njeri i mirë, por që, në të vërtetë, është mëkatar. Ai nuk ndalet së gabuari, për hir të të mirave të dynjasë, për dallim nga ai njeri, i cili bën namaz dhe zemra e tij është përplot iman. Këto fshehtësi të tyre, i di vetëm All-llahu xh.sh., se cili nga këta dy, bën namaz nga bindja, e cili nga përfitimet e kësaj bote.

Gjithashtu, edhe shembulli i bamirësisë. Kemi njerëz që japin para sa për t'i parë turma, me këtë, ata synojnë t'a përfitojnë atë, dhe kemi njerëz, që kur japin, nuk duan që dora e majtë të shohë se ç'dha dora e djathtë. Para syve tanë, që të dy, kontribuan në bamirësi, por shpërblimi tek Allahu ndryshon.

Të tillë shembuj, kemi shumë në jetën tonë të përditshme. Jeta është përplot shpella, të cilat i fshihen realitetet. Kemi njerëz, që paraqiten se na duan të mirën, por në realitet punojnë që të na groposin, etj.

KUR PËRPLASEN GJYKIMET

Musau a.s. “Tha: InshaAllah do të më gjesh, prej atyre që do të durojnë, e nuk do t'i shkeli urdhërat e tua”.⁵² Por, ai, i cili deklarohet se do të mund të durojë, në të njëjtën kohë, është i ngarkuar me vepra, që e ngarkojnë atë sipas gjykimeve të tij, sepse ka marrë direktivat nga All-llahu i Lartësuar. Por shikuar realisht, atij i ishin

⁵¹ Kur'an, sure 18 el Kehf, ajeti 67, 68

⁵² Po aty, 69

fshehur të vërtetat, e si mund të durontë! Por, pasi që Robi i Mirë, e mori premtimin, nga Musau, se do të durojë, i tha: “Nëse më shoqëron mua, atëherë, mos më pyet për ndodhitë e gjërave, derisa, unë nuk të trego!”⁵³

Kjo është urtësia, njeriu, që nuk është i informuar nga Allahu i Lartësuar me të vërtetat, fshehtësitë e tyre, e bëjnë atë që të gjykojë nga jashtë. Ai që nuk e sheh realen, ai nuk mundë t’u kuptojë, prandaj pëlçet, dhe e humb durimin. Edhe pse Musau ishte i dërguari Allahut, edhe pse Ai fliste me të, ai nuk mundi të durojë pranë veprave, të cilat ishin të fshehura për të, nga Allahu i Lartësuar. Kur kjo i ndodhi Musaut a.s., atëherë çfarë pritet nga ne, si njerëz të rëndomtë, të ndodhë, kur t’i shohim ato para syve tanë?

Kemi raste të shohim individë, të cilët bëjnë mëkate, por në anën tjetër, Allahu i Lartëmadhëruar, vazhdon t’u japë mall. Kemi të tjerë, të cilët mëkatojnë dhe bëjnë dëme, megjithatë, Allahu i Lartësuar, u jep pushtet. Po ashtu, kemi njerëz të tretë, të cilët mëkatojnë dhe bëjnë ngatërresa në tokë, por gjithashtu jemi dëshmitarë, se Allahu nuk i përmbys ata, por përkundrazi, populli fiton përshtypjen se ata janë të pamundshëm dhe bëjnë çka të dëshirojnë.

Me këtë, i Lartësuari, dëshiron të na thotë se: ajo, çfarë ju po shihni, është vetëm pamja e jashtme e shpellës. E vërteta është e fshehur, ai që ndodhet brenda saj dhe hulumton në të, do të mund t’u gjejë diturinë Time, dhe do të mësojë atë, çfarë Unë dëshiroj t’i jap.

Prandaj, mos gjykoni vetëm pamjet e jashtme. Nuk do të thotë që mirësia, e cila duket nga jashtë, të jetë përfundimtare, ajo mund të mos jetë realja. Gjithashtu, mos gjykoni ndodhitë e këqia, si të tilla. Mundet, që diçka t’u ndodhë ju dhe, paragjykimi juaj e nxjerr atë si vepër të shëmtuar dhe shumë të keqe, por pas një kohe, pasi që të jenë zbuluar shumë gjëra dhe t’ju hiqet perdja e fshehtësive, do të konkludoni se ajo e “keqe” paska qenë e dobishme. Si dhe, mund të ndodhë, të keni një ditë shumë të hareshme dhe me plot gëzim. Atë ditë do t’u përkujtoni si një ditë të mirë, por pas një kohe do të ndërroni mendje, sepse do t’u kuptoni se ajo ditë paska qenë një ditë e kobshme, ditë që do t’u mallkojë atë gëzim dhe do të thoje pastaj ‘ah’, sikur mos të ndodhte ai gëzim.

Këso shembujsh, të shumtë, janë nga përditshmëria jonë. Kemi shumë shanse, që na humbin në jetë, dhe ato na ngelin në mendje si shanse të mira, por të humbura. Mërzitemi për këto shanse të humbura. Por, pas një kohe, na jepen shanset e tjera edhe më të mira se ato të kaluarat. Kjo është nga Urtësia e Allahut xh.sh, të na pengojë diçka, për të na dhuruar diçka tjetër edhe më të mirë. Gjithashtu, vlen edhe për veprat e parallogaritura për momentin, si të këqia, por pas një kohe, befasoni për të mirë, sepse ajo vepër paska qenë e mirë.

⁵³ Po aty, 70

Pastaj i përkulemi Allahut xh.sh dhe e falenderojmë, Atë, për atë të “keqe”. Të gjithë ne, nëse e kthejmë shiritin e kasetës, së jetës sonë, do të shohim me dhjetra ngjarje, që na vërtetojnë këto urtësi.

Por ja që, ne nuk durojmë, edhe pse, i dimë këto realitete. Përderisa, urtësia na është e fshehur, gjoksat tanë ngushtohen dhe kështu e humbim durimin. Pozita e besimtarëve duhet të ndryshojë, ata e dinë se, e mira është ajo, që e ka caktuar Allahu i Lartësuar për ta, kurse e keqja qëndron në mos kryerjen e veprës ose largimin momental të saj.

Pas gjithë kësaj që thamë, të kthehemi tek tregimi i Musaut a.s. dhe Njeriut të Mirë. Kur hyn eksperimenti, në vet ngjarjen e ndodhisë të cilën e përjetojmë, çfarë ndodhë? Teoria është diçka tjetër, kurse praktika krejtësisht diçka tjetër. Kur ndodhë ngjarja, njeriu nuk e zotëron veten. Ai për momentin harron çdo gjë, tek ai do të mbisundojë pamja e jashtme e asaj ndodhie dhe, padyshim, do t’a kapë pesimizmi. Për këtë arsye, besimtari duhet të jetë shumë vigjilent. Ekziston, dallim i madh, ndërmjet ndjenjës së brendshme të njeriut dhe fjalës ose shprehjes së thënë. Ky moment, është i përballueshëm dhe njeriu e kalon këtë lehtë, por e ka shumë të vështirë të durojë, kur është në brendësi të vet ngjarjes dhe është duke e përjetuar.

Musau me Robin e Mirë hypën, në një anije. Ajo ishte pronë e disa të skamnorëve. Musau, si peygamber i Allahut, kishte konsideratë ndaj skamnorëve, sepse mësimi dhe edukimi tij, ishte që njeriu duhet të përkujdeset për skamnorët. Detyrë e tij ishte që t’i ndihmojë ata, për aq sa i jepej mundësia për t’i ndihmuar. Sapo hypën në anije, Robi i Mirë, në vend se t’i ndihmote ata, t’i shpërblente ose të paktën t’ju riparonte atyre anijen e vjetër, ai filloi t’ju prishë anijen edhe më tepër, ose më saktë e zhvrimosi atë. Musau, para kësaj skene, nuk mundi të durojë.

Si mundej që, Robi i Mirë, t’a bënte një gjë të tillë!? Si mundi që t’a zhvrimosë anijen, e cila, për ta, ishte burim i vetëm i jetës dhe, me të, mezi furnizoheshin!? Si mundi, që t’jua humbë shpresat e riparimit të saj, se edhe pse ajo ishte e vjetër, ishte në gjendje të rregullt. Ajo anije, ju shërbente skamnorëve, dhe i ushqente ata.

Duke qenë në këtë gjendje psikike, nën presionin mendor, durimi i Musaut a.s. plasi. Nuk u përmajt dhe i tha: “...e shkatërrove (zhvrimose) atë, për t’i fundosur udhëtarët! Bëre një gjë monstruoze (*shumë të urryer*)!”⁵⁴. Robi i Mirë, nuk vonoi dhe menjëherë ia përkujtoi marrëveshjen, para se të niseshin: “Tha: A nuk të (paralajmërova) thashë se ti, nuk do të tregohesh i durueshëm me mua”⁵⁵ E pranoi Musau a.s. vërejtjen e tij, pastaj kërkoi falje, se nuk do t’a përsëriste më

⁵⁴ Po aty, 71

⁵⁵ Po aty, 72

gabimin: “Tha: Mos ma merr për të keq, e kisha harruar fare porosinë tënde, që ma bëre dhe mos më ngarko, me gjëra të vështira (unë dua të mësoj prej teje, prandaj, të lutem, mi thjeshtëzo gjërat).”

SIKUR T’I JEPEJ DITURIA

Pa dyshim, sikur t’i jepej Musaut a.s., dituria e Robit të Mirë, edhe ky, kishte për të vepruar me anijen, sikur Robi i Mirë. Dituria, për Musaun, ishte e kornizuar, kjo e bënte atë të tensionuar dhe të mos duronte pas ndodhive.

Robi Mirë, vazhdoi rrugëtimin me Musaun a.s. Gjatë këtij rrugëtimi, Robi i Mirë, e ndaloi një çun dhe, pa u hamendur fare, e mbyti atë. Ishte skandaloze, vepër shumë e shëmtuar, ky veprim, e bëri Musaun a.s., të mos përmbahej. Si gjykoj ky njeri, ose Robi Mirë, t’a mbyttë fëmijën, pa ndonjë shkak!? Ai, nuk kishte bërë asgjë. Mbytja e fëmijës, në krahasim me shkatërrimin e anijes, ishte shumëfish më e madhe. Prandaj, Musau a.s. iu drejtua: “ ...si e vrave një person të pastër, (*të pafajshëm, pa asnjë mëkat*) që nuk ka vrarë njeri!? Vërtet, bëre një gjë të shëmtuar”

Këtu, duket qartë dallimi ndërmjet personit, i cili, ka informacion të gjërë ose më saktësisht të vërtetën, dhe atij, që nuk posedon informacionin e duhur mbi të vërtetën. Për njeriun e thjeshtë, vrasja e një çuni, të bën të mos përmbahesh dhe, në këso raste, revoltimi është i padiskutueshëm. Duke e vërejtur gjendjen e Musaut a.s., Robi i Mirë nuk vonoi dhe ia përkujtoi premtimin, që ia kishte dhënë, para se të nisej me të, në shoqërim, dhe i: “Tha: A nuk të (paralajmërova) thashë, se ti nuk do të tregohesh i durueshëm me mua”

Përnjëherë, Musau a.s. erdhi në vete, duke i shprehur keqardhje për mosdurimin e tij, për të dytën here, dhe i: “Tha: Nëqoftëse pas kësaj here, do të të pyes përsëri, për ndonjë gjë, atëherë mos më lejo, që të vazhdojmë rrugëtimin tonë. Tash e tutje, ke marrë arsye të plotë prej meje (që t’a ndërpresësh shoqërimin së bashku, sepse mjaft më ke duruar).”

Me këtë përgjigje, sikur i kërkoi falje Musau a.s. Me shumë keqardhje i thotë, sikur, edhe unë të dua, ti mos më lejo të vazhdojmë së bashku, sepse durimi me ty qenka shumë i vështirë.

Vazhduan rrugëtimin së bashku, derisa arritën në një fshat. Ishin të huaj dhe nuk njihnin njeri. Kërkuan nga fshatarët që t’i ushqejnë. Sipas zakoneve, nëse një i huaj kalon në mes të fshatit, vendasit duhet t’ju afrojnë ushqim. Ky gjest, është nga natyra e vet qenies njerëzore. Ky gjest, nuk do gjykim të veçantë, edhe nëse ata nuk kërkojnë ushqim, ata janë të huaj dhe nuk duhet diskutuar. Kur zakonet njerëzore duhej të ishin të tilla, atëherë çfarë mund të thuhet, kur ata kërkojnë ushqim, ngase janë të uritur, kërkojnë kafshata sa për t’a thyer urinë ekstreme. Fshatarët refuzuan për t’i ushqyer!

Dy të huaj të uritur, – Musau a.s.dhe Robi Mirë, hynë në fshat, kërkuan nga fshatarët disa kafshata buke, por u refuzuan. Nuk pranuan t’ju japin asgjë! Çfarë mund të thuhet për këta njerëz? Ata nuk meritojnë kurrfarë mirësie, përkundrazi, ata duhen qortuar.

Për çudi, Musau a.s., u befasua kur pa Robin e Mirë, se ju afrua një muri gjysëm të shkatërruar, në atë fshat, dhe filloi t’a riparojë. Jo vetëm e riparoj, por edhe e zbukuroj, atë mur. Sjellja e tij, tani Musaun e tronditi edhe më tepër. Kishin kërkuar nga fshatatrët disa kafshata buke, sa për t’a thyer urinë e madhe që kishin, kurse ky po i ndihmonte ata. Kjo tronditje, Musaun a.s., e shokoi, nuk u durua dhe i tha me zë, paksa më të ngritur. Ata refuzuan të na ushqejnë, e ti po ua riparon murin, bile po e zbukuron atë?! A ky është shpërblimi i tyre!? Do të ishte më mirë, sikur të goditeshe me ta, për këtë punë. Të paktën sa për të ngrënë, e jo të punosh falas, sepse këta qenkan njerëz, të cilët, nuk e meritojnë, këtë mirësi. Kur’ani, këtë, e përshkruan kështu: “...po të doje, për këtë që bëre, do t’u kishe marrë shpërblim.”

Kjo përzierje e tretë, u bë shkak i ndarjes, ndërmjet Musaut a.s. dhe Robit të Mirë. Ai, i kishte premtuar, se do të ishte i përmbajtur dhe i durueshëm, por më kot, ia fali dy herë. Ashtu siç ishin marrë vesh, hera e tretë do të ishte ndarje mes tyre. Atëherë, i tha Robi i Mirë: “Kjo është ndarja (*jonë*) mes meje dhe teje...”

Nuk e ndërpreu me kaq takimin, e të ikte përnjëherë, por ia sqaroi të gjitha urtësitë e veprimeve të tij. Ia përkujtoi shkatërrimin e anijes, dhe i tha: atë e bëra për të mirën e skamnorëve. Mbreti i tyre, ishte një njeri i pamëshirë dhe mizor. Kishte urdhëruar që secila anije, që ishte në gjendje të rregullt, pa marrë parasysh se e kujt ishte, të sekuestrohej. Për t’ua shpëtuar anijen atyre, e prisha një grimë të vogël. Prishja ishte aq, sa mos t’ju sekuestrohej. Kështu ju mbeti anija edhe më tutje. Tani të pyes, cila ishte më e favorshme për ta? Ta kishin, më tutje anijen me një prishje të vogël, të cilën, do t’a riparonin për një kohë shumë të shkurtër, apo t’ju sekuestrohej anija? Sikur t’ju tregoja rastin ose këtë urtësi atyre, pa dyshim që ata vetë do të kishin parapëlqyer prishjen e saj. Prandaj konsideroj se kjo që bëra, ishte një e mirë e madhe për ata të shkretë. Por, ja që mungesa e urtësisë, e bëri Musaun të papërqëndrueshëm, dhe nuk duroi për një sekuencë të vogël kohore për t’a vërtetuar realitetin.

TAKOI NJË ÇUN DHE E VRAU

Tani të shohim tregimin e fëmijës, të cilin, e vrau Robi i Mirë. Çfarë urtësie kemi këtu? “...dhe të dy prindërit i kishte besimtarë, prandaj kishim frikë se ai (vazhdimisht)do t’ju shkaktonte dhembje derisa (me kalimin e kohës do të detyroheshin prindërit tij) të bëheshin femohues”

Secili prind, e ruan fëmijën e vet si bebzën e syrit. Ata i kushtohen atij, dhe i lënë përshtypje shumë të mira në këtë botë. Por, kur prindi e vëren se fëmija po i shkakton dhembje, po i mundon dhe do t'i nxjerrë probleme, deri në atë masë, sa ata të bëhen mohues të fesë, duke qenë se ishin besimtarë të mirë, padyshim, që do t'a lutnin, të Madhërishmin, për t'ua zëvendësuar atë, me një fëmijë tjetër dhe besimtar.

Këtë gjë e vërejmë shpesh herë, në jetën tonë të përditshme, kur djali ose vajza bëhen problematikë. Prindërit, joshen pas tyre dhe gabojnë kundrejt parimeve fetare. Ndodh, që për hir të tyre, të vjedhin, ose të bëjnë vepra të liga, të cilat e hidhërojnë Allahun. Këtë, e bëjnë vetëm sa për t'ua plotësuar dëshirat atyre. Ndodh që t'a mbulojnë sekretin, për shkak të fëmijës të tyre. Prindërit, gjithmonë, janë të dobët përballë kërkesave të fëmijëve.

Prindërit e mirë, nuk shikojnë vetëm këtë botë, por ata mendojnë edhe ahiretin, ose botën tjetër. Këta prindër, para se t'a fusin dorën në diçka të huaj, e dinë mirë se do të japin llogari, gjithashtu e dinë se, për shkak të fëmijës të tyre, do të dënohen. Kjo pasuri nuk i bën të kënaqur, por, përkundrazi, ata i iriton vepra e shëmtuar. Vepra, që e hidhëron Allahun e Lartëmadhëruar, duhet të jetë e padëshirueshme, sado e këndshme të jetë ajo, për kënaqësitë e kësaj bote. Kurse, sa i përket prindërve jo të mirë, ose mohuesve të fesë, këto vepra i kënaqin. Njeriun besimtar, nuk e bën të kënaqur asnjë pasuri e botës, e cila arrihet në formë vjedhjeje, ai është i bindur se ajo pasuri e hidhëron Allahun. Me pasuritë e paligjshme, njeriu nuk arrin askund. Padyshim, ai me të nuk ndien kënaqësi, por përkundrazi, do të ketë vuajtje të vazhdueshme. Ajo, do t'a përcjellë si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër, edhe pse, në pamje të jashtme, duket se çdo gjë është në rregull.

Nëse, prindërve të mirë, iu jepet mundësia të zgjedhin: T'ju dhurohet fëmijë, por që do të jetë problematik dhe që do të bëhet shkaktar, që ata t'a humbin fenë; ose të zgjedhin, alternativën tjetër, që të mos u jepej fare fëmijë, pa dyshim, që ata do të zgjedhin të dytën. Ata do të jenë të bindur, se për ta, do të jetë shumë më mirë t'a kalojnë jetën pa fëmijë, sesa të kenë djalë ose vajzë, që vazhdimisht do t'ju sjellë probleme dhe, në fund, edhe do t'i nxjerrë nga besimi, në Allahun xh.sh.

Të supozojmë, sikur i Lartëmadhëruari, t'ju tregonte për ardhmërinë e djalit të tyre. T'ju tregonte se, ai kur të rritet do t'i shpiente ata në zjarr dhe, në të njëjtën kohë, do t'ju jepte mundësinë e përzgjedhjes. Pa dyshim, se ata kishin për të thënë se: nuk e duam, fare, këtë fëmijë. Këtu, kemi të bëjmë me përzgjedhjen e njeriut të mirë, i cili do të zgjidhte, nëse do të shkonte në zjarr, apo do t'a pranonte dhuratën e Zotit për të patur fëmijë.

Kjo ngjarje, tregon se, Allahu i Lartësuar, për këta prindër të devotshëm, paska zgjedhur më të mirën e mundshme. Bile, zgjodhi nga mëshira e Tij e Madhe, që

fëmia i tyre të mbytet, për të parandaluar krimet, që ata do t'i bënin në këtë botë. Kështu, Ai, nga mëshira, do ti bashkojë përsëri me fëmijën e tyre në xhennet. E dyta, i Lartësuari nga vullneti Tij i mirë, kishte zgjedhur që, atyre, atë fëmijë, t'ia zëvendësojë me një tjetër të mirë dhe besimtar. Ai, në Kur'anin Kerim, thotë: “Dhe deshëm, që t'ua zëvendësojmë atyre me një tjetër, i cili, do të jetë më i mirë, më i mençur, më i afërt dhe më i mëshirshëm për ta”⁵⁶

Vullneti Allahut të Lartësuar, zgjodhi për ta zëvendësues të fëmijës, i cili parashikohej të ishte problematik dhe i cili do t'i shpiente prindërit në mohim të Allahut, me një fëmijë të mirë dhe bamirës.

Kur ne i përcjellim ngjarjet, ato nuk duhet t'i ndërlidhim me ngjarjet e kohës, sepse ajo është vepër dhe matës, që na përket vetëm neve. I Lartësuari, nuk ka të bëjë me kohën. Prandaj, çdo gjë, kur duhet t'a prezantojmë, atë duhet t'a ndërlidhim mes veprës dhe shpërblimit. Mëkati i bërë nga ne, e gëzon vetëm armikun. Ai, i gëzohet mëkatit tonë, sepse, ai, mund të jetë bërë me para haram, ose me pasuri të huaj, ose është bërë ndonjë krim, ose është përdorur forca. A ia vlen që e gjithë keqbërje të bëhet vetëm sa për ta kënaqur veten, ose dikë tjetër dhe atë për një periudhë të shkurtër kohore?

Këto sjellje dhe veçori, nuk i përkasin dhe vlejnë për njeriun besimtar. Ai, i sheh gjërat me një sy tjetër dhe është i bindur, në shpërblimet që e presin. Ato, i sheh sikur t'i kishte para vetes. Për momentin, ato janë sekret, si për besimtarin, ashtu edhe për jobesimtarin. Por, jo, mosbesimtari shpërblimet nuk i sheh fare, sepse, ai, atyre nuk ju beson fare. Sikur shpërblimi të ishte i hapur, atëherë ata do të ishin të barabartë, si në ushqim, ashtu edhe në gjëra të tjera, psh., sikur t'a mbushnim një dhomë me flori, e atë do t'ia ofronim një njeriu, dhe do t'a paralajmëronim se ky mall është mbledhur prej haramit, por, që ky është caktuar për ty. Do t'i themi merre, dhe kënaqu me të, për një kohë të caktuar. Por menjëherë, do t'ia kishim hapur derën tjetër, dhe aty, ai do të shihte dënimin e Allahut, në zjarr të xhehennemit. Pasi ta ketë parë dënimin, përsëri do t'i themi atij, nëse e merr këtë pasuri të haramit, do të fusim në këtë dhomë për t'u ndëshkuar. Pas këtij shpjegimi, pa dyshim, ai nuk do të përpiqej të merrte asnjë copë floriri. Kështu, nuk do të kishte njerëz, që do të gabonin ndaj Zotit.

Dallimi mes besimtarit dhe jobesimtarit, qëndron aty se, njeriu besimtar këto gjëra i sheh në mendje, edhe pse, e ardhmja e tij është sekret. Në momentin, kur besimtari e zgjat dorën për t'a marrë pasurinë e haramit, atij i paraqitet, para syve të tij, pamja e xhehennemit dhe dënimi i Allahut. Menjëherë, e largon dorën, kërkon falje për gabimin, që kishte për t'a bërë. Kurse, jobesimtarit ose ateistit, nuk i paraqitet kjo pamje. Atij, nëse i thuhet dhe i tregojnë për të ardhmen e botës tjetër, ai do t'a refuzojë, ose të paktën do të mundohet t'a refuzojë. Do të

⁵⁶ Kur'an, sure 18 el Kehf, ajeti 81

përpiqet që t'a bindë veten, se këto gjëra janë të pavërteta. Kështu, ai do të vazhdojë së vepruari, duke supozuar dhe mashtruar veten, se nuk ka ndëshkim, pas kësaj bote. Ajo, që e kënaq atë, është pasuria dhe fitimi i momentit, ai nuk llogarit për jetën e botës tjetër, sepse e vërteta para tij është e errët.

Njeriu besimtar, mëkatet i sheh si ndëshkim prej Allahut, kurse, njeriu ateist, mëkatet i sheh, si shkathtësi të tij dhe fitim. Duke qenë se ndryshojnë teoritë, ndryshojnë edhe veprimet. Ajo që është më e rëndësishmja, e vërteta mbetet, edhe pse për momentin është e fshehur për ne. Për çdo veprim, do të përgjigjemi.

CILA DO TË ISHTE PËRZGJEDHJA E PRINDËRVE?

Tani, të kthehemi, përsëri, tek tregimi i vrasjes së fëmijës, nga Robi i Mirë. Sikur mos t'a kishte fëmija exhelin⁵⁷, do të jetonte një jetë përplot ngatërresa. Ai, me siguri, kishte për t'i detyruar prindërit të "vjedhin", ose të ballafaqoheshin me llojlloj ngatërresa me të tjerët, etj. Këtë, ata do t'a bënin për t'ia plotësuar dëshirat fëmijës. Këtu, edhe shtrohet pyetja, cila do të ishte më e mirë për prindërit, t'a kishin në jetë ende këtë fëmijë, apo më mirë, për ta, do të ishte t'u zëvendësohej ai, me një fëmijë tjetër besimtar, të mirë dhe i pranueshëm, për këtë botë dhe tjetrën?

Sikur t'a kishin informacionin e duhur për të ardhmen, me siguri, ata do t'a kishin zgjedhur më të mirën. Meqenëse, ata, ishin të bindur në përgjegjësitë e tyre dhe besonin në ringjallje, ata, do të ishin të kujdesshëm nga provimet e përditshmërisë së kësaj bote. Ata ishin zemërfortë dhe ishin përplot bindje.

Po çfarë ndodhi në realitet? Shikuar nga jashtë, ajo që ndodhi, ishte e shëmtuar dhe skandaloze. Kurse, kjo vepër, në realitet, nëse kërkohej e vërteta, për prindërit e fëmijës dhe për vetë fëmijën, ishte vepër e mirë. Por, problemi, qëndron që, atyre, nuk iu është shpalosur sekreti i së ardhmes, prandaj, njeriu i thjeshtë, këtë do t'a konsiderojë si vepër shumë të keqe.

Çuditërisht, ne, në jetën tonë të përditshme, bëjmë vepra të shumta, për ngritjen e standarteve dhe për një ardhmëri më të mirë. Prindërit, shpeshherë, privojnë vetet nga shumë sende, ata, shpesh here, nuk i shijojnë kënaqësitë e kësaj jete. Këtë, e bëjnë për t'i kënaqur fëmijët e tyre, sa më shumë. Ata mendojnë për t'i shqyrtuar ata, sa më mirë dhe më lehtë. E gjithë kjo sakrifikicë e tyre, bëhet me qëllim që ata të bëhen të sjellshëm, të ndershëm dhe të zotët e vetvetes. Ata mundohen, që jeta e fëmijëve të tyre, të jetë shumë më e mirë se vetë jeta e tyre, që kanë jetuar. Njeriut të sëmurë, i ndalohet të hajë ushqimet që i pëlqen, nëse nuk i ka në recetë. Po e njëjta gjë, është edhe me pijet që i shijon, ose shumë gjëra, që zemra ia parapëlqen. Ai detyrohet të marrë barnat dhe t'i shijojë

⁵⁷ Momenti i vdekjes është i caktuar nga Allahu xh.sh, kjo, në arabishte, quhet exhel

idhtësirat e tyre. Këtë e bën pa dëshirë, ai rënkon për një kohë të gjatë, deri në përmirësim të shëndetit. Ky është rrugëtimi i kësaj jete, nuk ka ndryshim në të. Duke qenë se po flasim për jetën e kësaj bote dhe ahiret⁵⁸, disa njerëz harrojnë ahiretin dhe llogaritë, që do t'i japin atje, ata nxitojnë në grumbullimin e sa më shumë pasurive, duke mos shikuar se si grumbullohet, apo a është haram.

Të habit fakti, se disa njerëz e privojnë veten për një kohë të gjatë nga kënaqësitë e kësaj bote. Ata i sheh duke vuajtur. Ata, gjithnjë, janë në kërkim të një dite tjetër më të mirë. Orvajtjet e tyre, janë sikur të gjithë të tjerët, atë e bëjnë për t'a shijuar, edhe ata, këtë jetë.

Por edhe pas të gjitha këtyre sakrificave, po këta njerëz, çuditërisht, i sheh se janë mohues së All-llahut. Në fakt, jeta e tillë e tyre, është e kotë. Gjithashtu, janë të pakënaqur, por, fatkeqësisht, mëkatojnë. Shembulli i tyre, është sikur lojërat e fëmijëve, ata harrojnë se fëmijët bëjnë, atë, që ua ka ënda atyre, por nëse vazhdojnë me avazet e tyre, ata duhet t'a dinë se, një ditë, do të rriten dhe nuk do të gjejnë punë të përshtatshme.

Realiteti i kësaj bote është edhe më i përpiktë, sepse ditët i kemi të numëruara në këtë botë, kurse jeta e ahiret është e përhershme. Të mirat e kësaj bote, varen nga mundësitë që ia krijon njeriu vetes, me dëshirën e Allahut, kurse, në ahiret, njeriu disponon vetëm me kënaqësitë e Allahut të Larësuar, të cilat, janë të panumërta. Dallimi, mes mundësive të Allahut dhe të njeriut, janë të pakrahasueshme. Kjo botë, kënaqësitë i ka të caktuara. Nëse njeriu shpenzon pa masë, shkatërron shëndetin e vet dhe, njëkohësisht, nuk do të arrijë të kënaqet.

Derisa ai e tepron në shpenzimin e një ushqimi, ilaçi i tij, një ditë, do të jetë ndalimi i atij ushqimi. Kështu, për secilin që shpenzon tepër, për çfarëdo lloji kënaqësie të kësaj bote, Allahu i Lartësuar do t'ia ndalojë atij atë. Ai do të bëjë që, ai mos të arrijë deri tek ajo. Kurse, bota e ahiret është ajo, që syri i njeriut kurrë nuk ka mundur të shohë, e as veshi kurrë nuk ka dëgjuar, dhe gjithsesi as që i ka shkuar ndërmend, ndonjëherë, ndonjë njeriu se mund të ketë gjëra të tilla.

Imani është rezultat ose urtësia e gjithë kësaj që thamë. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar, na tregon se: "...dhe të dy prindërit i kishte besimtarë". Allahu, këtu, na paraqet një të vërtetë shumë të rëndësishme. Ai, na kishte paralajmëruar, se prindërit ishin të mirë dhe besimtarë. Ky iman, dhe ky sinqeritet i tyre, ndaj Krijuesit, ju mundësoi atyre të kanë mundësi të zgjedhin. Ata do të zgjedhin: t'a kenë ose mos t'a kenë fëmijën.

Këtyre, ju preferua, kjo e dyta. Po të gjykojmë me parametrat e kësaj bote, do të konkludonim se kjo vepër ishte e shëmtuar. Me këtë vepër, Zoti, e ruajti imanin e tyre. Ai, ishte i mëshirshëm, si për prindërit, ashtu edhe për fëmijën. Në anën

⁵⁸ Ahiret – bota e amshueshme

tjetër, atyre ua zëvendësoi, atë, me një fëmijë tjetër. Duke e zëvendësuar, atë, me një tjetër, Ai e shpëtoi fëmijën e mbytur, nga sprovat e kësaj bote. Pra, sikur, vërtet, i Lartësuar i t'ju mundësonte prindërve të zgjedhin, për këtë tregim, me siguri, që ata kishin për t'a zgjedhur këtë, të cilën edhe u bë. Në të njejtën kohë, do të ishin falenderues ndaj Allahut, i cili i mëshiroi nga Mirësia e Tij. Por, më e rëndësishmja, që nuk duhet të na mungojnë asnjëherë, është imani.

VEPRA E MIRË ... NUK ZHDUKET

T'i kthehemi, tani, të vërtetës së tretë. Tek fshati i kopracëve. Fshatarët nuk i ushqyen ata të dy, edhe pse, këta kishin kërkuar nga fshatarët për t'i ushqyer. Dy të panjohur, shumë të uritur, kishin hyrë në fshat. Gjëja më e rëndomtë, do të ishte që fshatarët të tregoheshin bujarë. Nëse, një i huaj hyn në një fshat, pikë së pari, atij i ofrohet ushqim. Ai mund të mos jetë i uritur, por nëse ai tregon se është i uritur, fshatarët janë të detyruar që t'a ushqejnë atë. Kurse këta fshatarë, Musaun dhe Njeriun e Mirë, edhe pse dukeshin nga pamja e jashtme, se ishin shumë të uritur, i keqpritën, bile edhe i qortuan. Nga uria e tepërt, ata, si duket, nuk i kishin dëgjuar qortimet e tyre, ata kërkonin ushqim pa pretendime, nuk kërkonin ndonjë ushqim të veçantë ose llojllojshmëri të gjellrave, kërkesa e tyre ishte shumë e vogël, disa kafshata bukë, sa për t'a larguar urinë ekstreme.

Fshatarët refuzuan edhe këto kërkesa të thjeshta. Gjatë rrugës përmes fshatit, Njeriut të Mirë, i shkoi syri tek një mur, i cili ishte duke u rrëzuar. U drejtua drejt atij muri, dhe filloi t'a riparojë. Musau, nuk kishte si të duronte dhe tha: Populli i këtij fshati, refuzoi të na japë dy kafshata bukë, e ti po ua riparon këtë mur pa pagesë, po ua zbukuron fshatin, si shpërblim të qortimit të tyre ndaj nesh! Kjo është një çudi e urryer!

Pas kësaj kërkesë ose situate, Musaut a.s., i tregohet e vërteta e kësaj veprë humane, prej Njeriut të Mirë. Vërtet, fshatarët nuk e meritonin këtë të mirë, por, kjo vepër e tij, nuk u dedikohet fshatarëve. Ky mur ishte pronë e disa fëmijëve jetim. Një njeri i mirë, i këtij vendi, e kishte njohur mirë, mentalitetin e fshatarëve të tij. Ai e paska ditur se këta janë matrapazë, nuk i mbajnë premtimet, dhe nuk janë mikpritës. Ata janë kopracë, dhe asgjë nuk shpenzojnë në emër të All-llahut xh.sh. Vërtetë, Allahu ju paska ndaluar, që këtyre t'ju bëhet mirë. Por, njeriu i mirë i këtij fshati, para se të ndërronte jetë, ju kishte lënë, fëmijëve të tij, një thesar, poshtë këtij muri.

Këtu ishte edhe ndarja, ndërmjet Musaut dhe Njeriut të Mirë. Pasi, u sqaruan këto urtësi të Allahut, në këto ngjarje, vërejmë se urtësia ndryshon njëra prej tjetrës.

Shikuar nga një këndvështrim, ose të bazuar në logjikë, dy veprimet e para të

Njeriut të Mirë, dukeshin si shumë të këqia, të shëmtuara dhe të papranuara. Por ja, që e vërteta e tyre, ishte krejtësisht e kundërt. Një prishje e vogël e tragetit, i shpëtoi, ata të shkretë, nga tirania e sundimtarit të kohës, që mos t'ua uzurponte atë. Në ngjarjen tjetër, vrau fëmijën, për t'i shpëtuar prindërit e atij fëmije, por, atë, e zëvendësoi me një fëmijë tjetër të mirë.

Kurse, ngjarja e tretë, ka të bëjë me fshatarët jo mikpritësa. Megjithatë, Njeriu i Mirë, ju bëri një “shërbim”, ai ju riparoi murin, që po rrëzohej. E vërtea e këtij muri ishte se, Njeriu i Mirë nuk i shërbeu atyre, por i pengoi, që ata të arrijnë deri tek thesari. Këtë e bëri, ngase fshatarëve ju ishte e ndaluar bamirësia.

Muri i shkatëruar, poshtë tij, kishte një thesar. Ky thesar, u përkiste dy fëmijëve jetim, që jetonin në qytet. Babain e kishin patur të mirë. Pasurinë e dikujt, normalisht, se duhet t'a trashëgojnë fëmijët. Babanë e mirë, Allahu, e përgëzon me fëmijë, që do t'a trashëgojë pasurinë e tij, që të jetë pjesëmarrës në furnizimin e tyre. Ky shpërblim, ishte i Allahut xh.sh., për shkak të veprës së tij të mirë.

Shtrohet pyetja. Vërtetë a do ta trashëgonin atë thesar, këta dy fëmijë? Jo, gjithsesi se jo. Gjykuar sipas sjelljeve dhe moralit të fshatarëve, të cilët, nuk pranuan t'i ushqejnë dy të uriturit. Sikur, rastësisht, t'a kishin gjetur thesarin, ata, kishin për t'a marrë për vete. Ata nuk do t'ua jepnin fëmijëve, atë. Për shkak të moralit të dobët të fshatarëve, Allahu i Lartësuar, ua kishte ndaluar atyre çdo bamirësi ose thesar. Veçanarisht, kur ishte në pyetje, vepra e mirë e babait të fëmijëve. Ai, ua ruajti atyre, atë thesar, derisa të rriten.

Kjo ishte një nga urtësitë, dhe të fshehurat. Çfarë ishte e qartë para fshatarëve? Në fshatin e tyre, u futën dy të panjohur, të uritur. Ata refuzuan t'i ushqejnë ata dy, kurse njëri prej tyre, u bëri një të mirë, u riparoi dhe e zbukuroi një mur brenda fshatit të tyre.

Sikur të ishte banor i atij, dhe t'a përjetoje këtë ngjarje, do të thoshe Subhanallah (i Lartësuar është Allahu)! Populli i tërë, refuzoi t'i ushqejnë dy të huaj, të uritur. Refuzuan, urdhërin e Zotit, ndaj përkujdesit të skamnorëve. Në vend të bujarisë, që duhej të ishte shpërblimi tyre, ata shprehën urrejtje dhe nuk ju dhanë as dy kafshata bukë. Më pastaj, vërejmë që njëri prej tyre, ashtu i lodhur, ngrihet dhe e riparon një mur. Jo vetëm kaq, por edhe e zbukuron atë. Me siguri, do të drejtoheshe drejt qiellit duke thënë: O Zot, ç'po më shohin sytë! Ke dërguar njeri, t'ju riparojë murin këtyre, fshatarëve të poshtër, të cilët, nuk i ushqyen këta të shkretë!? O Zot, si t'ju shpërbehet këtyre të poshtërve, në këtë mënyrë?!

Do habiteshe me ato sjellje, si po e nënshtrojnë, Allahu i Lartësuar, një njeri, ndaj një populli, i cili është shumë larg bindjes së besimit dhe kërkon, prej tij, t'a zbukurojë fshatin e tyre. Kjo e shtyri, Musaun a.s., që të mos durojë. Por, kur atij iu shpalua e vërteta e atij veprimi, ai kuptoi se fshatarët nuk kishin kurrfarë dobie prej asaj “mirësie”, përkundrazi, ajo ishte ndalesë e të mirave të tyre. Për ata, që

nuk e dinin përfundimin, kjo vepër konsiderohej dhuratë, kurse realiteti ishte krejtësisht i kundërt.

I Lartësuar, na solli këto shembuj në këtë sure, për t'ia tërhequr vërejtjen, qenies njerëzore, të mos nxitojnë në gjykimet e veta. Që ata të jenë të bindur, të përdorin logjikën e tyre, por, pa u nxituar. Sikur ju thotë atyre, dituria absolute është tek Unë, kurse ju, mos këmbëngulni në fjalën përfundimtare, me të gjitha ato argumente, që i keni para jush.

Unë e di, se gjoksi juaj ngushtohet, para ngjarjeve, të cilat ju shtyjnë t'a humbni durimin. Ju habiteni, kur shihni, se disa ngjarje “shumë të rënda e të këqia”, i kapin njerëzit e mirë dhe të devotshëm, kurse, në anën tjetër, shihni “shumë të mira”, tek personat, që bëjnë mëkate. Mos paragjykoni se ky është përfundimi tyre. Ajo, se çfarë ju shihni, është logjika juaj, kurse e vërteta absolute qëndron tek Unë. Ndodh që, e servuara para jush, të jetë e kundërta e së vërtetës. Atë, që ju e vlerësoni të dëmshme, mund të jetë e mirë e madhe, kurse atë, të cilën ju mund t'a vlerësoni të mirë, mund të jetë e dëmshme ose pengesë e mirësive tuaja.

SHPELLAT E JETËS

I Lartësuar, me anë të këtyre shembujve, na bëri me dije se, jeta është përplot shpella. Në brendi, gjenden, të vërtetat. Njeriut, nuk i mbetet gjë tjetër, veçse të gjykojë pamjet e jashtme, por gjithnjë duke e parandier se atij i fshihen gjërat. Duhet t'a ketë të qartë secili njeri, se bie në caktim (ose fatkeqësi), që nuk ka patur alternativë për të. Kur atij, do t'i ndodhte, ai paracaktim i Allahut, duhet t'a kuptojë se aty kemi urtësi. Thamë më parë, se ajo, jo gjithnjë, është e dukshme. Duhet të jemi vigjilent, e mos të japim konkluzione përfundimtare, ndaj ndodhive të mundshme, të bazuar në logjikën tonë. T'i pranojmë gjërat, pa shqetësim nga e keqja eventuale, që mund të na përfshijë, dhe njëkohësisht, mos t'i gëzohemi shumë mirësive. Ndodh, që t'i gëzohemi gjërave, e pastaj të themi, sikur mos të kishte ndodhë ajo mirësi. Me këto urtësi, i Lartësuar, na bën të qartë se, jeta duhet pranuar ashtu siç është, duhet të përballemi me të. Ne kemi rënë dakort me kaderin. Për pjesët, që na janë ndarë neve, ne nuk dyshojmë fare, sepse ato janë ndarë për të mirën tonë.

Ato janë të pashmangshme, nuk kemi alternativa në ndodhitë e kaderit tonë, ato janë pjesët që na përkasin vetëm neve.

Do t'a përmbyllim fjalimin tonë, rreth kësaj sureje Kehf (shpella), me tregimin e Dhulkarnejn. I Lartësuar, nëpërmes Kur'ani Kerimit, na thotë: “Do të pyesin ty (o Muhammed) për Dhulkarnejin. Thuaju: Unë do t'ju rrëfej diçka për të”⁵⁹. Disa

⁵⁹ Kur'an, Kehf -83

njerëz, për këtë person, na tregojnë historikun e tij, gjë që, neve, nuk na shërben fare. Nuk kërkohet nga ne, të humbim kohë dhe të hulumtojmë personalitetin fizik të këtij personi. Vërtet, cili ishte ky njeri?! Ajo, që kërkohet nga ne, është ngjarja që përshkruhet, nga i Lartësuari, për të. Ka shumë polemika, mes dijetarëve, rreth fizikut të këtij personi: cili ishte Dhulkarnejni, në ç'kohë jetoi, në cilin shtet, e kështu me radhë.

Ngjarjet në Kur'ani Kerim. nuk kanë për qëllim, që nëpërmjet ngjarjeve ose tregimeve t'a përcaktojnë personalitetin e dikujt. Nuk kërkohet nga ne, që të largohemi nga urtësia, nga ajeti Kur'anor, e t'i qasemi polemikave rreth personalitetit të Dhulkarnejnit. Ai, për ne, ekziston në çdo periudhë kohore, por me emra të ndryshëm.

KUR'ANI DHE E VËRTETA

Pra, t'i kthehemi sërish tregimit të Dhulkarnejnit. Siç thashë, nuk kam ndërmend të hyj në personalitetin e tij, se kush ishte ky person, por, ajo që dua të flas këtu, është urtësia, të cilën, na rrëfen i Lartësuari.

Dhulkarnejnit, Allahu xh.sh., i dha pushtet në tokë, me fjalë të tjera, e bëri mbret. Atij i mundësoi t'i ndjekë gjurmët objektive dhe subjektive të problemeve, d.m.th. përderisa posedonte këtë pushtet, ai kishte autonomi të plotë të bënte çfarë të dëshironte.

Meqenëse, kishte këtë forcë, çfarë bëri, në realitet, ky njeri? A mos vallë i mjaftoi, vetëm, shteti i tij? Përkundrazi, ai nuk u përqëndua vetëm në vendin e vet, por, ai, filloi të ndjekë dhe gjurmë shkaku e ngecjeve, ose fillet e problemeve. Me këtë shembull, i Lartësuari, sikur do të na tregojë se, nëse, Ne kemi dhënë shkaku e gjësendeve, atëherë duhet kuptuar se, ato shkaqe, përcillen me shkaqe të tjera dhe nuk duhen stagnuar ato.

Kjo nuk përfundon me kaq, kjo formë mohon teorinë e mbështetjes dhe përtacësisë në punë. Nëse më ka mundësuar i Lartësuari të kam një copë tokë në shfrytëzim, kjo nënkupton, që unë duhet t'a punoj atë duke e lëvruar, mbjellur etj., deri sa të përfitoj nga ajo arë. Nëse e lë atë të pambjellë, si dhe nuk e shfrytëzoj, d.m.th, kam marrë një pjesë, prej programit të relativitetit nga Zoti dhe bëhem shkaktar i ngecjes së procesit, ose bëj pengesa. Kjo neglizhencë, i shpian të tjerë, me të drejtë, të më cilësojnë si kundërshtar të sheriatit (ligjit) të Allahut në tokë.

Nëse i Lartësuari më jep pasuri, detyrohem që, atë, t'a shfrytëzoj për vete dhe t'a përdor për të mirën e njerëzimit. Me këtë strategji, hapen dyert e rizkut për njerëzimin dhe, njëkohësisht, zhvillohet dhe ndërtohet planeti tokë. Nuk do të

përfitoja asgjë, nëse pasurinë e deponoj dhe e ruaj. Kjo strategji, është kundër progresit, kjo i mbyll dyert për të tjerët. Nëse, pra, i Lartësuari më dhuroi pasuri, unë do të duhet t'a shtoj atë, me punën time. Këtë, do t'a ndërlihdja, me të gjitha gjërat e jetës. Nëse, i Lartësuari më mundësoi në një specializim, obligohem që t'a shpërndaj atë dituri, nëse veproj kështu, atëherë, Allahu xh.sh., do t'a kishte bekuar atë, dhe njëkohësisht do të më pasuronte edhe më shumë. Nga ne, kërkohet të jemi të hapur, e jo të mbyllur. Nëse, i Lartësuari më mundësoi të kem një diçka, që nuk e kanë të tjerët, atëherë, duhet t'a qarkulloj atë, sa janë në lëvizje të tjerët dhe të përfitojnë prej saj, etj.

Kështu, është edhe me ajetin Kur'anor:

“Derisa arriti në perëndimin e diellit (aty, ku dukej se po perëndonte), pa që ai perëndonte në një burim lymi të zi (turbullt) dhe aty, pranë, gjeti një popull (pra, tek populli më i largët, në perëndim, që përjetonte vuajtjet e parisë së tyre) Ne i thamë:” O Dhulkarnejn! Ose ndëshkoi, ose sillu me mirësi ndaj tyre”⁶⁰

Kështu, i Lartësuari, i kishte dhënë liri, të sillej me ata njerëz, si të dëshironte: keqbërësit i dënonte, kurse me mirëbërësit sillej me shumë mirësi.

Ashtu siç na tregon, i Lartësuari, në Kur'an Kerim: “Ai tha: mizorët do t'i ndëshkoj...”⁶¹. Pse u shpreh kështu, e nuk tha: O Zot, atë që është mizor, do t'a lë të ndëshkohet në Ahiret. Nuk tha kështu, sepse ligjet e jetës dhe mendoj se kjo pikë është shumë e rëndësishme, nëse gjykohet një herë, do t'i mjaftojë për të gjitha gjërat që i ka bërë. Ai e dinte se, në këtë botë, njeriu nuk gjykohet përfundimisht, por, sikur të mos ekzistonte edhe ky gjyq, përfundimi ynë do të ishte anarkia.

Në botë, ka besimtarë dhe jobesimtarë. Në të, ka të mirë dhe të këqij. Qëllimi i kësaj jete është përfitimi para sevapit. I Lartësuari i ka dhënë rregullat e jetës së këtij planeti. Nëse, një person pabesimtar vjedh, patjetër duhet dënohet edhe në këtë botë. Gjithashtu, personi pabesimtar, i cili ka tejkaluar çdo kufi të Allahut, patjetër, duhet të dënohet. Por, kjo nuk është e gjitha, nëse jemi ata që duam t'a kemi jetën e rregullt dhe në harmoni të plotë, atëherë, duhet të jemi shumë organizativë në punë. Sepse, ky rregull, të bën të përgjegjshëm, e kjo pastaj, do të detyrojë në gjykime, ose të bëhen dënime edhe për thyerësit e rregullores.

Të jemi, pak më të vëmendshëm, në këtë ajet. A thua, pse, i Lartësuari, i filloi thëniet e Tij, gjatë tregimit të biografisë së Dhulkarnejnit, me: “Ai tha: mizorët do t'i ndëshkoj” e pastaj tha: “Kurse, ai i cili ka besuar dhe bërë vepra të mira, do t'a shpërblejmë me mirësi...”⁶², sepse ndëshkimi është para, ai i paraprin dekorimeve,

⁶⁰ Kur'an, Kehf - 86

⁶¹ Kur'an, Kehf - 87

⁶² Kur'an, Kehf - 88

ose siç ne i quajmë shtesa ose dhënie kurajo. Nëse marrim një punë, pa marrë parasysh cila është ajo, dhe administratorët e ndërmarjes, nuk e ndëshkojmë hilexhiun, dhe po ashtu nuk e stimulojnë punëtorin, atëherë, ajo punë nuk do të jetë frytdhënëse. Do të ishte e rregullt, sikur të ndëshkohej hilexhiu, sepse puna, pastaj, do të ecte në baza të shëndosha, e kur të arrihen frutat e para të asaj pune, atëherë vjen në shprehje shpërblimi, ose stimulimi i punëtorëve më të mirë.

DËMTUES I VETVETES

Të jemi shumë të vëmendshëm, edhe në këtë pikë. Kjo është një veçori, në vete. Dëmtuesi, në këtë botë, ka dy ndëshkime. Atë, të kësaj bote dhe të ahiretit. Dëmtuesit, sa për të qenë preciz me Kur'ani Kerimin, janë dy llojesh. Njeriu, që dëmton veten e vet, dhe njeriu, që dëmton një njeri tjetër. Që të dy, do të llogariten - ndëshkohen. Njeriu, i cili e dëmtoi veten, bëhet i shkatërruar, prej dënimit të tij edhe në ahiret. Këtë ndëshkim, e ka, sepse nuk i ka kryer obligimet ndaj All-llahut xh.sh, ose ndoshta e ka mohuar Allahun dhe mirësitë e Tij. Ai nuk ndëshkohet për pasurinë e madhe që dispononte, e as për namazin. Por, ndëshkimi i erdhi për shkak se ishte mospërfillës. Ai këto i bënte pa ndonjë shpërblim të kësaj bote. Persona të këtij lloji, kemi shumë. Ose, si ai që dërgon letra anonime të rrejshme, kundër shokëve, grave ose fqinjëve të tyre. Ose, si ai, që dëshmon shehadetin rrejshëm, sa për t'a evituar rrezikun. Këto i bën, pa ndonjë shpërblim. Ky lloj personi dëmton veten, sepse e ka marrë tatëpjetën e vetshkatërrimit. Por, në të njëjtën kohë, ky lloj njeriu, as nuk përfiton nga kjo botë, sikur që përfitojnë njerëzit e llojit të tjerë dëmtues. Si ai, që vjedh pasurinë e tjetrit, apo ai, që arrin kënaqësi të shpejtuar. Ky lloj personi, ka shitur këtë botë me ahiretin. Ka dhënë të përjetshmen, për të përkohshmen.

Dënimi do të jetë në dy mënyra. Mënyra e parë, është dënimi i dukshëm, p.sh. ai që kapet në flagrancë duke vjedhur, ose ai që merr të drejtat e një njeriu tjetër me dhunë. Ky i nënshtrohet këtij lloj dënimi. Mënyra e dytë, njeriu, i cili tinëzisht vepron ato vepra, që janë të ndaluara nga Allahu xh.sh. dhe, njëkohësisht, nuk e beson Atë. Ky njeri, një ditë, do të kthehet tek Allahu dhe do të dënohet dhembshëm.

Pra, Allahu, secilit, ia ka caktuar përgjegjësitë e tij, në këtë botë. Secili duhet të jetë i kujdesshëm dhe vigilent. Ai duhet t'a ketë me vete peshoren, që sa herë të ketë nevojë, t'a peshojë veten, gjatë lëvizjeve të tij, në botë dhe në rrethin, që ai jeton. Kështu, do të veprojë, derisa t'a drejtojë ose zotërojë atë lëvizje. Zotërimi i lëvizjeve, ka për qëllim që dëmtuesit t'i ndëshkojë e, kurrësesi, të thuhet se, këtë veprim të lig, po ia lëmë Allahut xh.sh. t'a gjykojë ose t'a dënojë. Pa tjetër, duhet të ketë dënim në këtë botë, ky është një parandalim për ata që nuk besojnë, ose për ata që kanë harruar Lartëmadhërinë.

I Lartësuarit thotë:

“Kurse ai që ka besuar, dhe bëri vepra të mira, për të, ka shpërblime më të mira, pastaj do t’i themi, atij, se lehtësitë i ke nga Ne”

Do ndalojmë pak, në shpjegimin e këtij ajeti. Pse vallë nuk u plotësua që, ky njeri, do të kthehet tek Zoti i tij dhe pastaj do të hyjë në xhen-net. Këtu, vërejmë një urtësi të lartë. Vërejmë se, imani, qëndron ndërmjet robit dhe Zotit. I Lartësuarit është i vetmi, që e di saktësisht, nëse dikush është besimtar i vërtetë apo, nëse, besimi tij është sa për sy e faqe, ose sa për t’a parë dikush, sepse fshehurazi vepron ato që i ka ënda, edhe pse ato veprime janë të ndaluara.

Sado të jemi të sofistikuar, nuk jemi në gjendje t’a dallojmë nëse dikush është besimtar i vërtetë, apo, hiqet si besimtar. Për këtë arsye, lënda e tyre, kalon tek i Lartëmadhëruari. Ai, e di çka fshihet në brendi të njeriut dhe çfarë heshtin zemrat. Ai e di se, kush e bën veprën për hir të All-llahut dhe kush e bën sa për t’a shfaqur mirësinë, për qëllime të liga të kësaj bote.

Për këtë arsye, lënda e tij, i kalon Allahut të Lartësuar. Atij nuk i shpëton asgjë, dhe kështu, besimtarin e vërtetë e shpërblen, kurse, ata që kanë qëllime, të lartësimit të pozitës së tyre, ose të të mirave të kësaj bote, ose atyre që paraqitjet i kanë hipokrite, lënda e tyre do të kalojë tek All-llahut dhe Ai do t’i gjykojë.

Vazhdojmë, me ajetin tjetër, me radhë.⁶³

“Derisa arriti në lindjen e diellit (aty, ku dukej se po lind), vërejti se, ai lindte tek një popull (tek populli më i largët, në lindje, që përjetonte vuajtjet e parisë së tyre), që Ne nuk iu kishim dhënë atyre mbulesë, nën të (diellin)”.⁶⁴ “Kështu, Ne dinim çdo gjë (për të) prej përvojës së tij”.⁶⁵

Në fillim të këtij kapitulli, theksuam se ç’kuptim kishte ajeti Kur’anor ...që Ne, nuk iu kishim dhënë mbulesë, nën të (diellin).

(Leka i Madh) Aleksandri kishte arritur deri në një vend, ku dielli nuk mungonte për një kohë të gjatë. Ai popull, nuk ballafaqohej me ndërrimin e ditës dhe natës, si popujt e tjerë, të këtij planeti. Dielli vazhdonte të ishte prezent tek ta, një kohë të gjatë, sepse ata nuk i mbulonte terrë. Sot, neve na është e njohur, se kemi vende në tokë, në të cilat dielli lind dhe nuk perëndon për gjashtë muaj rrjesht, gjatë vitit, ose anasjelltas, perëndon e nuk lind, për gjashtë muaj. Këto vende, janë Poli i Veriut dhe Poli i Jugut.

Me këtë thënie, i Lartësuarit, sikur ka dashur të na tregojë se, kemi vende në

⁶³ Tani, Dhulkarnejni, do të drejtohet nga lindja, pasi kishte vlerësuar se drejt perëndimit nuk kishte udhëheqës mizor. (koment i përkthyesit).

⁶⁴ Kur’an, Kehf 90

⁶⁵ Kur’an, Kehf 91

planetin tokë, që nuk i nënshtrohen rregullave të natës dhe të ditës, sikurse i nënshtrohen vendet e tjera të tokës.

PASURIA.. AJO QË JEP ALLAHU

Tani, të shohim, se ç'ndodhi me Dhulkarnejnin, kur arriti tek diga. I Lartësuari, thotë:

“Derisa arriti mes dy kodrave, poshtë tyre, gjeti një popull, me të cilët shumë vështirë ishte për t’u marrë vesh. Ata i thanë: O Dhulkarnejn, vërtet Jexhuxhët dhe Mexhuxhët janë shumë (të llastuar dhe pervers) shkatërrimtarë në tokë...”⁶⁶

Ajeti Kur’anor, vazhdon të na tregojë, kur ata i ofruan atij kundërvlerë, për mundin dhe dijen e tij.

“...atë, që mua ma dhuroi Zoti im (nga pasuria), është shumë më e mirë (se ç’po më ofroni ju), por ju më ndihmoni me fuqi (punëtore), derisa të ngrejme një digë ndërmjet jush dhe atyre, që kjo pastaj të bëhet e pakalueshme”.⁶⁷

Këtu, kemi të bëjmë me dy dispozita të Allahut xh.sh., i Cili dëshiroi të na i tregojë, nëpërmjet tregimit të Dhulkarnejnit.

Dispozitën e parë, e nxjerrim nga thënia e Dhulkarnejnit: atë që mua ma dhuroi Zoti im (nga pasuria), është shumë më e mirë. Kjo jep të kuptohet se, njeriu i drejtë dhe i mirë, gjithnjë bën punë të mira. Ai nuk mërzhitet për pasuri, e as që punon për t’a grumbulluar e deponuar atë. Ka bindje të plotë, se veprat e mira, të cilat i bën, janë më të vlefshme se sa, ajo që i ofrohet, sepse ajo i mbetet përgjithmonë. Ai e di se, ajo që shpërndahet për bamirësi, nuk humbet, por përkundrazi, ajo shtohet. Ky, që një prej argumenteve, se Dhulkarnejni ishte njeri i drejtë. Sikur të ishte njeri, që paraqitej si i mirë, ai, me siguri, do të gëzohej në momentin kur iu ofruan para. Njeriu i tillë, nuk ngopet kurrë me pasuri, ai synon të mirat e kësaj bote. Ai nuk mendon, që pasurinë e tij t’a deponojë tek Allahu i Lartësuar, i Cili do t’ia shumëfishonte mirësitë.

Me këtë, i Lartësuari, sikur do të na thotë: mos lakmoni pasurinë, por lakmoni veprat e mira, që ua paraqes juve. Mos ikni nga këto mirësi, kapini ato, sepse këto janë më shumë se pasuri. Këto vepra, do t’ju sjellin dobi, në këtë botë dhe ahiret.

Dispozita e dytë. I Lartësuari, gjithashtu, shprehet me fjalët e Dhulkarnejnit: ...por ju më ndihmoni me fuqi (punëtore), derisa të ngrejme një digë, ndërmjet jush dhe atyre, që kjo pastaj të bëhet e pakalueshme”.

Mesazhi, në pjesën e dytë, është: Allahu dëshiron, që ne të punojmë pandërprerë,

⁶⁶ Kur’an, Kehf 93-94

⁶⁷ Kur’an, Kehf 95

derisa t'a evitojmë të keqen prej veteve tona. Nëse bota ka njerëz të llastuar dhe pervers, atëherë, të mirët duhen të bëhen tok, për t'a evituar rrezikun ose kërcënimet. Allahu xh.sh. na ka dhuruar mendjen, na ka mundësuar, që me të, t'a evitojmë çdo të keqe, e kjo arrihet duke punuar vepra të mira. Mendjen, nuk duhet t'a humbasim nëpër diskutime, ose polemika të kota, e as në hulumtimet e kota, të cilat janë të panjohura për ne, për ato, të cilat nuk na përkasin neve. Mos t'a shkatërrojmë veten nëpër ato vende, që nuk janë produktive, që nuk japin rezultate, ose nëpër diskutime, që nuk mund të vërtetohen. Nga ne, kërkohet që mendjen t'a shfrytëzojmë në hulumtimin e sekreteve, të cilat janë të kapshme, që mund të zbulohen, ndaj atyre krijesave që janë nën patronazhin tonë, etj, që këto pastaj, të na shërbejnë për lehtësimin e jetës, ose për evitim të këqijave, gjithashtu, për të jetuar një jetë të ndershme dhe të hareshme. Edhe pse, i Lartësuari, na dhuroi këtë mendje, për të mirën tonë, gjenden njerëz, të cilët e shfrytëzojnë këtë, për vepra të liga, e të padobishme. Ata nuk kënaqen vetëm me kaq, por çka është edhe më keq, ata u pengojnë të tjerëve. Ata futin huti dhe dyshime ndër njerëz, fusin hundët në metafizikë dhe, me këtë, ata vetëm sa i ndihmojnë shkatërrimit. Këto veti të këqija, Allahu xh.sh, nuk ia ka dhuruar mendjes, e cila është e kufizuar. Njeriu është i kornizuar, kurse Allahu xh.sh. nuk ka kufij, e as kondita.

Detyrë e mendjes së njeriut, është që t'a angazhojë atë, në krijesat, që janë krijuar për të.

Ajo është toka dhe ç'ka në të, si dhe gjithësia, deri aq sa dëshiron i Lartësuari të na zbulojë nga sekretet e Tij.

Allahu dëshiron që t'a shfrytëzojmë mendjen, vetëm në ato gjëra, që na përkasin dhe preokupojnë neve, në këtë botë. Ai nuk do të dëshironte, që ne t'a mendojmë atë, për gjëra, që nuk na përkasin dhe që nuk janë në domenin tonë. Angazhimi ynë, në këto hulumtime, do të na shpinte në përfundim të dëmshëm dhe pa rezultat për ne.

MBROJTJA E TË DOBTIT

Gjëja e parë, që vërejti Dhulkarnejni, tek ata, ishte dobësia. Ata i kërkuan mbrojtje prej Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve, të cilët ishin të fuqishëm dhe keqbërës. Ata ishin në gjendje t'a paguanin Dhulkarnejnin, për mbrojtjen e tyre, kundër shkatërrimtarëve, masakruesve dhe plaçkitësve, etj. Organizimi i tyre, nuk kishte qenë në gjendje të arrijë deri në atë nivel, sa të ishin në gjendje të mbroheshin nga ajo forcë shkatërrimtare.

Duke e parë gjendjen e tyre, Dhulkarnejni, tha: atë, që mua ma dhuroi Zoti im (nga pasuria), është shumë më e mirë, Ç'kuptim tjetër, mund të ketë kjo thënie?

Dhulkarnejni iu tha: diturinë, që disponoj, nëse e përdor për bamirësi ose për të ndihmuar dikë, është më e vlefshme, se e tërë pasuria e botës. Kuptohet, pasuria është relative, atë sot e ke, nesër e humbë, kurse bamirësia mbetet përgjithmonë. Vepra, e cila ka për qëllim kënaqësinë e Allahut të Lartësuar, është gjëja më e shtrenjtë, që mund të fitojë njeriu. Pse? Ajo që deponohet është e përhershme, i shlyen të këqijat dhe kështu afrohet, më afër Allahut.

Gjithashtu, ajo mbetet e përhershme në ahiret, duke u shtuar, e kjo nuk pakësohet. Për veprën e mirë, që vjen prej njeriut të drejtë, e që ka për qëllim kënaqësinë e Allahut, për këta, i Lartësuari thotë, në Kur'ani Kerim:

“Ne ju jemi atyre kujdestarë, në këtë botë dhe në ahiret, për ju, ka çdo gjë që ju shijon shpirti juaj, dhe gjithashtu, mirësi të panumërta. Kjo shpallje është nga Falësi dhe Mëshirëploti”⁶⁸

Po ashtu, këta janë, për të cilët, thuhet: “Vërtetë, Allahu është mbrojtësi i atyre që besuan...”⁶⁹, për këta, gjithashtu, thuhet: “Ai që ka dro (bindje ose i përmbahet dispozitave) Allahun, atij, i bën rrugëzgjdhje dhe e furnizon, prej andej, nga s’e kujton fare”⁷⁰.

Nga kjo, mësuam se njeriu i mirë dhe i drejtë, shpërblimet i ka këtë botë. Këtij, lutjet i pranohen, për çdo gjë, që i dëshiron zemra. Njëkohësisht, ky është nën mbrojtjen e Allahut të Lartësuar, i Cili qëndron përballë secilit njeri, që e bezdis atë, duke e poshtërsuar, ose ata që orvaten t’ia humbin sundimin.

Ai bën që bezdia të mos përplasht me besimtarin, sepse mbrojtësi i tij është Allahu xh.sh. A thua kush mund t’a bezdisë atë, që është në mbrojtje të Allahut të Plotëfuqishëm? Plus kësaj, ajo mirësi e afron, atë, tek Allahu xh.sh. Kjo afërsi i mundëson atij, që në çdo vështirësi ose krizë, të ketë rrugëdalje. Ato rrugëdalje, i vijnë andej nga nuk e ka llogaritur fare. Me këtë, nuk nënkuptohet vetëm vështirësia ekonomike ose rizku. Për ato të mira, atij i hapen dyert, andej, nga ai nuk ka menduar kurrën e kurrës se mund t’i lehtësohet. Kjo dyerhapje e tillë, për të, është në këtë botë, qoftë në formë të idesë ose të veprës, kurse, ato të ahiretit janë të panumërta ose të panjohura për ne. Me to, do të arrijmë një fitore shumë të madhe. A ka më të madhe se xhen- neti!

Nëse ky, është shpërblimi i mirësisë, atëherë, si t’a lëshonte këtë pasuri, Dhulkarnejni, kur e dinte fare mirë dhe kishte bindje të plotë, se Ai i kishte krijuar rrethanat e kësaj mirësie? Si mund të mendohet, se ai do t’a shiste këtë mirësi, duke lakmuar në shpërblimin e tyre?

Këtu, nuk dyshoi fare, sepse ai tha: atë, që mua ma dhuroi Zoti im (nga pasuria),

⁶⁸ Kur’an, Fusilet, 31

⁶⁹ Kur’an, Haxh, 38

⁷⁰ Kur’an, Talak, 2-3

është shumë më e mirë. Me bindje të plotë, iu tha atyre, se atë që më jep i Lartësuar, është shumë më mirë se kjo e juaja, dhe kështu unë refuzoj t'a marr tuajën, edhe sikur të ishte ajo pasuria e botës. Dhulkarnejni zgjodhi këtë alternativë, dhe unë mendoj se, secili besimtar i mirë e i drejtë, kishte për të shkuar drejt kësaj alternative. Zgjodhi që t'a mbrojë këtë popull të dobët, nga mizorët shkatërrimtarë, të cilët, ishin të paaftë në vetëmbrojtje, por ç'ishte edhe më keq, ata nuk ishin në gjendje, as të mereshin vesh. Zgjodhi, që shpërblimin t'a mirrte nga i Lartësuar, për këtë lloj mbrojtje, deri në fitore.

Me se e mbrojti, këtë popull? Mos vallë iu ndërtoi një mur, apo iu bëri ndonjë punë të madhe, që i kushtoi shumë mund dhe kohë. Jo. Ai kërkoi nga ata, diçka, që ata vetë do t'a bënin. Këtë e bëri me qëllim, që kur ai të largohet, ata të ishin në gjendje që përsëri t'a bëjnë vetë. Ai, atyre, iu mësoi se si t'a përdorin forcën e tyre, për mbrojtje dhe ju tha: “por ju më ndihmoni me fuqi (punëtore), derisa të ngrejme një digë, ndërmjet jush dhe atyre, që kjo pastaj të bëhet e pakalueshme”. Ai, ju bashkangjiti atyre në punë, i mësoi se si t'a ndërtojnë digën, e cila do të ishte mbrojtje për ta, dhe do t'i shpëtonte nga shkatërrimet e shpeshta. Ajo u ngrit si rezultat i punës dhe mundit të tyre dhe, kështu, u ndërtua diga mbrojtëse, ndërmjet popullit të dobët dhe keqbërësve. Me këtë vepër u mbrojtën prej tiranisë, por kjo, njëkohësisht, ju shërbeu pasi mësuan edhe një strategji të re për vetëmbrojtje.

Këtu e shohim edhe urtësinë. Çdo popull, sado i dobët të jetë, mund të bëhet i fortë, nëse mbështet tek dijetarët dhe strategët, që ka vazhdimisht bota. Këta persona, mund të ndikojnë shumë për zhvillim dhe përparim, nëse popujt e dëshirojnë këtë. Atyre, iu duhet vetëm t'i u shpjegohet shkaku i depresionit dhe i mossukseve të tyre. Ata janë strategë dhe japin vizione të qarta. Për t'a realizuar strategjinë e sygjëruar për mbrojtje, duhet të marrë pjesë i gjithë kolektivi ose populli. Për të patur sukses, duhet që mbarë kolektivi ose populli, të ndërrojnë sjelljet e mëparshme dhe të pajisen me veti të reja, që nuk i kishin më parë.

Para se ta mbyll, përmbledhjen e sures Kehf (Shpella), dua të them, se kjo sure është përplot shpella të kësaj bote, të cilat ende nuk janë të zbuluara. Kuptimi i parë, që duhet t'a kemi parasysh është, se veprues është Allahu i Lartësuar. Asgjë, nuk mund të bëhet, pa vullnetin e Tij. Nga ky këndvështrim, secili njeri, duhet që çështen t'ia kalojë Allahut të Lartësuar, e kurrësesi të thotë, se do të bëj këtë, pa shtuar thënjen 'inshaAllah' (nëse shpreh vullnet Allahu), sepse ai që posedon elementin e së ardhmes, është vetëm Allahu i Lartësuar.

Urtësia e dytë. Kështu, duhet të jetë vizioni i njeriut, për prejardhjen e shkaqeve: Nëse Allahu dikënd, e ka begatuar me pasuri, ose tokë, ose, ndokënd tjetër e ka begatuar me rrizk, duhet të jetë i bindur, se ajo është një prej dhuntive të Allahut të Lartësuar. Mos të mburret me to, e të mendojë se këtë e ka arritur nga shkathtësia e tij. Mburra, konsiderohet fillimi i largimit, nga besimi në Allah. Ai, i

Cili t'i jep mirësitë Ai, edhe t'i merr ato. Pa pëlqimin e Tij, asgjë nuk mund të bëhet, prandaj do të jetë shkatërrues i vetvetes ai person, i cili mendon se mundet të krijojë energjinë e vet, apo të krijojë gjëra të tjera. Ai, në të vërtetë, do të ketë mundësi të bëjë shumëçka, por duke u mbështetur në pëlqimin dhe vullnetin e Allahut xh.sh. Ky lloj pëlqimi i kërkuar, është esenca e suksesit të tij të vërtetë. Sikur të mos ishte Ai, do të zhdukej dhe do të falimentonte për çdo gjë. Puna është e kërkuar dhe obligative, por, pa mburrje. Unë punoj, e All-llahu, inshallah, do ta parapëlqejë dhe begatojë atë, e pastaj t'a shndërrojë në rrizk.

Urtësia e tretë. Reklamimi i gjërave nuk prejudikon vërtetësinë. E mira dhe e keqja, nuk mund të gjykohen nga thashethemet ose propagandat. Kjo na bën, që të mos jemi në gjendje t'a gjykojmë ngjarjen. Duke mos e njohur realitetin, mendojmë se gjykimi paraprak ishte i dëmshëm, ose e kundërta, i gëzohemi ndonjë gjykimi, duke llogaritur se paska qenë i mirë për ne. E vërteta, e së mirës dhe e së keqes, është tek Allahu xh.sh, dhe çfarëdo gjykimi, që vjen prej Tij, gjithmonë duhet t'a pranojmë. Aty kemi urtësinë e Allahut, sepse ajo është sekret i fshehur për ne. Duke qenë se jemi besimtarë, ne e dimë, që Allahu nuk e dëmton besimtarin. Allahu xh.sh. na kishte dhënë disa shembuj, gjatë tregimit të Musaut dhe Robit të Mirë, prandaj, besimtari nuk duhet të dyshojë.

Urtësia e katërt. Disa gjëra i përkasin kaderit (parapërcaktimit), ato mund t'i ndodhin njerëzve edhe pa ndonjë lëvizje. Ai nuk është protagonist ose bashkëveprues i saj. Këto gjëra, nuk ndodhin ashtu, shkel e shko, e as nuk përmbillen ashtu lehtë. Ndodh nganjëherë, që këto, të jenë shumë larg njohurive tona, por ne duhet t'a kuptojmë, se ajo që ngjau, është një prej kadereve të kësaj gjithësie, e që shkaktoi i saj është Allahu i Lartëmadhëruar.

Ajo që është gjykuar t'i ndodhë njeriut, prej Allahut të Lartësuar, duhet t'a dijë, se ajo ishte caktim i mëhershëm i planifikuar. Ato na ndodhin, shpesh, në jetën e përditshme. Si shembulli i atij, që ia zhvrimosi tragetin, ose atij, që e ngriti murin e askush nuk e kuptonte qëllimin. Këto ngjarje janë sekrete, këto do t'i kuptojë vetëm ai, që i është mundësuar t'a njohë të vërtetën, prej Allahut xh.sh.

Urtësia e pestë. Ne, sado të jemi të dobët, do të mësojmë shumë, prej atyre, që u është dhënë dhunti nga i Madhërishmi. Sikur, kësaj diturie, t'i shtojmë edhe punën, padyshim se Allahu xh.sh. do t'i begatojë.

Dhe së fundi, duhet t'a kemi të qartë se, kur Allahu na pais me dhunti dhe punë të mira, Ai do të na japë edhe elementet më të mira të mundshme, që të kemi mundësi të fitojmë shpërblime dhe sevape, në këtë botë dhe ahiret. Sikur të jetë i kënaqur Allahu xh.sh., me veprat e njeriut, ato e bëjnë të pasur, dhe i jepen shumë mundësira në jetë.

QORTIMET E PEJGAMBERIT NË KUR'ANI KERIM

Shumë orientalistë nuk ngopen me fyerjet e tyre. Ata mundohen, që disa gjëra t'i shpjegojnë, sipas tekeve të tyre. Kuptohet, ata gjithmonë mundohen të fusin huti ndër besimtarë, duke sjellë shembuj disa qortime, që All-lahu i Lartësuar ia bëri të Dërguarit të Tij, Muhammedit ﷺ, në Kur'ani Kerim. Prej burimeve hyjnore, ata morën disa shembuj qortimesh, pastaj filluan t'i instrumentalizojnë, duke thënë se ai “nuk paska” qenë në rrugë të mbarë.

Të shohim, një prej thënieve, të Allahut të Lartësuar:

“...dhe kërko falje për gabimin tënd”⁷¹. “Dhe sikur mos të kishim forcuar ty, ti pothuaj, do t'u ishe dhënë pak atyre. Por, Ne do të bënim t'a shijoje (ndëshkimin) dyfish në këtë jetë dhe dyfish pas vdekjes, pastaj për ty, tek Ne, nuk do të gjendej kurrfarë mbrojtësi.”⁷²

Këto qortime, i erdhën pejgamberit ﷺ, nga Allahu xh.sh., pas luftës së Bedrit, kur muslimanët i kapën robërit e luftës. Për lirimimin e tyre, kishte kërkuar, që t'ju mësonin muslimanëve shkrim-lexim.

“Nuk është për Pejgamberin, të ketë robër lufte, përderisa t'i mposhtë (armiqtë) në tokë. Ju lakmoni të mirën e kësaj bote, por Allahu, për ju, dëshiron ahiretin...”⁷³

Çfarë flitet për vajtimin e të Dërguarit të Allahut ﷺ, kur zbriti ky ajet, dhe ajetet e tjera, që e qortuan atë, në lidhje me këtë betejë. Këto ajete, orientalistët i marrin si shembuj. Ata mundohen të futin huti, ndër ne, kinse Pejgamberi ﷺ nuk paska qenë në rrugë të drejtë.

Para se të filloj shpjegimin, rreth këtyre ajeteve, do isha ndalur pak me këta, që shkoqisin këto ajete. Këta, na bëjnë shërbim, që ne të ndihemi edhe më të fortë, se nuk ka kurrfarë dyshimi se, Kur'ani Kerim, është shpallje e Allahut të Lartësuar. Kjo jep të kuptohet se, Kur'ani nuk ka devijuar, e as, nuk ka ndryshuar. Edhe pse, në të, janë qortimet, që i janë bërë të Dërguarit të Tij. Në të, nuk është ndryshuar, as edhe një shkronjë e vetme. Ne shërbehemi me këto ajete, ashtu siç na u shpallën ato. Këto fakte, e vërtetojnë origjinalitetin e tij, i cili, arriti tek ne, pa u ndryshuar fare. Këto fakte, na përkujtojnë ajetin e Allahut, i Cili, thotë: “Vërtetë, Ne jemi Ata, që e zbritëm përkujtuesin (Kur'anin), dhe (padyshim që) Ne, do t'a ruajmë atë (nga ndryshimet eventuale, që do të mundohen, të fusin në të).”⁷⁴

⁷¹ Kur'an, Gafir 55

⁷² Kur'an, Israë, 74-75

⁷³ Kur'an, Enfal, 67

⁷⁴ Kur'an, Hixhr, 9

Përderisa, këto ajete, u zbritën në Kur'an, në kohën e Pejgamberit ﷺ, dhe ai e kapte shpalljen e Kur'anit, pastaj atë ia përcillte besimtarëve, sikur, Pejgamberi i Allahut, të mos ishte besnik, ai nuk do t'i shpallte këto ajete. Kishte mundësi, që t'i fshihte këto ajete. Me siguri, askush, nuk do të kuptonte, nëse këto ajete i ishin shpallur ose jo. Sikur autori i Kur'anit të ishte njeri, me siguri ajetet e qortimit nuk do t'i fuste. Natyra e njeriut, nuk mund të pranojë kritika, ai dëshiron të paraqesë "gjithëdijen" e tij. Nuk ka projekt njerëzor, që do t'a injoronte ose qortonte veten. Me siguri, secili projekt, e proklamonte projektin, si një nga më të përsosurit dhe pa gabime.

Këto ajete, vërtetojnë se, ky Kur'an, është shpallje e Allahut të Lartësuar, dhe Muahmmedi ﷺ, këto ajete, nuk i fshehu. Ky veprim, sinjalizon se ai ishte një njeri i sigurt dhe shumë besnik, ndaj përgjegjësisë së vet. Atij nuk i shpëtoi asnjë shkronjë, dhe ky libër, qëndroi i pa ndryshuar mbi 1400 vjet. Kjo, edhe një herë argumenton se, Kur'ani Kerim, neve na prezentohej pa asnjë ndryshim dhe pa asnjë zëvendësim.

Para se të filloj të hap debatin tim, rreth temës së sipërpërmendur, e pashë si shumë të arsyeshme t'a bëj këtë hyrje. Ata, të cilët, mundohen t'a shkatërrojnë këtë fe, ata sjellin fakte, se Kur'ani është fjalë e Zotit dhe i pandryshuar, si dhe tregojnë, se Muhammedi ﷺ, ishte besnik në shpallje.

Tani t'i shohim ajetet, të cilat qortojnë të Dërguarin e Allahut të Lartësuar. Orientalistët kanë shtruar shumë pyetje, por unë, para se të filloj t'ju përgjigjem pyetjeve të tyre, mendoj se, së pari, duhet të jap përgjigje rreth dyshimit në Kur'ani Kerim. Komenti i tyre, njëkohësisht, është edhe pyetja e tyre, rreth sures Teube. Ata thonë, se Muhammedi ﷺ ka harruar të shkruajë ajetin hyrës në këtë sure, pra 'Bismil Lahir Rahmanir Rahim'. Ata vazhdojnë të shtojnë, duke thënë se kjo nuk është për t'u habitur, sepse edhe ai ishte njeri sikur ne, dhe, normalisht, njeriu harron.

Pikërisht, kjo është e vetmja sure, që unë dua t'ju përkujtoj orientalistëve, se edhe këta janë të përfshirë në këtë sure. Për shkak, se Allahu i Lartësuar nuk do t'i mëshirojë njerëzit, që janë të përfshirë në këtë sure. Nuk e filloi këtë kapitull me 'Bismil-Lahir Rahmanir Rahim', sepse i Lartëmadhëruari, përfudimisht, i ka mbyllur dyert e Mëshirës së Tij, prandaj edhe fillon me:

"Kjo është (deklarata) e justifikimit, nga ana e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ndaj të gjithë atyre, që kishin marrëveshje me mushrikët (politeistat, paganët)".⁷⁵ Pataj thotë: "...se Allahu dhe i Dërguari i Tij u liruan (prej të gjitha detyrimeve) kundrejt (akuzave) të mushrikëve..."⁷⁶ pastaj thotë: "...dhe ti përgëzoi mohuesit,

⁷⁵ Kur'an, Teube 1

⁷⁶ Kur'an, Teube 3

me dënim të dhembshëm”⁷⁷.

Gjithashtu thotë:”...dhe vritni mushrikët, kudo që t’i gjeni, pastaj bllokoni ata (robëroni) dhe u kini kujdes të papriturave të tyre...”⁷⁸, pastaj kemi thënien tjetër: “ E si është e mundur, që mushrikët të kanë marrëveshje me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, përveç...”⁷⁹

Pastaj thënia e Lartëmadhërisë: Si (të keni marrëveshje me ta) kur, ata, sikur (një kohë) t’a merrnin fuqinë mbi ju, nuk do t’i përfillin lidhjet që patët me ta, as marrëveshjen, e as (lidhjet) farefisnore? (Ju kënaqin) Me fjalë, ata ju dredhojnë, zemrat i kanë kundër jush, sepse shumica e tyre janë besëthyes. Ata, ajetet e Allahut i shkëmbyen, me një kundërvlerë të vogël dhe (u bënë) penguesit e rrugës së Tij. Vërtetë, ata, bënë punë të shëmtuar. Ata, nuk e respektojnë (marrëveshjen me) besimtarin, e as faresisin, ata, si të tillë, i kanë tejkaluar të gjitha normat (njerëzore).⁸⁰

Pastaj, Allahu thotë: “...luftoni parinë e femohuesve, vërtetë, ata nuk i përmbushën betimet e tyre, ndoshta, kështu, do të ndalen (nga veprat e tyre shëmtuara). A nuk do t’a luftoni popullin, që i shkel betimet e veta dhe (njëkohësisht) u munduan që t’a nxjerrë të Dërguarin, kur ata, të parët, e filluan (sulmin). A mos (vallë) po ju frikësoheni atyre? Po të ishit besimtarë (të vërtetë atëherë ju) do t’ishte më e drejtë, që Allahut t’i bindeshit (frikësoheshit). I luftoni ata, sepse Allahu do t’i ndëshkojë me duart tuaja, pastaj do t’i poshtërojë dhe, më pastaj, do të korrni fitore mbi ta, kështu që zemrat besimtare do të shërohen”⁸¹.

Pastaj thënia: “Nuk i takon mushrikëve, të perkujdesen për xhamitë e Allahut, ata (haptaz po) dëshmojnë femohimin, për vetvetet e tyre. Punët e tyre janë të kota dhe në zjarr do të jenë përgjithmonë”⁸².

Vazhdojnë ajetet, njëra pas tjetrës, të gjitha vërtetojnë se Allahu i Lartëmadhëruar nuk i udhëzon mizorët, dhe shkatërruesit. Ai thotë: “ O ju që besuat, mos i merrni (si kujdestarë, ose shembull për të mirë) prindërit (ose gjyshërit etj.) dhe vëllezërit tuaj, nëse ata parapëlqejnë mosbesimin ndaj besimit, nëse dikush nga ju i referohet atyre, ai do të jetë dëmtues (i vetes)”⁸³.

Gjithashtu, i Lartëmadhëruari, thotë: Ata (pabesimtarët), me fjalët e tyre, mundohen t’a shuajnë Dritën e Allahut, kurse Allahu, nuk do t’a lejojë, kurrë, një gjë të tillë.

⁷⁷ Kur’an, Teube 3

⁷⁸ Kur’an, Teube 5

⁷⁹ Kur’an, Teube 7

⁸⁰ Kur’an, Teube 8-10

⁸¹ Kur’an, Teube 12-13

⁸² Kur’an, Teube 17

⁸³ Kur’an, Teube 23

Allahu (përkundrazi) do t'a plotësojë Dritën e Tij, edhe pse, femohuesit, e urrejnë (këtë)”⁸⁴.

Këta, të cilët u theksuan në këto ajete, si dhe shumë të tjerë, që nuk u theksuan, e që i përkasin këtij lloji, janë të padëshirueshëm. Të gjithë këta, konsiderohen jashtë mëshirës së Allahut të Lartësuar. Vërtetë, do të ishte e pakuptimtë, që një sure, të fillojë me mëshirën (tolerancën) e All-llahut, kur, po ajo sure, paralajmëron njerëzit që përjashtohen përgjithmonë nga mëshira e All-llahut (tregon zero tolerancë). Pra, Muhammedi ﷺ, nuk paska haruar, por dëshira e Allahut të Lartësuar ishte, që në këtë sure, mos të përmendet mëshira e Allahut, sepse dënimi i këtyre është i paevitueshëm dhe përjetshëm.

Pas këtij shpjegimi, të kthehemi tek tema jonë, tek qortimi ndaj të Dërguarit ﷺ, në Kur'ani Kerim.

Allahu i Lartësuar, e qortoi të Dërguarin e Tij, duke i thënë: “...kërko falje për gabimin tënd”, si dhe, në suren Fet'h, i Lartësuari i thotë: “ Vërtetë, Ne, ty të dhamë fitore të qartë. Për të të falur ty, Allahu, nga të gjitha gabimet, si ato të kaluarat, ashtu dhe ato të ardhmet...”⁸⁵

Si mund të kuptohet falja, nga e kaluara dhe e ardhmja, kur, në të njëjtën kohë, i Lartësuari, kërkon nga ai: kërko falje për gabimin tënd? Cilat janë gabimet, të cilat i kishte bërë i Dërguari Allahut xh.sh? Nëse marrim ajetet e qortimit, shumica e tyre këshillojnë Muhammedin ﷺ, që mos t'a marrë mbi vete barrën e thirrjes (davetit) islame. Kështu i Lartësuari, në një prej sureve, thotë: “ Ta, Ha”⁸⁶. Ne, nuk ta zbritëm ty Kur'anin, për të të munduar. Por (ate t'a zbritëm) këshillues, për të gjithë ata, që i frikësohen (Allahut)”⁸⁷

Gjithashtu, i Lartësuari thotë: “ Mbase, ti do t'a shkatërrosh veten, nga hidhërimi pas tyre (duke u munduar ti bindësh ata), nëse ata nuk i besojnë këto thënie (të Kur'anit)?”⁸⁸ Pastaj, thënia e All-llahut, që i thotë të Dërguarit të Tij: “...pse ia ndalon vetes atë, që Allahu t'a lejoi ty”. I Lartësuari, thotë, për pejgamberin: “ Ne e dimë (kuptojmë) pikëllimin tënd, që t'a shkaktojnë thëniet e tyre...”⁸⁹ Pastaj thënia: “ Mbase, do t'ju lësh diçka, prej asaj që të shpallet ty (shpresat e idhujtarëve), e ti ngushtohesh për ta (sepse atyre mund t'ju vijë rëndë të dëgjojnë

⁸⁴ Kur'an, Teube 32

⁸⁵ Kur'an, Fet'h 1

⁸⁶ Nuk ka përkthim, janë shkronja të alfabetit arab. Sipas disa komentatorëve, këto shkronja, janë shpallur nga Allahu xh.sh., sa për t'i treguar njerëzimit, se edhe Kur'ani, ka përdorur shkronjat nga alfabeti juaj, sikurse që i përdorni edhe ju. Me këtë, sikur do të na thotë, se ju nuk mund të bëni një Kur'an të tillë.

⁸⁷ Kur'an, Ta, Ha. 1-3

⁸⁸ Kur'an, Kehf 6

⁸⁹ Kur'an, En'am 33

thëniet...).”⁹⁰

I Lartësuar, për të Dërguarin e tij, thotë: “...ndaj ti (o Muhammed), mos e shkatërro veten, duke u dëshpëruar për ta...”⁹¹

Po ashtu, thotë:

“ U vrenjt (Muhammedi u mrrol) dhe ia ktheu shpinën, sepse atij i erdhi një i verbër”⁹²

Dhe thotë: “ Po të mos kishte qenë libri (dispozita e caktuar) i më hershëm prej Allahut...”⁹³, si dhe shumë ajete, të cilat e ngarkojnë Muhammedin ﷺ, me qortime të tilla. Allahu thotë: “Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues”⁹⁴

“...Thuaj: Unë nuk jam përgjegjësi juaj”⁹⁵

Të gjitha këto ajete, ishin qortim për Muhammedin ﷺ, por çfarë qortimi është ky? Ai është qortuar për gjëra, që nuk aludonin për atë, ato nuk i përkasin atij. A thua çfarë e preokuponte të Dërguarin e Allahut, të ngarkohej me barrat, të cilat nuk i përkisnin atij? Sigurisht, ajo ishte dashuria për Zotin dhe fenë.

Dëshira e tij, ishte që imani të hynte tek secili njeri, në të gjitha zemrat. Dashuria e tij për Zotin, shprehte sinqeritetin e tij në thirrjen në fe. Atë, e bënte me shumë pasion, prandaj ngarkohej edhe me gjëra, që nuk i përkisnin. Këto sjellje të Muhammedit ﷺ, si të thuash u bënë shkak që, Allahu, prej Mëshirës së Tij, të thotë: “Ne, nuk ta zbritëm ty Kur’anin, për të të munduar”, çka do të thotë se, ti, o Muhammed, po bart barrën, e cila nuk të përket, kurse Ne, nuk t’a zbritëm Kur’anin, që ti t’a mundosh shpirtin tënd.

Kur’ani është, vetëm, një informator dhe përkujtues, për njerëzimin, pastaj “...atëherë, kush do, le të besojë. E kush do, le të mos besojë...”⁹⁶

Allahu, për këtë adresë, thotë: “...a ti (o Muhammed) do t’i urresh (do t’i detyrosh) njerëzit, derisa ata të bëhen besimtarë?!”⁹⁷

Këto ajete të Allahut, na japin të kuptojmë, se feja islame është shumë larg urrejtjes. Ishte një urtësi e lartë kjo, prandaj sevapi dhe ndëshkimi vijnë si pasojë e thënieve: vepro ose mos vepro. Allahu i Lartësuar të ka thënë: bëje këtë, e mos e bëj atë, pastaj i tregoi njerëzimit rrugën e drejtë dhe të shtrembër. Këtu, edhe filloi drejtësia e Allahut xh.sh., njeriun e la të lirë. Atij, ia parashtroi zgjedhjen

⁹⁰ Kur’an, Hud, 12

⁹¹ Kur’an, Fatir 8

⁹² Kur’an, Abese, 1-2

⁹³ Kur’an, Enfal, 68

⁹⁴ Kur’an, Gashije , 22

⁹⁵ Kur’an, En’am, 66

⁹⁶ Kur’an, Kehf 29

⁹⁷ Kur’an, Junus 99

alternative, dhe pas kësaj, nuk ka vend urrejtja. I Dërguari i Allahut, duke qenë se e dinte me plotëbindje, se çfarë do t'i priste mosbesimtarët, mërзите dhe pikëllohej për ta. Ai mendohej, provonte të gjitha format që ata t'i afrojnë, bile, shpeshherë, provonte me metoda që nuk ishin të natyrës së tij. Këtë e bënte për të mirën e tyre, për t'i përfituar që, edhe ata, të hyjnë në Mëshirën e Allahut.

Muhammedi ﷺ, ishte informuar se ishte i dërguar, Mëshirë nga Allahu për mbarë njerëzimin. Kjo, atë, e bënte të dëshpëruar dhe të mërzitur.

Para se të fillojmë polemikën, rreth këtyre ajeteve, e shoh të arsyeshme, t'iu paraqes dy gjëra.

E para, ata, të cilët janë munduar të fusin huti dhe dyshim tek muslimanët, duke i përdorur ajetet e qortimit, si alibi ndaj të Dërguarit të Allahut, ata kanë gjykuar vetet e tyre, sepse janë të shenjzuar. Kur ti e merr Kur'anin, duhet që t'a përjetosh një pjesë të tij, pastaj, pjesën tjetër, do t'a evitosh. Gjithashtu, kemi edhe ajete, që e ngrejnë dhe e lartësojnë, Muhammedit ﷺ, si: "...dhe, vërtetë (ti o Muhammed) je me një moral të lartë"⁹⁸, pastaj "...dhe, vërtetë (ti o Muhammed) po i udhëzon në rrugë të drejtë"⁹⁹, pastaj thënia: "...dhe, ty, të dërguam mëshirë për njerëzimin"¹⁰⁰ pastaj thënia: "...bindjuni Allahut, gjithashtu bindjuni edhe të Dërguarit..."¹⁰¹

Shumë ajete kur'anore, e kanë lartësuar Pejgamberin e Allahut. A është e logjikshme, që të injorohen të gjitha këto ajete dhe të merremi vetëm me ajetet e qortimit!?

Këto qortime u ngjasojnë, atyre personave, që ju mjafojnë thëniet e ajeteve, si p.sh.: "...mos ju afroni namazit..."¹⁰². Me këto lloj shpifjesh dhe veprimesh, njerëzit mundohen t'a njollosin të vërtetën, e t'a fshehin realitetin. Por, unë, nuk e komentoj kështu.

E dyta, Kemi dallim kur themi qortim mbi dhe qortim në. Qortim, aludon në një ngjarje ose ndodhi, sepse rregullat, të cilat i kemi vendosur ndërmjet nesh, janë harmonizuar në atë mënyrë, sa që nuk lejojnë gabime. Por këto ndodhi, para së gjithash, paraqiten prej dashurisë mes personit dhe atij që e qorton. Ti nuk e qorton një njeri, që është ndërmjet teje dhe grupit tjetër. Pabesimtari, nuk qortohet për mëkatin që bëri, është thënia e njohur se: pas mosbesimit, nuk ka mëkat.

⁹⁸ Kur'an, Kalem , 4

⁹⁹ Kur'an, Shura 52

¹⁰⁰ Kur'an , Enbija , 107

¹⁰¹ Kur'an, Nisa 59

¹⁰² Kur'an, 43

Më këtë, kuptojmë, se nuk këshillohet armiku, prandaj ai edhe nuk qortohet për veprat që bën. Ti, nga ai, nuk pret gjëra të mira, pra, çfarëdo të keqe të të bëjë armiku, ti nuk ke pse t'a qortosh atë.

Qortimi mbetet vetëm mes teje dhe atij që ke mirëkuptim, atë që e do. Qortimi do të kuptohet, sipas shkallës së mirëkuptimit ose dashurisë që e ke. Nëse, dashuria, është e madhe, qortimet bëhen për gjëra shumë të vogla. Nëse dashuria është e mesme, qortimi do të jetë për gjëra të mëdha. Një njeri, që pak e njeh, nuk e qorton për gjëra të vogla, por nëse është një person që e do, që është i shtrenjtë tek ti, ose e ke vëlla, qortimi do të jetë aq sa, ai, ka zënë vend tek ti. Qorton vëllain, më shumë, se sa e qorton shokun tënd. E qorton shokun, më shumë, se sa e qorton një të huaj. Qortimi i gjërave të vogla vjen, si rezultat i dashurisë.

Kjo, pra, qenka e kundërta e asaj, që dëshirojnë dualistat. Prej kësaj, ne shohim një dashuri të madhe mes Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Kjo dashuri, ka bërë që Allahu t'a këshillojë të Dërguarin e Tij. A mos vallë, e qortoi për thyerjen e rregullave të gjithësisë, apo ajo ishte mëshirë për të dhe frikë ndaj tij?

Të sjellim një shembull, që do të ketë dy kuptimeve. Psh.unë kam dy fëmijë, njërin prej tyre e kam të zellshëm, kurse tjetri është përtac, nuk e do punën. Këtë të fundit ia përkujtoj shpesh detyrat, dhe shumë punë të tjera, njëkohësisht edhe e qortoj. Kurse fëmijës tjetër, nuk i lë detyra, sepse ai është i kujdesshëm në mësim, në ushqim, në gjumë. Por, derisa, edhe nuk pushon, gjithashtu edhe këtë e qortoj. Fëmijën e parë, e qortoj, sepse nuk është në linjat e rregullta, ai nuk mëson. Mundimet e mia, me këtë fëmijë janë të natyrës, sa për t'a kaluar klasën. Kurse fëmija tjetër, që nuk i thyen rregullat, edhe ky qortohet nga unë. Kujdesi im ose qortimet e mia, për këtë, janë të nivelit tjetër. Këtë e qortoj, të mos konsumohet. Ky lloj qortimi, ose kjo këshillë, është për të mirën e tij. Kjo argumenton, dashurinë dhe frikën e madhe që kam ndaj tij.

Kur i them atij, leri detyrat, pusho pak, sa të kthjellsh, këtë e qortoj, dhe prej tij kërkoj, që ai të veprojë sipas parimeve të mia. Kohë më parë, kam kërkuar nga ai të mësojë, sa të kalojë. E qortoja, i flisja, nëse nuk më dëgjonte ose respektonte fjalën time. Tani e qortoj atë, sepse duhet t'a kursej atë. Qortimi është për të, e jo mbi të. Qortimi im, konsidrohet mëshirë për të, e jo se ai ka bërë ndonjë gabim.

Ajetet që e qortojnë Muhammedin ﷺ, shumica janë të kësaj natyre. Ai nuk e ngarkon, atë, me aktakuza antiligjore. Veprimet e tij, ishin të lejuara, ai kishte kaluar nga gjërat e lehta, tek ato më të rëndat. "U vrenjt (Muhammedi u mrrol) dhe ia ktheu shpinën, sepse atij i erdhi një i verbër". Njeriu i verbër, i cili erdhi tek i Dërguari Allahut, ishte një person, i cili kishte pranuar islamin dhe ishte përplot iman. Ai kishte ardhur tek ai, për të mësuar edhe më shumë. Tani shtrohet pyetja, a do të ishte më lehtë për të Dërguarin e Allahut xh.sh., t'a thëriste njeriun e verbër, apo t'a qortonte veten me kurejshitët, që ishin përplot urrejtje dhe

mospërfillje. Pa dyshim, më lehtë, për të, do të ishte të ulej me atë, i cili kërkonte që t'a udhëzonte në besim. I Dërguari All-llahut, kishte zgjedhur rrugën më të vështirë. Ai mendonte, se Islami do të përparonte, sikur t'i thërriste në udhëzim, liderët ose mospërfillësit e tij. Këtu, i kishte ndërhyrë vullneti i Allahut të Lartësuar, duke kërkuar nga ai, ﷺ, të mos e lë anash pjesën tjetër, ata janë, për të, më të lehtë, e mos t'ju përkushtohet shumë vështirësive. Pse? Kjo ishte për të mirën e davetit (thirrjes islame). Sikur, po i thoshte: pse i lë të lehtë, e po futesh tek të vështirat, kur Allahu i zotëron të dyja? E ti, o Muhammed, mos e ngushto veten, me ata, të cilët, zemrat e tyre, i kanë përplot mlllef dhe refuzojnë të udhëzohen. Por Unë dua, që ti t'ju afroresh atyre, që t'i hapin zemrat dhe imanin, sepse ata janë më afër Allahut. E mos e zgjidh rrugën e vështirë, e cila të sjell telashe dhe të demoralizon. Të gjitha qortimet, janë, pothuajse, të këtij lloji.

I Lartësuari, e kishte paralajmëruar atë, se atij i janë falur të gjitha mëkatet, e mëparshme si dhe ato të ardhmet, megjithatë ai zgjohej natën, nuk flinte. Shpesh herë, prej qëndrimit të tij në këmbë, gjatë faljes së natës, i fryheshin këmbët. Një ditë, në mënyrë habitëse, Aisha (gruaja e tij) e pyeti atë, ﷺ: O i dërguari Allahut, a nuk je i falur prej Allahut!? Iu përgjigj: Po! Por kjo, nuk do të thotë, të mos jem një rob falenderues. Edhe pse ishte i falur, ai, prapë se prapë, vazhdonte duke adhuruar Allahun me bindje të plotë. A thua pse adhuronte, ai ishte i përkushtuar dhe nuk mungonte fare.

Nëse na lejohet t'i krahasojmë obligimet e njeriut, me të mirat dhe begatitë që Zoti ia jep atij, do të shohim se ato janë të pakrahasueshme. Mirësitë e Allahut, janë të panumërta, ato janë të panumërta, kurse obligimet e njeriut ndaj krijesit, janë të pakta dhe shumë të thjeshta. Kështu, zemra e besimtarit, i ndien dhuntitë e Allahut. Sikur, Allahu të kërkonte nga ne, kundërvlerën e atyre që na ka dhënë, nuk do të na mjaftonte dita, e as nata, duke e adhuruar Atë.

Zemra e besimtarit i ndien mirësitë e Allahut, sepse ato janë shumë më të mëdha, se sa falenderimi ose lutjet tona. Duke i kuptuar këto raporte, ai zgjohej natën dhe falej, në kohën, kur njerëzit e tjerë flinin. Namazi i natës nuk është obligativ, ai të harxhon energji, si dhe falenderimet e tjera gjatë kërkesës së shpëtimit, ose si leximi i Kur'anit etj.

Sikur të bashkoheshin të gjitha këto lutje, njeriu, prapë se prapë, e ndien veten të mangët, kundrejt begatave të Allahut të Lartësuar, ato, janë shumë më të mëdha. Sikur, njeriu t'ë ishte i obliguar të falej me këtë ritëm, a do zbrapsej? Jo, asesi, jo. Muhammedi ﷺ, këto lutje i bënte pa përtesë. Allahu xh.sh. kishte debulesë ndaj të Dërguarin e tij, sepse ai ngarkonte veten me përgjegjësinë e pabesimtarëve. Ai mundohej, kërkonte forma të ndryshme, që ata t'i afroreshin besimit, por ky angazhim i tepërt, atë e pengonte dukshëm.

Duke menduar për ta, ai nuk kishte kohë t'i shijonte mirësitë e kësaj bote.

Prandaj, i Lartësuari e këshillonte, ose, si të thuhet, e qortonte duke i thënë, se ti nuk je përgjegjës për ta, nëse ata besojnë ose nuk besojnë. Ti o Muhamed, e kryen misionin tënd, nëse jua dërgon mesazhin. Mjafton t'iu përcjellësh atyre amanetin dhe, me këtë, e ke ndriçuar rrugën.

Ky ishte qortimi i Allahut, a mund të themi, se ky qortim, ka të bëjë me mëkatet, apo, ky qortim, rrjedh nga dashuria, debulesa dhe mëshira e Allahut të Lartëmadhëruar? Siç thamë më lart, Allahu thotë:

“Mbase, ti, do t’a shkatërrosh veten nga hidhërimi, pas tyre (duke u munduar t’i bindësh ata), nëse ata nuk i besojnë këto thënie (të Kur’anit), pastaj: “Ne, nuk ta zbritëm ty Kur’anin për të të munduar”, pastaj: “...pse ia ndalon vetes, atë, që Allahu të lejoi ty”. Të gjitha këto ajete, tregojë dashurinë e Allahut, ndaj të Dërguarit të tij. Dashuri të madhe dhe mëshirë pa kufi. Gjithashtu, i thotë i Lartësuari: “...andaj ti (o Muhammed) mos e shkatërro veten me dëshprim për ta...”, sepse ti, ua përcolle atyre mesazhin dhe mos e angazho veten, deri në shkatërrim. Mos e lejo veten, në asisoj gjërash, që po të ndajnë nga mirësitë dhe udhëzimet e Mia.

Kjo dashuri dhe këto ajete, janë qortimet ndaj tij.

Më duket, se në dy ajete, orientalistët e kanë tepruar, ai: “...kërko falje për gabimin tënd”. Po, për të njëjtën gjë, në suren tjetër ka këtë kuptim: “Kur erdhi ndihma e Allahut dhe ngadhnjimi, dhe ti i pe njerëzit, duke hyrë në fenë e Allahut turma-turma. Pra, lartësoje me Lavdi Zotit tënd, dhe kërko falje nga Ai. Vërtetë Ai pranon pendimin,(është Mëshirues i madh)”.¹⁰³

Në këto dy ajete, Allahu, kërkon nga i Dërguari tij, istigfar. Fjala ‘istigfar ‘do të thotë të kërkuarit falje, por, cili është mëkati dhe, për çfarë, kërkohet falja?

Ajeti i parë, që është në suren Gafir, fillon kështu: “Ti (o Muhammed) ke durim, sepse premtimi i Allahut është hak (i pa shmangshëm), (prandaj ti) kërko falje për mëkatin tënd dhe lartësoje me Lavdi Zotit tënd, në çdo mbrëmje dhe çdo mëngjes”.¹⁰⁴

Nëse jemi preciz, istigfari në këtë ajet, është i lidhur me tespah (lartësim dhe falenderimin) ose, sikur, thënia tjetër: “Prandaj, dije, se nuk ka Hyjni tjetër, përveç Allahut, kërko falje për mëkatin tënd, dhe për besimtarët e besimtare,...”¹⁰⁵

Çdo gjë është e qartë, këto ajete kanë të bëjnë me lutjet. Këto ajete, aspak, nuk theksojnë ndonjë vepër të keqe, të cilat përmbajnë ndëshkim, e për këtë arsye, duhet të kërkojë falje. Por këtu, kërkohet istigfar (falje) në tespah (lartësim), çdo

¹⁰³ Kur’an, sureja Nasr. Përkthimi i kësaj sure është marrë nga përkthyesi H. Sherif Ahmeti

¹⁰⁴ Kur’an, Gafir, 55

¹⁰⁵ Kur’an, Muhammed 19

mbrëmje dhe mëngjes. Këto, janë fjalë lutjesh, këto e afrojnë besimtarin tek Allahu xh.sh. Kjo, nuk ka të bëjë, me qortim për vepra të liga, ose me mospërmbyshjen e detyrave. Kjo, ka të bëjë, me mundimin e tij të tepërt, për t'u afruar sa më afër Allahut. E Lartësonte, Atë, me lutje, me shehadet (thënia: 'Nuk ka Hynji tjetër përveç Allahut'), gjithashtu, kërkonte istigfar për besimtarët e besimtare.

Ata që i komentojnë këto ajete, si kërkesë për falje për t'u mos u dënuar, janë të gabuar. Këto ajete, kanë të bëjnë me adhurimet dhe afrimin tek Allahu i Lartësuar. I Dërguari i Tij, kërkonte istigfar, jo vetëm për veten e tij, por, për mbarë besimtarët. Në një hadith, Muhammedi ﷺ, thotë: " Askush nuk do të hyjë në xhennet, me veprat e tij. I thanë, edhe ti o i Dërguari All-llahut? Tha: veçse nëse "i mbyll" sytë Allahu, nga mëshira e tij".

Prej kësaj, mësojmë se sado të jetë besimi në nivel, të kërkuarit falje është nevojë dhe domosdoshmëri e çdo besimtari. Veprat, sado të mira të jenë, ato, në fund, do të vlerësohen nga Allahu i Lartësuar. Ligjet, nuk erdhën vetëm për të Dërguarin e Allahut, por ato, janë për besimtarët. Muhammedi ﷺ, për besimtarët ishte shembull, ai ishte mjaft i kujdesshëm në veprime. Kjo punë serioze e tij, kishte qëllim që t'i jepte umetit të vet natyrshmërinë e vërtetë njerëzore. Ai ishte i vetëdijshëm, se veprimet e tij, ishin të falura nga Allahu i Lartësuar, por prapë se prapë e falenderonte Allahun xh.sh. Ai zgjohej natën, falej deri sa i enjtëshin këmbët, kërkonte istigfar nga Allahu 100 herë në ditë.

Të gjitha këto, i bënte ngase ishte shembulli i pasardhësve dhe umetit të vet.

Pra, këto ajete, radhiten në kapitullin e lutjeve. Këto, kishin për qëllim afrimin tek Allahun xh.sh., e jo të komentohen qortime në sensin negativ, ashtu siç propagandojnë orientalistët. Ata, kanë komentuar vetëm një pjesë të fjalisë dhe, me këtë gjysmëfjalë, janë përpjekur të fusin hutë.

Ne sollëm mjaft argumente, megjithatë do të polemizojmë me ta, deri sa, ata t'a kuptojnë se janë dredhues dhe në humbje.

Para se të vazhdojmë me polemikën, dua t'ju përkujtoj atyre, se ç'kuptim ka fjala 'istigfar'. Ky është një pjesë e imanit. Duke kërkuar falje, njeriu e ndien veten të turpëruar ose të degraduar nga Allahu xh.sh. Ndjenjen e degradimit të besimtarit, Allahun xh.sh.e interpreton si krenari, ose personalitet me karakter të fortë, para jobesimtarëve.

Nuk do të gjesh njeri, i cili e mohon Allahun, që t'i kërkojë falje Allahut. Të tillët, janë në gjendje, t'a turpërojnë veten e tyre edhe para syve të botës. Atyre, nuk ju bën përshtypje mëkati, atë e bëjnë pa ndonjë drotje ndaj Zotit. Por, kur ju kërkohet falja për istigfar, ata krenohen për mëkatin ose krimin e tyre, që kanë bërë. Kjo, i detyron, ata, mos të kërkojnë falje. Prandaj, istigfar kërkojnë vetëm

ato zemra, që kanë iman në Allahun e Lartëmadhëruar. Ato, duke e pranuar Atë, si të vetmin strehim dhe mbështetje, ata, aty e gjejnë kënaqësinë dhe qetësinë.

Allahu, në një ajet, thotë: “Duke qenë se ti (o Muhammed), je në mesin e tyre, Allahu nuk do t’i dënojë ata, sepse Allahu nuk i ndëshkon ata, përderisa bëjnë istigfarë (kërkojnë falje)”.¹⁰⁶

Ky ajet kur’anor, na qartësoi edhe më tepër fjalën ‘istigfar’. Kjo ndodh, vetëm tek zemrat që kanë iman. Ajeti shpjegon, se Allahu nuk do t’i dënojë besimtarët, përderisa, ty o Muhammed, të kam dërguar mëshirë për botën dhe, njëkohësisht, përderisa Mëshira ime i paraprin ndëshkimit. Kështu, Unë nuk i ndëshkoj ata, duke qenë, se ti je mesin e tyre, garancë dhe mëshirë për ta. Ajeti, pastaj, na tregon se çfarë do të bëhet me ata, pasi Muhammedi ﷺ, do të shkojë prej tyre “sepse Allahu nuk i ndëshkon ata, përderisa, bëjnë istigfar (kërkojnë falje)”.

Pra, edhe pas shkuarjes tënde, o Muhamed, Unë, nuk do t’i dënoj ata, përderisa bëjnë istigfar. Pse? Sepse istigfari është bindje dhe nënshtrim, në Allahun e Lartësuar, e kjo ndjenjë, nuk gjendet tek zemrat jobesimtare. Përderisa, imani është në zemër, atëherë Mëshira e Allahut, mbështillet rreth robit të Tij.

Kështu na sqaron, i Lartësuari, domethënien e istigfarit. Ai pra, qenka parandalues i ndëshkimit dhe pastrues i mëkateve. Tani, në një ajet tjetër, na tregon se sa është vlera e istigfarit, tek Ai:

“...edhe pse ata (hipokritët) kur bënë perversitet (zullum) për vetet e tyre, sikur të vinin tek ti dhe do të kërkonin istigfar prej Allahut, gjithashtu edhe i Dërguari do të kërkonte istigfar (për ata), sigurisht, do të bindeshin se All-llhau është Mëshirëplotë, i Cili, i pranon pendimet.”¹⁰⁷

Pra, etapa e parë e faljes, është të kërkuarit falje, pastaj nënshtrimi ndaj Allahut, pastaj frika ndaj Allahut. Këto, janë sinjalet ose shenjat më të forta të istigfarit. Zemra jobesimtare nuk mëshiron, e as nuk fal, kurse i Dërguari ﷺ, gjithnjë, bënte dua për ummetin¹⁰⁸ e vet. Ai thoshte: “ Kërkoni falje Allahut, sepse unë kërkoj falje nga Ai njëqind herë në ditë”. Nëse, i Dërguari Allahut ﷺ, kërkonte falje duke qenë se mëkatet e tij, ishin të falura, atëherë si do t’ishte gjendja jonë në ahiret!?

Istigfari, është një pjesë e imanit, si dhe bindje në Allahun e Lartësuar. Këtë cilësi, e kanë vetëm besimtarët. Këtë fjalë, nuk e nxjerr nga goja personi, që nuk beson dhe nuk i frikësohet Allahut xh.sh. Këtë fjalë, nuk e ndalin së thëni, bile e thonë nxitimthi, zemrat që kanë frikë Ditën e Gjykimit. Pra, istigfari është në zemrën e çdo besimtari.

¹⁰⁶ Kur’an, Enfal 33

¹⁰⁷ Kur’an, Nisa 64

¹⁰⁸ Ummet – ka kuptimin e unisonit musliman ose bashkësia muslimane ose vëllazëria muslimane

Mjafton t'i shohim besimtarët, se si kërkojnë falje vetëm një ditë në Qabe. Ata shkojnë nga të gjitha anët e botës, për të kryer një obligim të tyre. Të gjithë ata, i dëgjon duke kërkuar falje, në të gjitha gjuhët e botës. Kërkojnë, që Mëshira e Allahut mos të mungojë, i sheh të rrënoqethur e duke qarë, burra goxha të mëdhej e të fuqishëm. Të jepet përshtypja, kur i sheh në këtë gjendje, sikur zemrat e tyre e ndiejnë Mëshirën e Allahut xh.sh.

Gjithashtu i sheh edhe ata, që janë të kapluar nga brengat e botës, të vijnë në këtë vend të pastër, të penduar, dhe të kërkojnë falje për mëkatet e tyre. Këta, i kapin ndjenjat e ligësisë dhe brengosjes, gjatë istigfarit në Allahun, në vendin, të cilën e zgjodhi, i Lartëmadhëruari, shtëpi të Vetën. Ndoshta, do të pranohen lutjet e tyre, iu falen mëkatet, dhe mbase do të shtohet Mëshira për të gjithë.

Pra, istigfari është një pjesë e rëndësishme e imanit. Ai, i cili nuk bie istigfar, i ndërpriten begatitë e mëdha të imanit. Allahu i Lartëmadhëruar, kërkoi nga i Dërguari tij, të kërkojë falje, edhe pse, ai, ishte shembulli më i mirë për muslimanët. Ai, me anë të tij, kërkoi nga të gjithë muslimanët, të veprojnë të paktën si ai, mos edhe më tepër. Të kërkojmë faljen, si dhe të na shlyhen mëkatet tona. Të jetojmë nën ndikimin e bindjes në Allahun xh.sh., duke qenë se e dimë dhe e njohën Atë.

Jemi të vetëdijshëm se, kemi momente ligësie dhe e humbim forcën. Ky istigfar, do të na përkujtonte fuqinë e Allahut dhe, njëkohësisht, do të na shërbente kundër perversëve. Nëse ndodhemi pranë momenteve të tilla, shpresojmë që istigfari i çastit të bëhet shkak për largimin e të keqes dhe, njëkohësisht, ky pendim dhe falje, do të na shërbejë për t'i karikuar zemrat tona, me iman në Allahun e Lartësuar.

Istigfari është edhe lidhje e qëndrueshme ndërmjet Allahut dhe besimtarit. Këtu, përkujtojmë vazhdimisht absolutizmin e Allahut dhe fuqinë e Tij, në njërën anë, kurse në anën tjetër, përkujtojmë dobësinë dhe ligësinë e robit. Këto përkujtime, janë të mira dhe na shërbejnë për një kohë, kur ne harojmë Allahun, nga dinamika e jetës dhe angazhimi ynë me problemet e jetës. Zemra, e cila kërkon falje në Allahun, krijon perde në mes tij dhe mëkatit. Kjo zemër, nuk mund të vazhdojë në mëkate ose në perversitet, sepse atij i përkujtohet Allahu dhe menjëherë kërkon falje. Duke kërkuar falje, ai e kthen në sevap ose në drejtësi, mëkatin që do t'a bënte. All-llahu, nuk i ndëshkon zemrat që pendohen, Ai thotë: “sepse Allahu, nuk i ndëshkon ata, përderisa bëjnë istigfar (që kërkojnë falje)”.

Kjo është mirësia e istigfarit. Këtë e ndien vetëm zemra besimtare, kjo begati, gjendet tek njerëzit, që e kanë frikë Allahun. E, për ta, Allahu thotë:

“Kur erdhi ndihma e Allahut dhe ngadhnjimi, dhe ti i pe njerëzit, duke hyrë në fenë e Allahut, turma-turma. Pra, lartësoje me Lavdi Zotit tënd, dhe kërko falje nga Ai. Vërtetë, Ai, pranon pendimin,(është Mëshirues i madh)”

Tespihët, të lartësuarit dhe istigfari, të kërkuarit falje, konsiderohen bindje vetëm në Allahun xh.sh.. Këtë kënaqësi e ndiejnë vetëm besimtarët. Kjo është arsyeja, sepse këto ajete janë ndërlidhur me suren Fat'h-(‘Ngadhënjimi’). Këto, nuk kanë të bëjnë me mëkatin. Tespihët dhe istigfari, që të dyja, janë madhërim dhe lartësim i Allahut, që të dyja, të afrojnë tek Allahu dhe, që të dyja, të pastrojnë në këtë botë dhe të afrojnë me xhennetin.

Vërtetë, Allahu, i tha Pejgamberit ﷺ, kërko falje për gabimin tënd. Pra, cili ishte mëkati, që ishte bërë prej të Dërguarit të Tij, që të kërkonte falje? Për t’a kuptuar këtë gjysëm ajeti, do të sjellim edhe dy të vërteta të tjera të rëndësishme.

I Dërguari i Allahut, është dërguar si mëshirë për njerëzimin. Kështu, ne edhe e kuptojmë, ai është mëshirë për ne, dhe se Allahu i Lartësuar është i Plotëfuqishëm dhe ndëshkues. Kjo, All-llahun, nuk e pengon dhe gjithësesi nuk i nevojitet asgjë. Kur, Ai, të kap, të kap si një Plotëfuqi Absolute, sa çel e mbyll sytë. Duke patur, i Dërguari Allahut, këto njohuri, ai mendohej që t’a afronte parinë me absolutizmin e Tij, kërkonte të bindeshin dhe, mbase, do të udhëzoheshin. Për këtë arsye, dënonte veten, deri në lodhje të tepruar. Prandaj, i Lartësuari, tha:

“Ne, nuk t’a zbritëm ty, Kur’anin, për të të munduar”

Në një rast, erdhën hipokritët dhe kërkuar falje nga Muhammedi ﷺ, për të mos shkuar në luftë. Ai i liroi, sepse besoi në arsyet e tyre. Pastaj, Allahu, i tha:

“T’a faltë Allahu (o Muhammed). Përse u dhe leje atyre...”¹⁰⁹.

Këtu, Pejgamberi, qortohet ngase u tregua shumë i mëshirshëm. U qortua, gjithashtu, pse lutej për femohuesit. Ata e torturonin, e luftonin, e ai nuk refuzonte t’ju falej xhenazja atyre, me shpresë se Allahu mund edhe t’i mëshirojë. Atëherë, Allahu, i thotë:

“Kurrë mos ua fal namazin (e xhenazes) atyre, që kanë vdekur përgjithmonë...”¹¹²

A mund të thuhet se, namazi i të Dërguarit të Allahut është mëkat? Jo. Ajo konsiderohet mëshirë dhe mundim i tepruar. E mundonte veten dhe kërkonte mëshirë, nga Allahu i Lartësuar edhe për ata, që e kishin refuzuar ftesën e tij. Kur ai, nuk ndalej së kërkuari mëshirë për ta, Allahu, i tha në ajetin tjetër kur’anor:

“...në të vërtetë, sikur (ti o Muhammed) të kërkoje falje për ata (hipokritët) edhe shtatëdhjetë herë, Allahu asesi nuk do t’i falë ata...”¹¹³

Udhëzimi i Allahut është mëshira e Tij në tokë. Vështro qiellin dhe thuaj: o Zot! Mëshira më solli deri tek adhurimi, dhe njohja e ekzistencës Tënde. Më mëshiro mua, derisa të tjerët refuzuan të të besojnë, refuzuan udhëzimin Tënd.

¹⁰⁹ Kur’an, Teube 43

Allahu i Lartësuar ia ndaloi Vetes Mëshirën për politeistët, perversët dhe përçarësit. Duke u nisur nga kjo, Allahu ia ktheu përgjigjen të Dërguarit të Vet, duke i thënë, ti o Muhammed, je mëshirë për besimtarët, ti je mëshirë e kësaj bote, sepse ua ndriçon

Rrugën, për tek Allahu. Ti, ua bën të qartë rrugën dhe u siguron jetë të qetë dhe pa brenga. Atë, që Unë përcaktoj për robërit, t'a kam ngarkuar ty, që t'i informosh. Ata, të cilët të ndjekin, do të shpëtojnë në këtë botë dhe në ahiret, kurse ata, që nuk më besojnë Mua dhe nuk të pasojnë ty, ata i pret dënimi, prandaj, ti o Muhammed, mos e mundo veten për ta, mos kërko mëshirë për ata, që nuk besojnë dhe, njëkohësisht, mos kërko falje për ta. Mos e humb veten, sepse Unë jam Absolut dhe i Plotëfuqishëm. Ata do t'i dënojnë, sipas veprave të tyre.

I Dërguari e ngarkonte veten, më shumë, se ç'nevoitej për davet (shpjegimin e fesë). Për shkak të kërkuarit mëshirë dhe falje të tepërt, Allahu i Lartësuar, kërkoi nga ai, që të pendohet nga kjo teprice. Ky stërteprim, në një farë mënyre, konsiderohet si ndërhyrje në çështjet e Allahut, e kjo, a mund të kuptohet si mëkat? Njëkohësisht, a do të konsiderohet ligji Allahut, për të Dërguarin e Tij, një pjesë e revelatës? Shikuar në këtë këndvështrim, mëshira absolute, ka depërtuar deri tek zemrat e mosbesimtarëve, sepse ato e kuptojnë ndëshkimin e dhemshëm, që do t'a përfetojnë. Për këtë, i Lartësuari Allah, iu përgjigjet:

“ Vëtetë, ti (O Mohammed) je veç një këshillues”¹¹⁰, “Ti, ndaj tyre, nuk je mbizotërues”, “Kurrë, mos ua fal namazin (e xhenazes) atyre, që kanë vdekur përgjithmonë...”

E shumë ajete të tjera, të këtij lloji, në Kur'an.

Disa të tjerë, thonë: çdo teprim, ose thirrje, ose këkesë për mëshirë dhe qortim ndaj Muhammedit s.av.s., konsiderohet, gjithashtu, të jetë në kundërshtim me ajetin:

“Dhe, ai (Muhammedi) nuk flet me hamendje, por...”¹¹¹ edhe pse, orientalistët, kësaj here, e ekzagjerojnë, pajtohem me ta. Për çdo gjë, i Dërguari i Allahut xh.sh., është i inspiruar. Ai është inspiruar për stresin, që e kaplonte gjatë thirrjes, gjithashtu, edhe kur mundohej, për së tepërmi, për t'i afruar mëkatarët. Ai, nga ata kërkonte të besojnë të vërtetën, edhe pse, këtë suplliment, Allahu nuk ja kërkonte.

Vërtetë, ai e ngarkonte veten dhe angazhonte mendjen e tij. Kjo humbje kohe, atij i shndërrohej në stres, ndërkaq, që Allahu nuk e obligonte atë, me këto lloji supllimentesh.

¹¹⁰ Kur'an, Fatir 23

¹¹¹ Kur'an, Nexhm 3

Të gjithëve kundërshtimeve, të këtij lloji, ju them se, kuptimi i ajetit “Dhe, ai (Muhammedi) nuk flet me hamendje, por...”, përderisa, Allahu i Lartësuar e dërgoi Pejgamberin ﷺ, dhe ia ndriçoi rrugën atij, padyshim se Pejgamberi e përcillte me vëmendje, atë linjë të vërtetë, edhe pse mendja e tij, hamendej nganjëherë diku tjetër.

Kur, i tha Allahu i Lartësuar: “Kurrë mos ua fal namazin (e xhenazes) atyre, që kanë vdekur përgjithmonë...”, ai këtë urdhër kurrë nuk e përsëriti. Atij, i vinte keq dhe dëshprohej, kur dikush prej tyre vdiste si mohues dhe nuk e pranonte islamin. Gjithashtu, veproi njëllor, edhe pas zbritjes së këtij ajeti: “U vrenjt (Muhammedi) dhe ai ktheu shpinën, sepse atij i erdhi një i verbër”

Pas kësaj këshille, ai nuk i mungoi askujt. Ata, që vinin dhe kërkonin udhëzim, ishin apo nuk ishin personalitete të larta, i priste me zemërgjërësi. Nuk mohohej fakti se, atij i kishin parapëlqyer personalitetet e larta të vendit, pasi ndikimi tek ta, do të bënte që Islami të forcohej edhe më shumë. Por ai, pas këtyre këshillave, ndoqi rrugën e shpalljes së obliguar, së cilës, ai duhej t’i pëmbahej. Pra, nga kjo kuptojmë, se i Dërguari i Allahut xh.sh., ndiqte rrugën e asaj që i shpallej, pa marrë parasysht, nëse atij i pëlqente ose jo. Ai, nuk qëndroi kurrë, kundër asaj që i revelohej.

Kështu, edhe ajeti Kur’anor: “Ju thafshin (dy¹¹²) duart e Ebu Lehebit, ashtu siç edhe ju kanë tharë”¹¹³.

Ky ajeti, ka zbritur për axhën e Resulull-llahit, Muhammedit ﷺ. Atë e thëriste vazhdimisht në Islam. Ashtu, siç thamë më sipër, shpallja ishte ndërmjet Allahut dhe të Dërguarit të tij, por, prej momentit kur i zbriti ky ajeti, Muhammedi ﷺ u tërhoq, edhe pse, ai ishte xhaxhai tij. Këto ajete, i premtonin axhës së Pejgamberit, zjarrin dhe, gjithashtu, dënimin e dhembshëm. Kështu, veproi Muhammedi ﷺ, me gjitha ajetet e tjera, që përmbanin dispozita të fesë. Ai, në çast, tërhoqej, i ndërpriste hamendjet e tij.

Ndiqte të vërtetën, atë që i shpallej, sado që ajo e vërtetë ishte e dhembshme për të dhe ndeshej me hamendjen e tij.

2. Tani, t’i kthehemi ajetit tjetër: “Dhe, sikur mos të të kishim forcuar ty, ti, pothuaj, do t’u ishte dhënë pak atyre. Kështu që, Ne do të bënim të shijojë (ndëshkimin) dyfish në këtë jetë dhe dyfish pas vdekjes, e pastaj nuk do të gjendej për ty, tek Ne, kurrfarë mbrojtësi”¹¹⁴.

¹¹² Dy duart – Gramatika jonë ka vetëm shumësin dhe njëjësin, kurse arabët, përveç këtyre të dyjave, kanë edhe dysinë. Kur, janë dy persona, arabët e përdorin dysinë dhe kuptohet se janë dy persona ose dy duar etj.

¹¹³ Kur’an, Mesed 1

¹¹⁴ Kur’an, Isra 74

Gjatë polemikës me politeistët, një moment, ata i paskan kërkuar Muhammedit ﷺ, që t'a adhurojnë, Allahun, për një vit, e pastaj, ai t'i adhurojë Zotërat e tyre, vitin tjetër. Disa prej orientalistëve, këtë ajet, e komentojnë kinse i Dërguari Allahut, në një çast, qenka hamendur dhe paska anuar kah politeistat, por paska shpëtuar në momentin e fundit, pa iu përgjigjur ftesës së mosbesimtarëve. Kjo, aspak, nuk është e vërtetë, kjo është një gënjeshtër e kulluar, që del nga orientalistët. Muhammedi ﷺ, kurrë, nuk ka përkrahur, e as nuk ka anuar, kurrë, nga propozimet e tyre. T'a shkoqisim ajetin kur'anor "sikur mos të kishim forcuar ty". 'Sikur mos', kjo është ndalfolje ndalimi. Padyshim, se Muhammedi ﷺ, kishte mbështetje prej Allahut xh.sh. Që prej kësaj pike e tutje, çdo gjë, që pason, në këtë ajet, ka të bëjë me ndajfojlen 'sikur mos'.

Pra, Allahu i tregon, se, ti o Muhammed, je i mbështetur nga Ne. Kjo, të ndalon ty, nga çdo devijim ose shmegie, prej Allahut xh.sh. Pastaj, vazhdojmë me ajetin kur'anor: ti pothuaj, me fjalën 'pothuaj', nënkuptojmë afrim në vepër, por, pa i pasuar ata. Kjo jep të kuptohet se nuk e bëri atë. Nëse nxjerrim kuptimin gjuhësor, dhe themi, thuajse e bëri, por ajo, absolutisht, nuk është bërë. Bile, të afruarit, afër veprës, mohon fjalën 'sikur mos'. Çfarë do të bëje ti, me hamednjen tënde, o Muhammed, sikur Ne mos të të kishim forcuar ty nga qielli? Pa dyshim, që edhe ti do të refuzoje, një gjë të tillë, sepse je i bazuar në natyrshmërinë tënde të mirë, dhe i mbështetur tek Ne.

Një njeri, nëse nuk ka mbështetje nga qielli, ndodh të anojë, për një çast, në ato gjëra. Kur njeriu, ka mbështetje qiellore dhe bindje, në natyrshmërinë e mirë, do t'a ndalojë veten të anojë në veprat e tyre. Nuk dyshohet në ty, sepse përbërja jote dhe ajo që ti posedon, nuk do t'ia lejojë vetes t'i pasojë ata, sikur edhe mos të ishte ndikimi ynë i drejtëpërdretë në ty.

Pastaj, pason ajeti "...Kështu që, Ne do të bënim t'a shijojë (ndëshkimin), dyfish, në këtë jetë dhe, dyfish, pas vdekjes..."

Të ndalemi pak këtu. Cili është qëllimi i shprehjes, dyfish në këtë botë, gjithashtu, edhe dyfish pas vdekjes? A thua, këtu, ka për qëllim të Dërguarin e Allahut? Ai kishte garancë nga qielli, gjithashtu, është i siguruar, sepse atë do t'a mbrojë natyrshmëria e tij e mirë. Meqë, ai i posedonte këto cilësi, ajeti Kur'anor, nuk prejudikon, që i Dërguari i Tij të jetë prej atyre, por, ata, të cilët i bëjnë këto vepra. I Dërguari Allahut, as nuk i ka bërë, e as nuk u është afruar.

Do të gjejmë urtësi, pasi t'a detajizojmë, këtë ajet, kjo është e qartë. I Lartësuari zgjedh atë, që dëshiron, prej robërve të Tij, gjithashtu, i jep postin e dëshiruar. Pastaj, vjen ndikimi i shejtanit, ai hulumton vazhdimisht dobësinë e njeriut. Me këtë, i Lartësuari, sikur na thotë, në këtë ajet: ishit shumë afër ndëshkimit të Allahut xh.sh. Tani, të shohim, se ç'na thotë, në suren Maideh:

"Dhe kur Havarijunët (nxënësit-apostujt e Isaut) thanë: O Isa, i biri Merjemes, a

do të mundë Zoti yt, të na zbresë një sofër nga qielli? Iu tha: Kini frikë Allahun, nëse vërtetë jeni besimtarë. I thanë: duam të hamë prej saj, dhe (gjithashtu le të bëhet) bindje për zemrat tona, si dhe t'a dimë se na ke treguar të vërtetën. Pastaj për të, do të bëhemi dëshmitarë”

“Isai, i biri Merjemes (bëri një lutje dhe) tha: Lartëmadhëri, o Zoti ynë, na e zbrit një sofër nga qielli, le të bëhet festë (bajram për të gjithë ne), që nga i pari deri tek i fundit, dhe le të jetë kjo, një shenjë (mrekulli) prej Teje. Na furnizo, sepse Ti je Furnizuesi më i mirë. Allahu tha: Unë do t'ua zbres juve atë, e kush nga ju, pastaj, do të mohojë, Unë do t'a ndëshkoj me aso dënimesh, që nuk i kam dënuar ndonjëherë, më parë, krijesat”¹¹⁵

Havarijunët pasonin Isain, birin e Merjemes, ata e besonin atë. Ata endeshin me të, sakrifikuan tërë kohën me të, ata ishin apostujt e krishterimit. Dëshiruan, një rast, të kenë një argument nga Allahu, e Ai, ju përgjegj duashë së Isaut, por me një kusht:

‘e kush nga ju, pastaj, do të mohojë, Unë do t'a ndëshkoj me aso dënimesh, që nuk i kam dënuar ndonjëherë, më parë, krijesat’.

Pse ? Sepse Allahu ju dërgoi atyre atë, që kërkuan dhe argumenti ishte shumë i qartë, prandaj dënimi do të ishte shumë më i dhembshëm, se i atyre, që nuk e kishin parë mrekullinë.

Me këtë, i Lartësuar sikur do të na thotë se, sa më afër të jemi me Allahun, më e madhe është përgjegjësia. Ata që i shohin argumentet ose mrekullitë e Allahut, do të përgjigjen më hollësisht, këta nuk barazohen me personat e rëndomtë.

Kështu, i Lartësuar, ju ligjëron edhe grave të Pejgamberit “ O ju gra të pejgamberit! Nuk konsideroheni, si çdo gra të tjera...”¹¹⁶

Këtë, jua tha sepse, ato janë afër tij dhe, sa më afër pejgamberit, përgjegjësia e tyre është më e madhe, prandaj kini kujdes edhe ndaj gjërave të vogla dhe të dyshimta. Ata, që hyjnë në mëshirën e Allahut, ata kanë një peshore të veçantë. Këta, kanë pasur një trajtim tjetër në këtë botë, sepse këta kishin shenja dhe njohuri që nuk i shohin të tjerët.

Pra, ajeti kerim, i cili ishte më parë “sikur mos të kishim forcuar ty”, do të kuptohet, sikurse t'i thuhej: O Muhammed, le t'a dijë mbarë umeti yt dhe i gjithë njerëzimi, se ai, i cili, është afër meje, atij ia shpalosi argumentet e Mia. Nëse këta persona të veçuar mëkatojnë, do t'i marr në përgjegjësi shumë më tepër, se ata që nuk ju kam shpalosur argumentet. Nga urtësitë, e Allahut të Lartësuar, është se ““sikur, mos të kishim forcuar ty, ‘sikur mos’ ka ardhur në fillim të ajetit, dhe kjo

¹¹⁵ Kur'an Maide 112-115

¹¹⁶ Kur'an, Ahzab 32

ndajfolje i përfshin të gjithë, që vijnë pas kësaj shprehje.

Kjo kuptohet kështu: Ti o Muhammed, je i përforcuar nga qielli, gjithashtu ke unin dhe qëndrueshmërinë tëndë, kuptohet se, këtë, e ke prej natyrshmërisë tënde të mirë. Por, ai, që arrin të maskohet, para bashkëkohësve të tij, ai do të pëgjigjet. Gjithashtu, kujdes të veçantë le të kenë të gjithë ata, që kanë argumnetet e Mia, e i fshehin dhe mëkatojnë, të tillët do t'i dënojnë dyfish. Përgjegjësia do të vijë sipas pozitës, që ju ka ngarkuar Allahu i Lartësuar. Allahu xh. sh. ju përgjigj ftesës ose lutjes së Isaut, birit të Merjemes, që t'iu zbriste sofrën nga qielli. Havarijunët ishin prezent kur ajo po zbriste, ishin dëshmitarë. Pastaj, këtë argument, ata e përjetuan, e prekën dhe e shijuan. Me këtë vepër, Isau dhe havarijunët ishin më të privilegjuar, prandaj Allahu ju tha:

“...e kush nga ju, pastaj, do të mohojë, Unë do t'a ndëshkoj me aso dënimesh, që nuk i kam dënuar ndonjëherë, më parë, krijesat”

Të gjitha këto argumente, vërtetojnë se i Dërguari i Allahut, nuk tundohej. Ai nuk kishte parapëlqyer kërkesat e pabesimtarëve, ai nuk do të lejonte që Zotrat e tyre të adhuroheshin një vit, e pastaj të adhurohej Allahu, vitin tjetër. Kjo, na jep të kuptojmë se, ti o Muahmed, je i përforcuar nga Ne, e kjo, ty, do të ndalojë të anosh tek ata, sepse ti je afër Nesh, ty të janë shpalosur shenjat e Allahut të Lartësuar, kurse për ta, është përgatitur dënim i dhembshëm, i dyfishtë, sepse po mohojnë ajetet dhe shenjat e Mia edhe pse i dëshmuan ato.

Ajeti nuk e qorton të Dërguarin e tij, e as që ka të bëjë me të. Ai filloi me ndajfolje ndalimi, ky ajet aludon në kryerësit e veprës, e kjo i përket mbarë njerëzimit. Sipas pozitës, do të jetë gjykimi. Pas prezentimit të këtyre ajeteve të Allahut, nëse dikush do t'i mohojë ato, Ai na siguroi se këta, nuk do të merren në pyetje me peshoren e njëjtë, sikur ata të rëndomtit. Peshorja e tyre është shumë më precize, pastaj dënimi tyre është i dyfishtë.

Këto ishin disa prej ligjëratave, rreth qortimit të Resulullahit ﷺ, në Kur'ani Kerim, të cilat, shprehja dëshirën t'ua shpjegoj. Qortimi, erdhi për shkak angazhimit të tij të tepërt në davet (thirrje) dhe, gjithashtu, për brengosjen e tij të tepërt, ndaj pabesimtarëve. Ai mërzitej tej mase, prandaj, atij nuk i mjaftonin lutjet e tepërta derisa ishin gjallë, por edhe pas vdekjes së tyre Resulullahu ﷺ, ua falte xhenazën. Duke shikuar këto cilësi të tij, konkludojmë se, ai ishte mëshirë për njerëzimin. Ai barte barra, që ishin mbi mundësitë e tij dhe, për këtë arsye, Allahu xh.sh., do të kërkonte që t'i ndërpriste këto teprime. Për këtë stërmundim të tij, duhej të kërkonte falje, sepse ato që ai bënte, nuk ishin kërkesë e Allahut xh.sh.

Nëse konsiderohet qortim, ndaj Resulullahut, animi tij nga pabesimtarët “sikur mos tëkishim forcuar ty” themi se, ai kurrë nuk kishte anuar. Përndryshe, ajeti nuk do të fillonte me ndajfole ndalimi, që në fillim, me ‘sikur mos’! Dhe me këtë, i Lartësuari, na vërtetoi pengimin e kryerjes së kësaj vepre. Pastaj, na informoi se,

aq sa është dashuria dhe afrimi tek Allahu, aq gjëra, do të na mundësojë të shohim. Kjo formulë, vlen edhe në gjykim, ai vlerësohet sipas vendit dhe pozitës në shoqëri, varësisht, se si i ka përjetuar argumnetet e Allahut, kur atij iu shfaqën. Dënimi i tyre, do të jetë i dyfishtë, ose siç na tregoi Allahu, me Havarijunët: e kush nga ju, pastaj, do të mohojë, Unë do ta ndëshkoj me aso dënimesh, që nuk i kam dënuar ndonjëherë, më parë, krijesat”

Njerëzimi ishte indiferent dhe mospërfillës, ndaj thirrjes. Sa herë, që Allahut xh.sh. i dukej se, Muhammedit ﷺ, puna po i shkonte keq, e përforconte atë. Ata, në të shumtën e rasteve, nuk i përgjigjeshin ftesës së tij. Ai, bënte përpjekjet e tij maksimale dhe përpiquej të ishte sa më bindës. Ai ju tregonte, se çfarë do të fitojnë ose pësojnë në ahiret. Por, këtë përforsim të vazhdueshëm nga Allahu, do t’a kuptojmë më mirë, pasi të kemi filluar të shpjegojmë mrekullinë e Israsë dhe Miraxhit, në kapitullin tjetër.

MREKULLIA E ISRA-SË DHE MIRAXH-IT

U njoftuam, në kaptinat e mësipërme, rreth disa mrekullive, por kjo, që do të prezantojmë tani, ka dallim të dukshëm. Mrekullia e Isra-së dhe Miraxh-it është prezantuar, në shumë forma. Kjo mrekulli, është përfolur, ndoshta, më së shumti, dhe rreth kësaj janë shkaktuar polemika të shumta. Veprimet e mrekullive të tjera, të prezantuara para Isra-së, ishin të karakterit dezorientues, apo e çrregullonin mendjen e njeriut, ato dukeshin alogjike, ashtu siç i shpjegojam ato, në kapitujt e mëparshëm. Kur, Allahu, krijoi gjithësinë, Ai, nuk e krijoi së koti dhe pa rregulla, por, atë e krijoi me rregulla shumë precise: dielli, yjet, toka, etj., kanë rregullat e veta, gjithashtu edhe uji ka rregullat e veta.

Shkurt thënë, të gjitha krijesat e Zotit, kanë rregullat e veta.

Edhe pse, Allahu i Lartëmadhëruar, e krijoi këtë univers me rregullat e tij, kjo nuk do të thotë se, Ai e liroi atë plotësisht. Allahu xh.sh., qëndron prapa gjitha krijesave të Veta, deri në Ditën e Katakлизмës. Prej kësaj, nënkuptojmë, se Allahu është mbikqyrësi i gjithësisë. Duke qenë se Ai është mbikqyrësi i tërë kësaj, atëherë, Ai edhe mund t’i ndryshojë këto rregulla, nëse do të dëshirojë. Ato, mund t’ua ndryshojë në tërësi, ose veç e veç, ndonjë prej krijesave të Tij. Kjo pra, është mrekulli. Këto mrekulli, bëhen sa për t’u bindur besimtarët, për diçka që atyre u intereson. Shpeshherë, besimtarët e Allahut të Lartësuar, nga dëshira e madhe për Të, mezi presin që t’iu prezantohen mrekullitë. Kjo shpresë, i mban për të përforsuar besimin e tyre dhe, me të, gjithsesi, të dalë e vërteta e kësaj jete, si dhe të ngadhënjë para pabesimtarëve.

Të gjitha këto mrekulli, kuptohen si vepra të dëshmuara nga turma njerëzish. Këta, kanë qenë prezent, gjatë kohës, kur mrekullia ndodhte. Ata, ishin

bashkëkohës me të dërguarit e Allahut xh.sh. Krahas dëshmitarëve okularë të kohës, prapë se prapë, kemi kundërthënie rreth mrekullive të pejgamberëve.

E si mos të ketë kundërthënie, në mrekullinë e Isra-së së Muhammedit ﷺ, i cili ishte i vetëm, pa asnjë dëshmitar të qenies njerëzore. Këtu, proceset dhe rregullat e qiellit- ndryshuan. Konsideroj se është dallim shumë i madh. Kemi të bëjmë me thëniet e Muhammedit ﷺ, i cili ishte i vetëm. Ai kishte udhëtuar, me trup, nga Xhamia e Qabes, në Mekë, për në xhaminë e Aksasë, në Jerusalemin e sotëm, pastaj u ngrit në qiell. Pastaj, ishte njeriu i vetëm, që iu hapën dyert e qiellit, për të shkuar atje me trup e me shpirt. Ai, arriti deri në Sidretul Munteha¹¹⁷.

Studijues të shumtë, i kanë shprehur mendimet e tyre të ndryshme, rreth këtij udhëtimi, nëse Muhammedi ﷺ, ka udhëtuar me trup dhe me shpirt, apo vetëm me shpirt. Do të ishte më afër logjikës, sikur të thuhej se shkuarja e tij ishte vetëm me shpirt, ky është mendimi i disa dijetarëve muslimanë. Ai, Pejgamberi ﷺ, na rrëfen se çfarë kishte parë atje, gjatë kohës, kur të tjerët ishin në gjumë, ashtu siç i tregojnë, njerëzit e rëndomtë, ëndrrat e tyre. Sipas këtyre dijetarëve, del se nuk duhet polemizuar shumë rreth shkuarjes së tij, ﷺ, në Isra dhe Miraxh. Sipas tyre, rrëfimi i tij, ndeshet me trurin dhe logjikën e shëndoshë.

Po, edhe sikur të shpjegohet kështu, nuk i humb vlera e mrekullisë. Të gjithë atyre, që e ndajnë këtë mendim, shfrytëzoj rastin t'u them se, veçantia dhe madhështia e këtij udhëtimi, qëndron, pikërisht, në shkuarjen e tij me trup. Ky është thelbi i këtij diskutimi. E para, truri dhe logjika e njeriut, nuk është i njëjtë.

Ato nuk krahasohen me mundësitë e Allahut të Lartësuar. Kur kemi të bëjmë me Allahun, ose, kur është Ai në pyetje, asnjëherë mos e barazo Atë me mendjen tënde. Asnjëherë, mos mendo, se kjo mund të jetë më afër, ose më larg mendjes tënde. Kur jemi pranë kësaj situatë, duhet t'a kuptojmë, se të gjitha ligjet dhe proceset stagnojnë. Kodet e logjikës dhe gjykimet tona njerëzore, ngelin, sepse, protagonist, është Allahu xh.sh.

Duke u bazuar në atë, sa më sipër theksuam, nëse ne mundohemi t'a vejmë mrekullinë e Israsë dhe Miraxh-it në diapazonin tonë, e të gjykojmë sipas logjikës, pastaj të deklarojmë, se do të ishte më afër mendjes, sikur të themi se udhëtimi i tij ishte me shpirt, e jo me trup, atëherë ne kemi filluar t'i ngatërojmë punët. Nëse ndodh kjo, atëherë, ne po e barazojmë logjikën dhe mundësitë tona, me ato të Allahut të Lartëmadhëruar. Këtu fillon gabimi, kur ne fillojmë t'i transferojmë ose barazojmë kompetetcat e Allahut, me ato tonat. Them, se kjo, nuk duhet të ndodhë dhe nuk duhet të vazhdohet me këtë mendje, sepse, ato nuk krahasohen në asnjë mënyrë.

Kur, dikush, që në start, mundohet të më vërtetojë, se shkuarja e tij me shpirt

¹¹⁷ Shif tefsirin.....

është e logjikshme, atëherë nuk mbetet çfarë të flas me të, sepse ai e krahason veten, me Atë, që ia ka krijuar mendjen atij. I krijuari, asesi nuk mund t'i barazojë kompetencat me Krijuesin. Nuk ka kut matës, nuk duhet t'a lejojmë veten, t'a krahasojmë Krijuesin, me universin dhe ligjet e tij. Krijuesi i mundësoi, logjikës së njeriut, të zbulojë disa nga proceset e Tij, me qëllim që t'i kuptojë dhe të ketë dobi prej tyre.

Ligjet e tokës, dalin nga dituria e Allahut në diturinë njerëzore, ashtu siç e shpjegoam edhe më lart. I Lartësuari i dha mendjes, aq mundësi, sa për të patur mundësi t'i shfrytëzojë të mirat e kësaj bote. Shtrohet pyetja, pse e bëri këtë? Si duket e bëri për një, të vetmen arsye. I Lartësuari urdhëroi, që njeriut t'i binden ose nënshtrohen të gjitha krijesat e tjera, që gjenden në tokë e qiej.

Po detyrohem t'a përsëris edhe një herë, se mrekullitë, të cilat na prezantoi i Lartësuari, nuk kanë ndonjë qëllim tjetër, përpos forcimit të imanit ose besimit tonë. Në momente të ndryshme kohore, kur besimtarët tregonin luhatjet e tyre ndaj besimit që kishin, atyre ju vinte ndihma (mrekullia) nga qielli, sa për t'ua forcuar besimin. Mrekullitë, u përkasin atyre kohërave, ato nuk përsëriten kurrë. Ata, të cilët i kanë parë, ju besojnë atyre, kurse ata, që nuk i kanë parë, mund edhe të mos u besojnë. Sikur, këto mrekulli, të mos rrëfeshin nga Kur'ani, ose, sikur, të mos ishin nga i Lartëmadhëruari, ato mbase do të shkruheshin nëpër librat e historisë. Nëse, me këto, do të merreshin historianët, atëherë besimi ose mohimi tyre, do t'u lihej parapërgatitjeve edukative të njerëzve dhe aftësive logjike të tyre. Por, kur është fjala për Kur'anin, ato tregime (mrekulli) janë, padyshim, të vërteta.

Tani, përderisa, kemi të bëjmë me mrekullinë e Isra-së dhe Miraxh-it, kjo dallon nga ato të tjerat, sepse kjo nuk ka ndodhur në prezencën e besimtarëve. Kjo ngjarje, nuk kishte për qëllim forcimin e besimit të tyre. Kjo kishte të bënte, drejtëpërdrejt, vetëm me të dërguarin e Allahut xh.sh. Pra, kemi të bëjmë me një mrekulli, e cila nuk është si veprat e tjera, që të shërbente për forcimin e imanit të besimtarëve. Prandaj, kur i dërguari i Allahut ﷺ, iu tregoi njerëzve për atë, një numër i tyre nuk i besoi.

Përderisa, ishte e ndryshme nga qëllimet e mrekullive të tjera, atëherë, cila ishte rëndësia e mrekullisë së Isra-së dhe Miraxh-it? Kjo mrekulli, dallohej nga të tjerat, sepse me këtë rast, i dërguari i Allahut, obligohej për t'i informuar besimtarët me dispozitat më kryesore të Islamit. Njerëzimi do të obligohej me faljen e namazit. Kjo ngjarje madhështore, duhej të kurorëzohej, drejtëpërdrejtë, nga Allahu i Lartësuar, pa shpallje.

Duke e ngritur rëndësinë e saj, njëkohësisht, edhe e tregoi fuqinë e Vet. Përderisa i Lartëmadhëruari, drejtëpërdrejtë, e obligoi njerëzimin me këtë obligim, dhe e veçoi prej të tjerave, atëherë, ky, nuk duhet të lihet në asnjë mënyrë. Në muajin e Ramazanit, kemi raste, që njeriu lejohet të mos agjërojë, kur është në udhëtim,

ose i sëmure ..., por këto, pastaj, duhet t'i plotësojë në ditët e tjera. Sikur të mos ketë mundësi edhe në ditët e tjera, atëherë, atij i lejohet t'i ushqejë të varfërit.

Zekati, nuk është obligativ për mbarë njerëzimin. Ky, obligim, është vetëm për të pasurit. Ata, që nuk kanë pasuri, lirohen edhe nga lëmosha, sepse nuk obligohen as për atë.

Haxhi, gjithashtu, është një obligim për besimtarët, por ai, vlen vetëm për ata, që kanë mundësi.

Pra, përsa u përket obligimeve kryesore, që duhet t'i kryejë njerëzimi, të gjitha kanë tolerancë. Këtu, bën përjashtim namazi, ky obligim, nuk ka kurrfarë tolerance. Namazi, është i obligueshëm, si në luftë ashtu edhe në paqe, bile edhe në fushëbetejë. Gjithashtu, si gjatë kohës kur je i shëndoshë, ashtu edhe i sëmure. Nuk bën përjashtim edhe udhëtimi, kur jemi në lëvizje, ose kur nuk jemi në lëvizje. Njeriu mund të falet në shtrat, nëse nuk mund të qëndrojë në këmbë. Ai mund të falet ulur, nëse nuk mund të bëjë sexhde ose ruku. I Lartësuar, kohës së namazit nuk i ka lënë mundësi zëvendësimi. Pra, njeriu obligohet të falet, gjatë udhëtimit, sëmundjes, etj. Këtu, kemi parasysh, të gjitha lehtësimet që ju janë dhënë të sëmureve, ose bashkimit e namazeve, duke qenë se jemi në udhëtim etj, nga dispozitat e njohura përrreth namazit.

Namazi, qenka lidhje direkte, ndërmjet robit dhe Zotit të tij. Prandaj, kurrë, mos u shkëput nga namazi. Secili vakt i namazit, ka kohën e vet të caktuar, ka performancat, ekskluzivitetet dhe rëndësitë e veta. Secili namaz, është i lartësuar dhe ka madhësinë e vet. Pas gjithë këtyre veçorive madhështore, ai të mbron nga veprat e liga dhe të ndyta.

Duke qenë si ndërlidhës mes robit dhe Zotit dhe duke qenë se të mbron nga të ligat dhe ndytësit, ky obligim iu kurorëzua pejgamberit, drejtëpërdrejtë, nga Allahu i Lartëmadhëruar.

Namazi ju obligua në vendin më të pastër e më të nderuar, në Sidretiu al Munteha¹¹⁸, u obligua në vendin më të afërt, me Allahun e Lartëmadhëruar. Në atë vend të afërt, nuk ka mundur të afrohet as edhe Xhebraili (një prej melaikeve, ose ndryshe postieri ndërmjet Krijuesit dhe krijesave shën.i përkth.). Kur arriti, Xhebralili me të dërguarin e Allahut ﷺ, në Siderutl Munteha, i tha atij: tani do të vazhdosh i vetëm. Muhammedi ﷺ i tha: Jo, ti do të vish me mua! Ai ju përgjegy: sikur të vazhdoj do të digjem, kurse ti po vazhdove do të depërtosh. Nga kjo nënkuptojmë, se prej dritës së Allahut xh.sh., në atë vend, nuk mund të mbijetojë as edhe meleku kryesor. Vend madhështor dhe i shtrenjtë! Vend, që i përket

¹¹⁸ Sidretu al munteha - (Sipas njohurive që iu janë dhënë njeriut Sidretul al Munteha duhet të jet vendkufiri mes krijesave dhe Krijuesit. Në këtë vend askush më parë nuk ishte para Muhamedit ﷺ - Allahu ealem, Zoti e di më së miri)

vetëm Lartëmadhërisë së Tij, atë ia mundësoi robit të tij, vetëm e vetëm, për t'ia dhënë detyrimet – obligimet e Tij. Tani, mundemi t'a vlerësojmë rëndësinë e namazit, si një nga obligimet e dispozitave të adhurimit.

Para se të dalim nga kjo temë, e të argumentojmë, se sa është e diskutueshme kjo mrekulli, mua më janë grumbulluar, në kokë, disa pyetje.

Pyetja e pare: A thua, pse ndodhi Isra-ja dhe Miraxh-i, e nuk ndodhi vetëm Miraxh-i? Pse u desh, që Allahu të kërkojë që robi i Tij të shkonte, prej Mesxhidul Haram (Qabja në Mekkë, sh.p) deri në Mesxhidul Aksa (Xhamia në Jerusalem sh.p.), dhe pastaj të ngjitej, në qiell.

Me siguri, kemi të bëjmë me një Urtësi, në këtë mrekulli. I dërguari i Allahut ﷺ, ishte obliguar nga Ai, që për çdo ndodhi t'a informonte popullin. Ishte detyrë, me të cilën ishte i ngarkuar, nga i Lartësuari. Kjo detyrë, nuk i ishte dhënë në prezence të mbarë njerëzimit, ose para një pjese të tij. Kjo, ishte bërë vetëm në mes tyre. Prandaj, i Dërguari Allahut ﷺ, ishte shumë i kujdesshëm, gjatë marrjes së lajmeve nga Ai, sepse ishte ndërmjetësues, ndërmjet atyre ndodhive, që Allahu shprehte dëshirën për t'a informuar krijesën e Tij. Për të patur argumente dhe për t'a besuar Miraxhin, i Lartësuari, para se të shkonte në Miraxh, e shëtiti rrugës për në Jerusalem.

Udhëtimi nëpër tokë, nga Mekka (Qabja) deri në Jerusalem (Isra), është një prej shenjave tokësore. Në atë kohë, udhëtimi për në Xhaminë e Aksasë, nuk ishte i pamundur.

Karvanet, e përshkonin atë, për disa javë. E rëndësishme, për ne, është se ai udhëtim ishte i njohur, pa marrë parasysh se me çka udhëtohej. Tani, së pari, këtu kemi mrekullinë e udhëtimit. Sepse udhëtimi, u bë brenda një kohe, relativisht, shumë të shkurtër. Pikë së pari, në këtë udhëtim, mrekullia është në kohë. Allahu xh.sh. nuk ka të bëjë me vendin dhe hapsirën. Më pas, atë e ngriti në qiell dhe e ktheu po atë natë. Njerëzit, me shumë vështirësi do t'a kuptonin kohën vajtje-ardhje. Tani, kishin një preteks të mohimit, për ta, kjo ishte dokërr dhe nuk besohej.

Por Muhammedi ﷺ, i lajmëroi ata, se cili karvan është para arritjes në Mekkë si dhe disa të tjera, që i kishte parë gjatë vajtje-ardhjes së tij, Mekke-Jerusalem. Atyre, ua përshkroi xhaminë e Aksasë. Të gjitha këto tregime, ishin dëshmi të mentalitetit njerëzor, në tokë, për mrekullinë. Ky ishte qëllimi. Pasi ju tregoi çfarë kishte parë dhe, pasi, që të gjitha ato dolën të sakta, padyshim, se kjo paraqiste një argument të shëndoshë, se Allahu i Lartëmadhëruar, i kishte prishur të gjitha ligjet logjike njerëzore, të cilat, kanë të bëjnë me qiellin. Përshkrimi i udhëtimit tokësor të tij, ose argumentet e tij të tokës, bënë që të besohet edhe ngjarja e ngritjes së tij në qiell.

Isra-ja, udhëtimi tokësor, konsiderohet mrekulli, qëllimi i këtij udhëtimi, ishte argumenti tokësor, me të cilën, i Lartësuari, i prishi të gjitha ligjet dhe rregullat tokësore, për të Dërguarin e Tij. Udhëtimi, u realizua për një kohë shumë të shkurtër, ose në pakohësi.

Me këtë ndodhi të dëshmuar, i Lartësuar, i bindi, ata, për mundësinë e Allahut, i cili, mund të bëjë çfarë të dëshirojë, për të Dërguarin e Tij. Kur, Ai, ishte në gjendje t'i ndryshojë ligjet tokësore, Ai, pra, e ka po atë mundësi, që t'i ndryshojë edhe ligjet qiellore. Pastaj kur t'u tregojë, Muhammedi s.a.v.s, atyre, të jetë bindës dhe i besueshëm.

Për t'a kuptuar logjika njerëzore, ngjarjen në tërësi dhe për t'a besuar atë, Isra-ja ishte një argument përforcues i një parashyrjeje, ose i një paraargumenti. Pas gjithë kësaj që thamë, kemi njerëz, të cilët tani mund të thonë, se sot mund të udhëtohet për më pak se gjysëm ore.

Kjo, që mund të flitet tani, nuk e prek aspak mrekullinë. Mrekullia e Allahut, mbetet mrekulli e shenjtë, sado që të përparojë shkenca. P.sh., Isau a.s., më parë, i shëronte të lebrosurit dhe të zgjebosurit, ai atë e bënte vetëm me një të prekur me dorë. Sot, shkenca ka përparuar dhe, duke e përdorur ilaçin, i shëron të lebrosurit dhe të zgjebosurit.

Mrekullia, për dallim nga mjekësia, mbetet mrekulli, sepse nuk mund të vijë në asnjë mënyrë koha, për t'i shëruar të sëmurët, vetëm me një të prekur, ashtu siç vepronte Isau a.s. Ashtu është edhe me mrekullinë e Muhammedit ﷺ Sot, me ndonjë mjet, mund të kalohet ajo largësi, për atë kohë, që ai e kaloi, por askush nuk mund të udhëtojë, sikur që udhëtoi ai, vetë me trup. Kjo është një mrekulli, njeriu nuk e ka mundësi të tillë.

Njeriu nuk mund të fluturojë pa ndonjë aparat, sikurse i ngjau Muhammedit ﷺ

Kështu që, mrekulia është diçka shenjtërore, e përhershme, në formën e ndodhisë dhe nuk ka asnjë mundësi, që një njeri të bëjë një gjë të ngjashme si ajo.

Na ka ngelur një pyetje shumë e rëndësishme. Allahu i kishte folur Musaut a.s. në tokë, atëherë, shtrohet pyetja: pse duhej që namazi të obligohej në qiell, vërtetë, pse nuk i foli edhe Muhammedit ﷺ, në tokë, ashtu siç bëri me Musanë a.s.?

Thamë se, mrekullia e parë, ishte Israja, si shenjë tokësore. Në të kthyer, i Dërguari u tregoi se çfarë kishte parë, gjatë këtij udhëtimi. Ishte shenjë tokësore, sa t'ia afrojë të kuptuarit njerëzor, ndodhinë ose ngjarjen qiellore. Për t'a besuar atë, ju tregoi për karvanet, dhe shumë dëshmi të tjera, gjatë këtij udhëtimi Mekke - Jerusalem. Këto të gjitha, vërtetojnë besueshmërinë e tregimit të tij për mrekullinë e madhe, si dhe kujtdo tjetër që i tregohej për të.

Kjo pra, ishte mëshira e Allahut, për logjikën njerëzore. Kur, një sekret i Allahut

të Lartësuar, shfaqet, ai kalon kompetencat e logjikës njerëzore. Ai, është jashtë domenit njerëzor, prandaj, mëshira e Tij, sjell shembuj të përafërt, sa të bëhet e mundur për t'a kuptuar, gjithashtu, kjo, në të njëjtën kohë, shërben sa për t'a forcuar imanin e tyre. Nuk ju jep hapësirë manipulimi pabesimtarëve, të cilët, vazhdimisht, mundohen dhe janë munduar, të fusin hutë dhe dyshim në këtë fe. Ishte në dijen e Tij, prandaj shohim Allahun e Lartëmadhëruar, të sjell shembullin për ata njerëz, të cilët e adhurojnë shkencën, se do të mburren me arritjet e tyre, duke e harruar mundësinë e Allahut të Lartësuar. Atyre ju thotë:

“...vërtetë, për ata, të cilët i drejtohen (adhurojnë) atyre, përveç Allahut, nuk janë në gjendje të krijojnë as edhe një mizë, sikur të mblidhen të gjithë....deri në fund të versetit...të dobët janë edhe kërkuesi, dhe ai që hulumton (shkencëtari)”¹¹⁹.

Sot me përparimin e shkencës, njeriu ka arritur të shkojë edhe në hënë, por ai, nuk është në gjendje të krijojë flatra të një mizeje. Kështu pra, kemi shenja dhe ngjarje të ndryshme, që na tregohen, si p.sh. rreth vdekjes, jetës ose ringjalljes etj., të gjitha këto, janë treguar me qëllim të afrimit dhe të kuptuarit sa më të mirë. Këto, gjithashtu, konsiderohen ndihmë për logjikën njerëzore, dhe njëkohësisht, këta shembuj, shërbejnë për t'ua forcuar imanin besimtarëve, kundrejt mohuesve të kësaj feje. Kur'ani na tregon edhe shumë mrekulli të tjera, disa prej të cilave, do t'i përmendim që tani, kurse të tjerat, në të ardhmen e afërt, inshalla.

Të kthehemi, tek mrekullia e Isra-së dhe Miraxh-it, tek pyetja më e rëndësishme.

Pse, All-llau i Lartëmadhëruar, i ka folur Musaut a.s. në tokë, ndërsa Muhammedin ﷺ, e ka ngritur në qiell?

Para se të filloj të përgjigjem në këtë pyetje, t'i kthehemi fillimit të ajetit kur'anor “Subhanel-ledhi esra... i Lartësuar qoftë Ai, i cili mori për udhëtim...”¹²⁰. Ai, i cili e mori, është Allahu i Lartëmadhëruar, kurse ai, i cili udhëtoi me Të dhe u ngjiti për në qiell, është Muhammedi ﷺ Pra, vepra i përket Allahut. Përderisa kemi të bëjmë me një veprim të Allahut, duhet t'a dimë mundësinë e atij që vepron, në këtë rast të Allahut xh.sh. Ne e dimë, që Allahut nuk i përcaktohen kufij e as rregulla, me të cilat do të matej logjika e njeriut. Ai, nuk ka të bëjë me vendin dhe hapsirën. Nëse bazohemi në këto që thamë tani, kur të flasim për mrekullinë, duhet t'a kemi të qartë dhe t'a kuptojë logjika jonë, se kemi të bëjmë me mundësitë dhe fuqitë e All-llahut xh.sh.

Edhe një herë t'i kthehemi pyetjes. Pse i foli Allahu Musaut në tokë, kurse Muhammedin e ngriti në qiell? A thua nuk që në gjendje t'i fliste edhe këtij në tokë? Përderisa Ai, nuk ka të bëjë me kufij, as me vend, e as me hapsirë, pse e ngriti atë?

¹¹⁹ Kur'an, El-Mu'minum 73

¹²⁰ Kur'an, El Isra 1

Kur ne flasim për këtë, prapë po them se nuk duhet të gjykojmë me parametrat tona. Koha dhe vendi, janë një prej krijesave të Allahut. Ato i krijoi për shërbim të njeriut, në tokë, Ai nuk ka të bëjë me to, prandaj, unë, nuk duhet t'a kuptoj mrekullinë sipas parametrave dhe mundësive të mija si njeri. Tani, këtë, unë duhet t'a kuptoj si mundësi të Allahut të Lartëmadhëruar. Nëse them distancë, ose nëse them e ngriti, kjo nuk duhet kuptuar si një ngritje në lartësi. Kur ne mësojmë se Allahu i Lartëmadhëruar e ngriti Muhammedin ﷺ, nuk duhet kuptuar, siç ne e kuptojmë ngritjen, këtu kemi të bëjmë me ngritjen, sipas mundësive të Lartëmadhërishmit. Veprimi ndërlidhet me mundësinë.

Kështu që, i Dërguari i Allahut ﷺ, me mundësinë e Allahut, arriti në një vend, vend, në të cilin nuk kishin shkuar as melaiket. Siç ekzistojnë ligjet dhe rregullat tokësore, po ashtu edhe qielli ka rregullat dhe ligjet e veta. Sipas këtyre rregullave, asnjë njeri, nuk mund të arrijë në qiell, ose të dalë nga bota tokësore. Kur them bota tokësore, nuk e kam fjalën për hënën, e as planetet që janë përreth tokës, e as diellin, sepse të gjitha këto, janë planetet të diellit dhe, të gjitha këto, kanë të bëjmë me rregullat dhe ligjet, që i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar për një çështje, e cila i përket vetëm Atij dhe këto ndikohen njëra prej tjetrës.

Sikur të zhdukej dielli, do të mbaronte jeta në tokë, sikur të zhdukej hëna, do të kishim ndryshime shumë të mëdha në hemisferën e tokës. Bashkësia e planeve dhe çdo gjë, që ne e shohim është vetëm një bashkësi. Këto, të gjitha, u krijuan nga Allahu, për t'i shërbyer njeriut. Dielli jep ngrohtësi që t'i hapë rrugë jetës, si florës ashtu edhe faunës etj. Sikur të humbte dielli, toka do të shndërohej në akullnajë, ose diçka tjetër, dhe nuk do të kishte jetë. Çdo gjë që na rrethon, është për shërbimin tonë. Erërat, retë, dhe ligjet e gjithësisë i janë bindur ose nënshtruar njeriut.

Pra, brendia e këtij sistemi diellor, i shërben njeriut, por, ne kemi edhe qindra sisteme të tjera, jashtë këtij sistemi diellor. Ashtu sikurse sistemi ynë dhe çdo sistem tjetër, i ka ligjet dhe rregullat, sipas urdhërave që i ka paraparë i Lartëmadhëruari për ta.

Por, kur kemi të bëjmë me Allahun, ne, nuk duhet të harojmë se mundësia i referohet të Lartësuarit, me Të, prishen të gjitha ligjet dhe rregullat për Muhammedin ﷺ. Me lejen e Tij, ai, doli nga të gjitha bashkësitë qiellore (megagalaktikat), atij iu mundësua të shohë shumë gjëra, deri sa arriti në Sidretu Munteha, për t'i dëgjuar edhe majat e lapsave. Kjo largësi ose distancë, nuk e përkufizoj vendin. Shikimi i Muhammedit ﷺ, është transferuar, me mundësinë e Allahut nga megagalaktikat, në diçka shumë më madhështore. Ky transfer, le të kuptojë ndryshimin e vet natyrës së njeriut, duke ndryshuar prej një pozite në të tjetrën.

Diçka, më afër, logjikës sonë. Dua të them, se i Lartësuarit, na ka dhënë të gjitha

shenjat qiellore dhe shembuj, për të na afruar kuptimin dhe të duket e logjikshme. Kur njeriu është zgjuar, duke qenë në këtë gjendje, ai e jeton jetën e vet, sipas natyrës së tij të përditshme. Kur ai bie në gjumë, ai sheh gjëra, që nuk i përkasin ligjeve të jetës së tij të përditshme. Sheh vende, të cilat asnjëherë në jetën e tij nuk i ka parë, e as që i ka dëgjuar.

Ai sheh ose flet me njerëz, të cilët kanë ndërruar jetë shumë vite më parë, e shumë gjëra të tjera, të cilat nuk përputhen me logjikën dhe jetën e përditshme. Sheh veten në maja të maleve, dhe zbret poshtë pa ndonjë problem, ose transferohet nga një skaj në skajin tjetër të botës. Ndodh të shohë dijetarë, që nuk i përkasin kësaj bote. Të gjitha këto, ndodhin për një interval kohor shumë të shkurtër, duke qenë në gjumë. Kur të zgjohet, të gjitha humbin prej tij dhe ai vazhdon jetën e tij të përditshme.

Ç'kuptim ka e gjithë kjo? Kjo nënkupton, se natyrshmëria e njeriut dhe ligjet, me të cilat vepron ai, nuk janë po ato ligje dhe rregulla, duke qenë në gjumë. Ai sheh symbyllur, flet gojëmbyllur, dëgjon atëherë kur mbretëron qetësi absolute. Të gjitha këto ndodhin duke qenë në gjumë. Pse? Sepse natyra e njeriut të zgjuar, ka ndryshuar.

Kur ndryshon natyrshmëria, ndyshojnë edhe ligjet. Ligjet e gjumit, nuk kanë nevojë për sy, që të shikojnë, e as vesh, për të dëgjuar etj. Këto rregulla të njeriut, vlejnë vetëm kur është zgjuar, sepse njeriu është shndëruar në një natyrë tjetër. Me të, korrespondojnë ligje të tjera.

Ato janë për një kohë të caktuar. Kur, kjo i ndodh njeriut, duke fjetur dhe shohim se trupi i tij nuk lëviz, atëherë pse duhet t'a komplikojmë vështirësinë e të kuptuarit të mundësisë së All-llahut, i Cili është krijues i këtyre ligjeve dhe rregullave, për t'a marrë robin e Vet me trup dhe për t'a transferuar atje, ku, Ai, do të dëshirojë? Tani, kur kjo pamje, iu afrua logjikës së njeriut, deri në këtë afërsi, mund të konstatojmë se e kuptojmë edhe mrekullinë e Muhammedit ﷺ. E kutojmë prishjen e ligjeve dhe rregullave njerëzore dhe shkuarjen e tij me trup. Ishte një mrekulli, të cilën i Lartëmadhëruari dëshiroi të na e tregojë, sepse e njëjta gjë e përafërt, edhe neve na është mundësuar, por vetëm në natyrën e rëndomtë, duke qenë në gjumë.

Me fuqinë e Allahut të Lartësuar, mrekullia kishte ndodhur. Muhammedi kishte parë krijesat më të mëdha të Allahut, në qiej, kurse Musau kishte parë krijesat e Allahut, në tokë. Këtu, shohim ndryshimin ndërmjet dy mrekullive.

Sa i përket të folurit të Allahut, kjo kishte ndodhur në një vend, që njihet si mrekulli, ose në vendin e shenjave. Ishte, pra, ky vendi, që Allahu kishte dashur t'i shfaqet të dërguarit e Tij. Atij, i kishte shfaqur disa prej krijimeve të Tij madhore, në tokë. Atij, gjithashtu, edhe i kishte folur në tokë, kurse Muhammedit ﷺ, i kishte shfaqur disa prej krijimeve të Tij madhore, në qiejt e lartë, dhe i kishte

folur në Sidretu al Munteha.

Allahu është prezent në çdo vend dhe në çdo hapsirë. Të folurit nuk përcaktohet me vendin, sepse Allahu, në të njejtën kohë, është në tokë dhe në qiell. Por, ajo që ishte me rëndësi, ishte zbulimi i krijesave të mëdha. Kur, Allahu, ia shfaqti Musaut krijesat madhore, ai ishte në tokë, gjithashtu biseda u bë në tokë. Kurse, Muhammedi ﷺ i pa krijesat madhore të Allahut në qiell dhe biseda u zhvillua në vendngjarjen e mrekullisë. Kjo jep të kuptohet, se Allahu është në çdo vend. Pra, nuk qenka ashtu siç thonë disa dualistë, se Allahu e ngriti Muhammedin ﷺ lartë, sa për të biseduar me të.

Allahu i Lartësuar përcaktoi vendin. Ai, në dy ajete kur'anore, na tregoi se i foli Musait, në tokë dhe Muhammedit, në qiellin e lartë. Me këto të dhëna, Ai na ka treguar se gjendet në çdo vend, gjithashtu na jep argumenteve të shumta të pakufizuara, se Ai i flet kujt të dojë dhe si të dojë, pa marrë parasysh se ngjarja do të zhvillohej në tokë ose në qiejt e lartë, ose në cilëndo pjesë të sundimit të Allahut. Këto argumente të Allahut, vërtetojnë se Ai nuk ka kufij, në kuptimin sipërfaqësor dhe atij hapësinor.

Pra, Isra-ja dhe Miraxh-i, që të dyja kishin ndodhur. Ai udhëtim ishte me trup dhe shpirt, së bashku. Allahu iu kishte dhënë peygamberëve të tjerë mrekullira. Të gjitha ato kishin për qëllim, prishjen e ligjeve dhe rregullave tokësore, të cilat Ai Vetë i kishte vendosur.

Mrekullia e Ibrahimit, Musait, Isait etj., të gjitha kishin për qëllim t'i bindin njerëzit, se ligjet dhe rregullat tuaja nuk vlejnë gjithnjë dhe për secilin. Ato, mund të prishen, sikurse ndodhi kur ia prishi zjarrit, cilësinë e tij të diegies, për Ibrahimin a.s., i prishi ligjet e ujit, sa për të kaluar Musau detin, edhe Isai i ngjallte të vdekurit, me lejen e Allahut, kurse, për Muhammedin ﷺ, i prishi rregullat e tokës dhe qiellit, duke e transferuar atë, nga Mekka për në Jerusalem, për një kohë shumë të shkurtër. Me këtë, e prishi ligjin tokësor, që Vetë e kishte vendosur. Pastaj, ia shtoi kësaj mrekullie edhe pjesën tjetër, duke i prishur edhe rregullat e qiellit. Natyra e njeriut është, që trupi të mos fluturojë në qiell, por këtë rregull, e theu për Muhammedin ﷺ Bëri që të shkojë me trup, deri në Sidretu al Munteha, për t'ia treguar krijesat e mëdha të Tij.

Tani, të vazhdojmë, me ajetin Kur'anor: “ Pastaj u lëshua e iu afrua. Dhe ishte në largësi sa dy harqe, ose edhe më afër.”¹²¹

Kuptojmë se ishte në vendin e Tij dhe zbriti më afër. Këtu, kemi të bëjmë me largësi ndërmjet distancave. Por, kuptimi, ndryshon plotësisht. Ne, matjet tona të largësisë dhe të afërsisë, i bëjmë mes distancave. Koha dhe vendi, janë të krijuara nga Allahu i Lartësuar. Edhe pse, të dyja, janë të krijuara nga Allahu xh.sh., ato,

¹²¹ Kur'an, Nexhm-8, 9

në fakt, nuk i shërbejnë Atij. Ai, nuk shërbehet as me vendin, e as me hapësirën, sipas paragykimeve tona, prandaj nuk duhet të kthehemi përsëri, e të na kaplojnë paragykimet tona, e t'a fusim logjikën në një kënd, e të mendojmë me ligjet tona.

Duke qenë në këtë gjendje, dhe ashtu siç thashë shumë herë, Allahu e ka mëshiruar mendjen e njeriut duke i dhënë mundësinë e të kuptuarit të përafërt, edhe pse ato janë mbi mundësinë e mendjes. Sikur t'a analizojmë këtë thënie, sipas parametrave njerëzore, është sikur t'i themi dikujt, se filani është shumë afër me zemër me filanin, ose themi, janë shumë të përafërt me njëri-tjetrin. Kjo shprehje, a nënkupton të jetë paracaktuar ndonjë distancë? Jo. Ndodh që dikush të jetë shumë afër meje ulur me trup, por që zemrat tona janë aq të largëta, sa që ai mund të konsiderohet më i urryeri, ose më armiku ose njeriu më i papërshtatshëm. Po ashtu, ndodh që dy persona të jetojnë në një shtëpi, në një kulm, por që janë shumë të ndryshëm nga njëri- tjetri dhe, kështu, jetojnë në një largësi shumë të madhe.

Dashuria, urrejta, tradita, zakoni ose gjithçka, që mund të thuhet në të, a varen nga afrimi i distancës? Pra, afrimi me njeriun në afërsi trupore, nuk do të thotë, gjithmonë, të jesh i afërt me të, sikurse kemi afrim, me një njeri, që me trup është larg, por me zemër është shumë afër. Distanca, nuk është gjithmonë shenjë e afrimit ose e largimit ndërmjet dy personave. Atë, nuk mund t'a vlerësojmë me matjen e distancës ose me ndonjë matës tjetër. Pas gjithë kësaj që thamë, nuk duhet t'a marrim ajetin Kur'anor:

“Dhe ishte në largësi sa dy harqe, ose edhe më afër...” në kuptimin e distancës. Por, do t'a kishim marrë afrim shpirtëror, me zemër.

Sikur t'a zbërthenim këtë përmbajtje, edhe më shumë, do të kishim thënë: p.sh. kokrrat e tespive i kishte në dorë, personalisht dua t'a thjeshtoj këtë përmbajtje edhe më tepër, sepse dua të jem preciz në atë, që them: I Dërguari i Allahut xh.sh., ka dëgjuar kokrrat e tespive në dorë. Kokrrat e tespive, mund të jenë në duart e besimtarit dhe jobesimtarit. Çdo gjë, që ekziston, e adhuron dhe e lartëson (heq tespiv në mënyrën e vet, sh.p.) Allahun. Të gjitha këto lloje, ne nuk i kuptojmë e as i dëgjojmë. Këto nuk i nënshtrohen dëshirës së njeriut, e as që ka, ai, ndikim në to.

Të lartësuarit (tespiv), është në dëshirën e Allahut xh.sh. Kur i Dërguari i preku guralecat ose kokrrat, i ka dëgjuar duke lartësuar Atë, sepse dëshira e Allahut të Lartësuar, ishte që t'ia zbulojë atë. Secili njeri, kur i prek kokrrat e tespive, nuk i dëgjon shprehjet e tespiveve (duke ju falur, ose latrësuar Allahut), sepse, Ai, nuk ia ka zbuluar atij atë lloj lartësimi. Ky lloj afrimi, nënkupton shprehjen e të afruarit, tek Allahut i Lartësuar. Ai, ia bën të mundur t'ia afrojë gjësendin (të shpreh gjëra) kur të dojë dhe si të dojë, pastaj, i Lartësuari, thotë për Dautin a.s.:

“ Vëtetë, Ne i bëmë malet t'ju binden (urdhërit Tonë) dhe ato së bashku

Lartësojnë (duke bërë tespih Madhërinë e Allahut) çdo Ashij (nga pasdita, deri në mbrëmje) dhe Ishrak (prej paslindjes së diellit, deri në mesditë)”.¹²²

A nënkupton kjo, se malet ndalen nga tespihët, i Larësuar thotë:

“ ...s’ka gjë (prej gjitha krijesave) që nuk (i falet Atij) e Lartëson Atë, duke i shprehur falenderim, por që ju nuk e kuptoni Lartësimin e tyre (ju nuk e kuptoni gjuhën e tyre)...”¹²³

Nga kjo kuptojmë, se çdo gjë që ekziston, i bën tespih Allahut të Lartësuar. Ai, i Cili ia ka dhënë të shprehurit maleve, Ai e kupton mënyrën e të falurit të tyre, sepse këtë lloj lutjeje e dëgjonte Dauti a.s.

Disa injorantë, duan të dinë se në cilën gjuhë ata luten!? Unë, personalisht, habitem me pyetjet e tyre. Gjuha nuk është e përcaktuar me të folurit. Sinjalet e aparaturës, pa ndonjë lidhje kablloviqe statike, transferohen nëpër botë. Këtë lloj gjuhe, nuk mund t’a kuptojë askush nga ne, përveç atyre që e kanë zbuluar këtë dhe ata që janë specializuar në të. Ata i mësojnë llojet e gjuhëve.

Njeriu, i cili nuk i njeh gjuhët, nëse do të kërkojë takim me ndokënd, ai takim do të dështonte, sepse nuk do të kuptonte asgjë. Po ashtu edhe shifrat, që përdoren mes shteteve, edhe ato janë gjuhë, por ato nuk i kupton kush, përveç atyre, që i kanë çelsat e tyre. Sinjalet e detit, edhe kjo është një gjuhë, por që nuk e kupton askush, përveç marinarëve.

Nga kjo kuptojmë, se shumë gjuhë ekzistojnë në tokë, që nuk kuptohen nga secili. Dëshifrimin e këtyre gjuhëve, do t’a bëjnë vetëm ata, që i kanë çelsat e atyre gjuhëve.

Kështu është edhe me tespihët e maleve, atë lloj falenderimi, nuk e kupton çdokush, me përjashtim të atyre, që iu janë dhënë çelsat e të kuptuarit të tyre. Njëllloj, sikur ato, dhjetra gjuhë, të cilat i përdorë njerëzimi, nuk kuptohen, por ndihen dhe shihen se ekzistojnë, qofshin ato fjalë me shifra, ose pa ndonjë lidhje kablloviqe statike (celularë), etj.

Pra, kur Allahu i Lartësuar, ia zbuloi Muhammedit a.s.v.s., sekretet e qiellit dhe ai e shikoi krijaturën e madhe, ajo ishte një nga dëshirat e Allahut, për të dërguarin e Tij.

Njerëzimi, këtë lloj skene, nuk duhet t’a parafytyrojë, as në kohë, e as në vend. Allahu është jashtë vendit dhe hapsirës, prandaj, ne nuk mund të llogarisim distancën, e të themi se sa lart ka shkuar i Dërguari Allahut xh.sh. Gjithashtu, nuk mund të parafytyrojmë hapsirën, sepse i Lartësuar nuk ka të bëjë me kohën. Në një gjë, jam i sigurt, ajo ka ndodhur, sepse Allahu i Lartëmadhëruar ka krijuar

¹²² Kur’an, Sad 18

¹²³ Kur’an, Isra, 44

qiellin dhe tokën dhe çdo gjë ç'ka në të, dhe ka mundësi t'i prishë, të gjitha rregullat, për t'a plotësuar një mrekulli prej mrekullive të pejgamberëve të Tij. Kurse, mrekullia, siç kam thënë edhe më herët, nuk përsëritet asnjëherë.

Ashtu siç theksuam, për ngritjen e Muhammedit ﷺ. në qiell, ashtu themi edhe për afrimin e tij, afër Tij. Ashtu siç thamë, afrimi nuk është në distancë, por ngjitje shpirtërore dhe me zemër. Shpallja, kur i zbriste Muhammedit ﷺ, për t'a përcjellë fjalën e Allahut, ishte afër zemrës dhe shpirtit të Tij. Nuk i kishte ndodhur, kjo më parë ndonjë njeriu, kështu që Muhammedi ﷺ, gjatë pranimit të shpalljes, ishte në gjendje para agonie. Pasi mbaronte shpallja, ndihej i lodhur nga përzierja¹²⁴ e shpalljes, krahasuar me natyrshmërinë e njeriut. Kjo përzierje, bëhej me urdhërin e Allahut xh.sh. Kur filloi zbritja e Kur'ani Kerimit, i Dërguari Allahut, e përshkruante mënyrën e zbritjes dhe thoshte:

Më erdhi Xhibrili dhe më tha: Lexo! I thash: Nuk di, të lexoj. Më morri dhe më shtrëngoi, për të dytën herë, deri në atë masë, sa që më ra tensioni, pastaj më kthjellonte dhe përsëri më thoshte:

Lexo! I thoja: Nuk di, të lexoj. Më mori dhe më shtrëngoi, për të tretën herë, pastaj më kthjelloi dhe më tha: Lexo! I thoja: Nuk di, të lexoj. Në fund, më tha:

“Lexo! Me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi. Krijoi njeriun nga Alak (copë gjaku i mpiksur). Lexo! Sepse Zoti yt është më i Begati. I Cili i ka mësuar me laps. Mësoi njerinë ato (gjëra), që nuk i dinte”.

Shtrengimi jep të kuptojë, se sa afër ishte i Dërguari Allahut, dhe po ashtu përzierja bëhej gjatë shpalljes së Kur'anit.

I Dërguari Allahut xh.sh., pa atë çka kishte për të parë, në shtatë qiejt (megagalaktikat), pastaj ju tregoi njerëzve. Dikush e besoi, por kishte edhe prej atyre, që nuk e besuan. Ebu Bekri i besoi plotësisht. Kur e informuan Ebu Bekrin, rreth ndodhisë dhe tregimeve të Muhammedit ﷺ, për Isra-në dhe Miraxh-in, ai para se t'ju përgjigjej, ju bëri vetëm një pyetje atyre. Më tregoni të vërtetën, a e ka thënë këtë Muhammedi? Të gjithë i thanë: Po! Atëherë tha: Ai është i besueshëm¹²⁵. Kjo, përgjigje e tij, dha të kuptojë se i Dërguari i Allahut, nuk gënjente kurrë, sepse ai nuk flet me hamendje. Që prej asaj dite, Ebu Bekri, u njoh me pseudonimin 'es Siddik '(i besueshëm), por kishim edhe prej atyre, që e

¹²⁴ Kur'ani Kerim nuk ka zbritur në kaptina, gjatë shpalljes së ajeteve Muhmmaedi ﷺ, urdhërohej që ajetet t'i vendoste në kaptinat e caktuara, sipas urdhërit. Praktika e tillë, i sillte mundime të mëdha, ishte shumë e vështirë t'i rradhiste ajetet. – sqarim i përkthyesit

¹²⁵ Ebu Bekri, në kohën kur i Dërguari Allahut kishte filluar të tregojë mbi Isra-në dhe Miraxh-in, ishte shumë larg vendit. Në atë kohë, ndodhej në tokat bizantine. Kishte shkuar për tregti. Kur, ai ishte kthyer, i dolën në hyrje të Mekkes, për t'a paralajmëruar se shoku i tij i ngushtë kishte “ikur fare”, sepse ai po tregon dokrra. Pas kësaj përgjigje të tij, Muhammedi ﷺ, e quajti atë 'es Siddik ' - i besueshëm. (shënim i përkthyesit)

përgënjeshtroan të Dërguarin e Allahut ﷺ

Muhammedi i kishte paralajmëruar ata, për vendndodhjen e karvanit, ndërmjet Kudsit dhe Mekkes. I thanë: Na përshkruaj Kuds. Ai e përshkruajti me hollësi të shumta. Këto ishin disa nga shenjat tokësore, që bëheshin me qëllim. Përderisa, ishte i saktë në këto, atëherë, do të ishte i besueshëm edhe për Miraxhin, për ngritjen e tij në qiell, si dhe për prishjen e rregullave të logjikës së njeriut.

Kjo ishte mrekullia e Isra-së dhe Miraxh-it. Me të, Allahu, i prishi proceset natyrore, dhe qiellore, për t'i treguar atij krijesat madhore, për t'a përforcuar atë, dhe njëkohësisht, për t'a obliguar ummetin e tij, me lutjen më të shenjtë, që e afron atë me Allahun e Lartësuar.

Qëllimi, në këtë mrekulli, ishte Muhammedi ﷺ Kjo nuk ndodhi para një grumbulli të vogël njerëzish, e as para një auditori më të gjërë. Kjo ishte, vetëm, ndërmjet Allahut dhe të Dërguarit të tij. Ai, ia zbuloi disa nga sekretet e qiellit dhe të universit.

Çfarë na mëson kjo mrekulli? Së pari, mësuam mundësinë e Allahut të Lartësuar, i Cili bën atë që dëshiron me robërit e tij të zgjedhur, pastaj, pejgamberit të fundit, ia tregoi jo vetëm sundimin e tokës, por edhe të qiejve. Mësuam se i Lartësuari, qenka në çdo vend, i flet pejgamberit të Vet, si në tokë, ashtu edhe në qiell, në Sidetul Munteha¹²⁶. Sikur të ishte i Lartësuari vetëm në qiell, nuk do t'i fliste pejgamberit në tokë, e sikur të ishte në tokë, nuk do t'i fliste pejgamberit të Tij në Sidretul Munteha.

Së fundi, mrekullitë e pejgamberëve, bëheshin në prezencën e besimtarëve për t'i përforcuar ata, kurse pejgamberin, Allahu, meqenëse ishte i Dërguari i fundit, e veçoi me ngritjen e tij në qiell, ndësa, mrekullia e tij e pashterur, është prezente para duarve tona, e ai është Kur'ani Kerim, i cili i jep risirat e vazhdueshme secilës gjeneratë.

E falenderoj Allahun, që më mundësoi përkthimin e librit të dytë të këtij libri.

¹²⁶ Kufiri mes Krijësave dhe Allahut (Allahu e di më së miri) (shpjegim i përkthyesit).

Përmbajtja

LAVDI ALLAHUT (EL-HAMDULIL-LAH)	2
ALLAHU DHE GJITHËSIA.....	4
DYSHIMI DHE EKZISTENCA.....	18
LIGJËRIME RRETH SURES KEHF (SHPELLA).....	40
Ç'KUPTOJMË ME FJALËN SHPELLË.....	42
VESHI, JETA DHE RINGJALLJA.....	45
VULLNETI ALLAHUT	46
LAVDIA I TAKON VETËM ALLAHUT.....	49
VEPRUES ËSHTË ALLAHU	51
DITURIA E ALLAHUT	53
KUR PËRPLASEN GJYKIMET	54
SIKUR T'I JEPEJ DITURIA	57
TAKOI NJË ÇUN DHE E VRAU.....	58
CILA DO TË ISHTE PËRZGJEDHJA E PRINDËRVE?.....	61
VEPRA E MIRË ... NUK ZHDUKET.....	63
SHPELLAT E JETËS.....	65
KUR'ANI DHE E VËRTETA	66
DËMTUES I VETVETES	68
PASURIA.. AJO QË JEP ALLAHU.....	70
MBROJTJA E TË DOBTIT.....	71
QORTIMET E PEJGAMBERIT NË KUR'ANI KERIM.....	75
MREKULLIA E ISRA-SË DHE MIRAXH-IT	93